

Le t'i gëzohemi kësaj veprë të bukur dhe të urojmë autorin për kënaqësinë që na dha. Ajo që shkon përshtat si thirrje publike është që ndërsa të huajt e kërkojnë dhe e klikojnë në British Library, shqiptarët e kudondodhur duhet ta kenë atë në duart e tyre që të tregojnë vlerat e tyre si shqiptarë, në artin global.

“Shqiptarët në artin botëror” i studiuesit Ferid Hudhri, ndër librat më të kërkuar në BRITISH LIBRARY, LONDËR

Prof. Dr. Fatmir Terziu, Angli



Kënga popullore
Moj bejka konispolite
**ARI I RIGJETUR I
NJË KËNGE ÇAME**
Nga Bashkim Kuçuku (fq. 8)

SHËNIME MBI LIBRAT

Primo SHLLAKU, “Nata e qejve”

**NJI ZBULIM SURREAL
DHE INTROSPEKTIV
TË JETËS, DËSHIRËS,
KUJTESËS DHE VDEKJES**

Nga Vlora Ademi (fq. 10)

Pa u konfrontue hiç, nëpërmjet skenave të shumta të ndërlidhuna me personazhët, autori i shpie lexuesit në një hapësinë ku temat ekzistenciale përzihen me takime thellësisht personale, të gjitha të ngjyrosuna me një ndjesi tragjike. Mbase edhe të përmallshme.

**NJË JETË PLOT SHKULME
E BARDIT LEFTER ÇIPA**

Nga Prof. dr. Bardhosh Gaçe

Në ditë të veçanta të jetës, por edhe raste të kësaj natyre, duket se të përshkon një lloj pasigurie e çuditshme, një pasiguri që lidhet me fjalën, peshën dhe fuqinë që ajo duhet të mbartë për të nderuar poetin dhe vjershëtorin Lefter Çipa nga njëra anë, por edhe detyrimin që zakonisht njerëz të personalitetit të tij duhen nderuar dhe vlerësuar. (fq. 12)

Rreth librit me rrëfime “Post scriptum”

**DYKOHËSIA SI
SPROVË ARTISTIKE
NË KRIJIMTARINË E
BASHKIM HOXHËS**

Nga Agim Bajrami (fq. 4)

Botim i ri nga Ombra GVG

CHARLES CASHA
Një libër për Emin

Përktheu: Anisa Trifoni (fq. 21)

Besnik Mustafaj, finalist i Çmimit Letrar Nabokov, Itali



Pas një leximi të kujdesshëm, juria ka përcaktuar listën e finalistëve për seksionet e veprave të botuara dhe të pabotuara në narrativa, poezi dhe eseistike të Çmimit Letrar Nabokov – 2024, të cilët do të kalojnë në finale. Ceremonia e ndarjes së çmimeve – me prezantime të librave dhe autorëve – do të mbahet më 29 mars 2025, në Teatrin Komunal të Novolit (LE). (fq. 5)

Kadare dhe “apologjia” e të mëdhenjve
**SHKRIMTARËT I DUAM
PAS VDEKJES**

Nga Ndue Dedaj (fq. 6)

**NJË ËNDËRR DIMRI ME
ISMAIL KADARENË**

Nga Enver Kushi (fq. 7)

**“Uroj të të dashurojnë
marrëzisht, Jacqueline”**

Një amour fou surrealiste
à la française

Prof. ass. dr Maklena Nika (fq. 22)



BIBLIOTEKË

Miri Dhrami (fq. 13)

Me lëkurë të re

Mehmet Elezi (fq. 14)

Fustani për Shën Valentin

Odise Kote (fq. 14)

Llokumet

Eva Gavani (fq. 15)

Kam gjetur një shteg

Artur Spanjoll (fq. 16)

Aromë lulesh prilli

Feride Papeleka (fq. 18)

Poema dashurie

Klara Kodra (fq. 19)

Ëndrra të bukura

Lemony Snicket (fq. 20)

Do të të dua

Përktheu: Xhoina Salaj

Peter Stamm (fq. 23)

Ndalesa

Përktheu: Dr. Elda Gjana-Boriçi

Arben Meksi (fq. 24)

Karikatura e së shtunës

Botim i ri nga Minerva

LEV TOLSTOI

Kalendari i urtësisë

Përkthyer nga Granit Zela (fq. 17)

Ky është libri që vetë Tolstoi e konsideronte si kontributin e tij më të çmuar për njerëzimin dhe që është njëkohësisht dhe vepra e viteve të fundit të jetës së tij.

Në Bibliotekën Britanike (British Library), ose sikurse quhet edhe Biblioteka Kombëtare e Mbretërisë së Bashkuar, ku raftet mbajnë mbi 170 milionë artikuj, pra një koleksion i gjallë që bëhet më i madh çdo ditë, ndodhet dhe Enciklopedia „Shqiptarët në artin botëror“, enciklopedi e autorit të mirënjohur shqiptar, Prof. Dr. Ferid Hudhri. Në Katalogun online të këtij institucioni, ku rrënjët e tij shtrihen në shekuj, dhe ku mblidhet gjithçka e botuar sot, që të shërbej për nesër dhe për dekada në të ardhmen, ku ka miliona klikime, kërkime për miliona libra, por edhe gazeta, harta, regjistrime zanore, patenta dhe pulla, rezultojnë se libri në fjalë i Hudhrit mbetet mjaft i kërkuar nga lexuesit. Përpara se Katalogu të sulmohej nga hakerat, rezultonte në disa mijëra klikime, dhe natyrshëm zyrtarët e këtij mjedisi mjaft të vizituar dhe me një emër të madh Global, e deklarorin këtë me një krenari të veçantë. Arsyet ende nuk dihen, por dihet se kjo Enciklopedi është e vetmja, e munguara ndër vite, dhe me një cilësi të madhe e të padiskutueshme të realizimit të saj.

Ky libër mjaft cilësor i autorit Hudhri, është i kërkuar dhe për shumë arsye të tjera, që vijnë nga vlerat, kërkimi adekuat dhe profesional, trajtimi i sqimtë e mirëfilli-shkencor, diskursiviteti i të gjithë burimeve, gjithëpërfshirja, informacioni i një modeli të paparë, materiali ilustrues burimor dhe trajtimi i detajuar, e i planifikuar mirë, në vetë strukturën e Enciklopedisë. Duke ditur se për shekuj me radhë, në kufijtë midis kohërave dhe orekeve kohore, territori i Shqipërisë ishte një lakmi e hershme e Perandorisë Romake, pastaj e Bizantit dhe forcave të tjera agresive dhe grabitëse, dhe në periudhën e hershme moderne pre e Perandorisë Osmane dhe më pas edhe nën Pushtimin italian, apriori ishte dhe fakti që mbeti nën mjaft ndikime. Këto ndikime të mbivendosura kanë rezultuar në varietete kulturore në të gjithë Shqipërinë (natyrale dhe gjeografike), ku përveç lidhjes gjeografike është vetë një ndikim karakteristik për Ballkanin më të gjerë, madje edhe për Mesdheun. Ndikimi bizantin në Shqipëri ishte i thellë, kryesisht përmes tregtisë dhe ndikimeve romane, ashtu sikurse pasuan më pas ndikimet e kulturës dhe arkitekturës italiane.

Edhe pse me pak gjasa të mbaheshin në këmbë shumë nga këto arritje dhe qasje me ndikime, kishat dhe manastiret e asaj periudhe i japin shumë vlerë dhe dimension. Shqipëria ka pesë monumente kulturore të regjistruara në listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s: Butrintin, Qendrat historike të Beratit dhe Gjirokastrës, Amfiteatrin e Durrësit, Varret Mbretërore të Selcës, si edhe Trashëgimia Natyrore dhe Kulturore e rajonit të Ohrit. Ka valle tradicionale popullore nën shoqërimin e tradicionales (Vallja e Tropojës) janë të regjistruara në Listat e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të UNESCO-s. Ministria e Kulturës dhe Informacionit ka për detyrë të ruajë trashëgiminë kulturore të vendit dhe të mbikëqyrë zhvillimin e saj. Edhe pse aktivitete të mëtejshme në mbështetje të zhvillimit të kulturës ndërmerren në nivel të qeverisjes vendore, por kjo është në një plan të gjerë, në një plan që i përket ministrisë, ndërsa atë që ka bërë autori i Enciklopedisë natyrisht është një punë e munguar, një vlerë e madhe dhe një risi e ndjeshme edhe për të huajt, që kohët e fundit duket se kanë shtuar orekset për ta rizbuluar ndryshe.

“Shqiptarët në artin botëror” i studiuesit Ferid Hudhri, ndër librat më të kërkuar në BRITISH LIBRARY, LONDËR

Prof. Dr. Fatmir Terziu, Angli



Kësisoj në këtë pikë Enciklopedia „Shqiptarët në artin botëror“ ka rolin e saj të padiskutueshëm. Pse e themi këtë? Së pari, nga vetë fakti që ajo është ndër më të kërkuarat dhe së dyti, ngase ajo është e strukturuar dhe e paisur edhe me aparatit e duhur ndihmës, i nevojshëm ky për të lehtësuar konsultimin e shpejtë dhe efikas nga ana e lexuesit dhe studiuesve. Indeksi i jep asaj një kënd tjetër profesional dhe kështu ajo mbetet në kornizat më të larta akademike dhe kërkuese si vlerë. Vetë teksti i enciklopedisë është pajisur me indeksin e personave që paraqiten në veprat e artit, si edhe listën e veprave të artit, ku këtu mirëkuptohet se cili ka qenë „gjahu“ rreth të cilit të huajt e artit janë vërtitur e frymëzuar më shumë.

Këtë e vërtetojnë qasjet me figurat historike. Figura të tilla si Skënderbeu, Ali Pashë Tepelena, Mehmet Ali Pasha, Ahmet Zogu, Aleksandër Moisiu e deri tek ato bashkëkohore si Ismail Kadare dhe Nënë Tereza, natyrisht janë embrioni i këtij thelbi.

Prof. Dr. Ferid Hudhri nga eksperiencia e tij e gjatë, nga koha me të cilën ai ka hulumtuar, e zbuluar, gjetur e përshtatur, një kohë gati katër dekadash në studim, kërkim dhe hulumtim shkencor, ka ditur të flasë me dy gjuhë të veçanta. Themi kështu se ka ditur ti afrojë shqiptarëve një realitet të akumuluar dhe të parë në një kënd ndryshe mes artit dhe në anën tjetër mjeshtërisht ka ngritur diskursin të informojë edhe për jetën dhe karrierën



Prof. Dr. Myqerem Tafaj dhe ambasadori amerikan, Arvizu

artistike të autorëve, duke theksuar interesimin dhe përkushtimin që ata kanë pasur ndaj botës shqiptare, fenomenve shqiptare, koloritit dhe kostumografisë, virtyteve dhe tipareve, natyrës së Shqipërisë, njeriut shqiptar, objekteve dhe kulturës materiale shqiptare. Për secilin prej piktorëve, apo skulptorëve autori ravijëzon edhe punimet me subjekt shqiptar që ai ka realizuar, historiku i krijimit dhe ekspozimit të tyre, lëvizjet nëpër ekspozita dhe koleksione të ndryshme dhe vendndodhja aktuale e tyre.


Enciklopedia “Shqiptarët në artin botëror”, kjo vepër monumentale e Ferid Hudhrit, nuk është thjesht një botim i Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimeve të Artit pranë Qendrës së Studimeve Albanologjike, por një përkujdesje e gjatë dhe e gjallë shpirtrore, profesionale, akademike dhe art-përcjellëse që konkuron me vlerë, me cilësi, me art dhe me çdo gjë në përgjithësi, thuhet me të gjithë paraqitjet e këtij lloji në kohë të ndryshme. Në këtë pikë duke parë volumin e saj të madh, që natyrshëm është rreth pesëqind faqe, dhe duke ditur se enciklopeditë janë vepra referimi, ose përmbledhje që ofrojnë përmbledhje të njohurive, të përgjithshme, ose të veçanta, në një fushë, ose disiplinë të caktuar dhe për to angazhohen institucione të tëra, e themi padyshim më të vogël, se kjo Enciklopedi është ajo që e bën Prof. Dr. Ferid Hudhrit një institucion më vete. Kjo e mjaft të tjera si kjo e bën këtë Enciklopedi mjaft të kërkueshme edhe në Bibliotekën Kombëtare të Britanisë së Madhe.

Faktet e tjera burojnë nga ajo që përfshihet në këtë vepër voluminoze, por dhe nga konteksti që dihet e përfshihet se trojet e banuara nga shqiptarët, ashtu si dhe fatet e kulturës shqiptare, ndonëse gjeografikisht i takonin Europës, u mbajtën për shumë kohë larg ndikimit iluminist, ngaqë për shkaqe që tashmë dihen, ndodheshin në skajin më të largët të Perandorisë Osmane e për rrjedhojë, u ndien gati të harruara. Ajo që vlen të citohet është se një ndikim pati Orientalizmi. Orientalizmi tregoi interes për skenat orientale në artet pamore të shekullit të 19-të. Fushata e Napoleonit në Egjipt, pushtimi i Algjerisë, si dhe librat e udhëtimeve dhe përshkrimet e tjera letrare, nxitën entuziazmin dhe imagjinatën e artistëve. Vendet islamike ishin bërë destinacioni i preferuar i udhëtimit për shumë artistë. Skenat e shesheve, pazareve, haremit dhe ngjarjeve të ndryshme folklorike hynë në pikturën evropiane. Orientalizmi rrallëherë kishte një karakter thjesht dokumentar dhe më shpesh përshkruante entuziazmin e evropianëve për bukurinë, gjallërinë dhe joshjen e botës së panjohur dhe ekzotike. Natyra e egër dhe zakonet e pazakonta, të kombinuara me ngjyrat

dhe dritën e mrekullueshme, ishin bërë një frymëzim i madh për artistët evropianë. Një shembull mbetet vlera e pikturës historike të Leopold Müllerit, e njohur për motivet e saj orientale. Nuk ka dyshim se mësimet vendimtare të Millerit përcaktuan preferencën e mjaft subjekteve për pikturë, që vunë në dukje rritjen e interesit të Evropës për ngjarjet në Ballkan. Kështu krahas tij që udhëtoi në Shqipëri, Mal të Zi, Dalmaci, Bosnjë-Hercegovinë dhe Serbi duke mbledhur skica dhe studime të jetës së popujve ballkanikë, janë dhe të tjerët që mbajnë vendin e tyre në këtë Enciklopedi, që për fatin e mirë pamje të jetës së përditshme prej punës së tyre përjetësoheshin në tablo, statuja, monumente, si dhe në vepra të tjera arti. Gjithë kjo krijimtari e begatë, shtrirë në të gjitha gjinitë dhe zhanret e arteve pamore, përbën objektin e enciklopedisë së hartuar nga Ferid Hudhri.

Para disa vitesh, kur në Ambasadën e Shqipërisë në Londër ishte Kryediplomati shqiptar, që në vetvete kishte dhe një shije të lartë estetiko-kulturore, po aq dhe atdhetare-dashamirëse ndaj arti dhe letërsisë, publicisti dhe studiuesi i njohur Mal Berisha, Enciklopedia "Shqiptarët në artin botëror" së bashku me disa libra të tjerë të rëndësishëm u ekspozua në kënde të ndjeshme e të mirëndërtuara për vizitorët e huaj. Ndërsa kjo enciklopedi u pasqyrua krahas librave të Kadaresë, Elsie, e mjaft të tjerë natyrisht kishte dhe meritoren tjetër përkrah saj në gjuhën angleze me titullin "Albania in the World Art", (Athinë, 1990), e cila ishte e plotësuar me 100 riprodhime të reja në pikturë, skulpturë dhe grafikë.

Të mos harrojmë edhe faktin tjetër se kjo enciklopedi kur iu dhurua nga ish-Zëvendëskryemintsi i Shqipërisë dhe Ministër i Arsimit, Kulturës dhe Shkencës, Prof. Dr. Myqerem Tafaj, ish-Ambasadorit të SHBA-së në Tiranë, Arvizu, ajo nuk ishte thjesht një surprizë, por një vlerësim i madh, të cilin vetë Ambasadori Arvizu atëkohë e quajti vlerë mbi vlerat. Në atë kohë ishte dhe një shprehje nga një shkrim i autorit Kastriot Marku që përblidhte si më poshtë: „Me rënien e regjimit komunist dhe hapjen e vendit, kishte mundësi shumë më të mëdha kërkimi, hulumtimi dhe studimi nëpër galeri, muze, biblioteka, arkiva dhe koleksione private të ndryshme në qendra kryesore të artit botëror në shumë vende të botës, si Paris, Romë, Londër, Athinë, Nju Jork dhe deri në Shën Petërburg (në British Museum, Victoria and Albert Museum, Wallace Collection në Londër, në Art Museum në Mançester, në Musé du Louvre e Muse d'Orsay në Paris, në Metropolitan Museum of Art në Nju Jork, Houghton Library në Harvard, Muzeun Ermitazh në Shën Petërburg e Galerinë Tretjakov në Moskë, në Muzeun Uffizi në Firence, në Galerinë e Arteve Moderne në Romë, Muzeun e Soloturnit në Zvicër, Benaki Museum në Athinë) etj., duke siguruar kështu të dhëna të mjaftueshme për enciklopedinë me temë shqiptare. Nga 118 autorë që kishte përfshirë në botimin e parë, tash në këtë botim enciklopedik, numri i tyre shkon në 1250 piktorë, skulptorë dhe grafistë, ndërkohë që numri i riprodhimeve është 1112 copë. Enciklopedia ka gjithsej 871 zëra/njësi enciklopedike të zgjedhura nga mijëra vepra arti nga një arkiv personal, që sikurse e përmend autori shkon në mbi 1400 dosje dhe 7000 njësi arkivore, çfarë dëshmon një punë të



pallogaritshme hulumtuese kërkimore dhe sistemore, pas së cilës qëndrojnë 40 vite të tëra pune.“ (Marku, Gazeta „Shqip“ 2013)

Sikurse shkruhet, Enciklopedia përmban: „Studime mbi ndikimin e shqiptarëve në artin botëror, si artistë dhe si figura të paraqitura në art; Dokumente dhe materiale arkivore të rralla, duke përfshirë piktura, grafikë, dhe fotografi nga artistë të huaj dhe shqiptarë; Piktura e huaj me tematikë shqiptare, që përshkruajnë figura, peizazhe dhe skena nga kultura dhe historia shqiptare; Biografi dhe analiza të thelluara të artistëve shqiptarë, të cilët kanë kontribuar në skenën ndërkombëtare të artit.“ Jo më kot kjo Enciklopedi u bë fituese e Çmimit Special „KULT 2013“.

Duke parë punën e madhe të këtij autori ndër vite, shkrimet e tij të shumta, paraqitjet akademike e shkencore, duke parë këtë enciklopedi në këndin e saj meritore, mund të themi se “Shqiptarët në artin botëror” është një studim jo vetëm me karakter kombëtar por edhe ndërkombëtar të artit gjithëkohor që ka vendosur si kryefjalë Shqipërinë dhe

shqiptarët, duke hedhur një vështrim kritik në punën e artistëve të njohur në këtë drejtim dhe duke eksploruar tendenca dhe lëvizje të gjera me vlera ndërlidhëse, ndërkombëtare. Libri merr si temë qendrore ndikimin e punëve në fatet e mohuara, që natyrisht me forcën që kanë artet pamore kanë synuar të bëjnë atë që mbetet e pavdekshme. Diskutohet dominimi i këtij arti që ka bërë shqiptarët të kenë dhe ata vendin kohor, në kohën kur ishin lënë të braktisur e në harresë të plotë. Përveç kësaj, enciklopedia ka veçori të ndjeshme e të thella disa dhe të panjohura më parë mbi artin që gjunjëzon me art kohërat dhe ngre lart vlerat e ekzistencës dhe vetë jetës si një dëshmi madhështore e përkushtimit të Prof. Dr. Ferid Hudhrit dhe një trashëgimi e vyer për brezat e ardhshëm.

Duke përfunduar dua të shtoj se duke patur në Bibliotekën personale një vepër të tillë, sikurse është dhe mbetet e patjetërsueshme, enciklopedia „Shqiptarët në artin

botëror“, natyrshëm ke autorësinë e këtij hulumtuesi të madh shkencor, Prof. Dr. Ferid Hudhri, por dhe mbi 1250 autorë në 871 zëra dhe artikuj, të ilustruar me 1112 vepra arti nga dora dhe vëmendja e tij, dhe që vepër kaq domethënëse që u botua në 100-vjetorin e shtetit shqiptar. Dhe natyrisht me fjalën e ish-Kryeministrit të Shqipërisë, Aleksandër Meksi, që shprehet qartë se „Tashmë shqiptarët punojnë e studiojnë kudo në botë dhe zbulimi i veprave të tilla është me të vërtetë një detyrë fisnike. Sidoqoftë kjo i takon së ardhmes; tani le t'i gëzohemi kësaj veprë të bukur dhe të urojmë autorin për kënaqësinë që na dha.“, ajo që shkon përshtat si thirrje publike është që ndërsa të huajt e kërkojnë dhe e klikojnë në British Library, shqiptarët e kudondodhur duhet ta kenë atë në duart e tyre që të tregojnë vlerat e tyre si shqiptarë, në artin global.

Ka shkrimtarë, që mbas një krijimtarie të gjatë dhe të frytshme, ndjejnë nevojën të bëjnë një lloj intermexo të shkurtër, jo aq për tu çlodhur dhe reflektuar, por për të thënë disa gjëra në dukje të vogla, që mund ti kenë mbetur pa vënë në gojë e personazheve të tij, si nevojë për të ndriçuar disa zona të vogla dhe të mjegullta të jetës së tyre personale dhe shoqërore,

Shembujt e Orhan Pamukut, Ekzyperisë, Cvajgut apo ndonjë tjetri, na tregojnë se "Post Scriptum" të tillë janë mëse të nevojshëm, Por duket se "Post Scriptum" i Bashkim HOXHES, është shkruar edhe për ca qëllime më tepër Për tu ndier më mirë me veten, dhe për të ndare me ne bujarisht dicka nga sekretet dhe mjeshtëria e tij krijuese ne vite Duke qenë një autor që e ka ndjekur artin dhe letërsinë, në të gjitha viset dhe hapësirat e veta, qëllime të tilla janë të mirëpritura. Që nga shqyrtimi i veprës së tij të parë, që mbeti vetëm si projekt dhe deri tek "Kronikë në ditën e festes së gomarit", lexuesi ka rastin të njihet gjer në detaje me historikun e shkrimit të çdo veprë, , motivet, indiciet dhe dhe gjithçka tjetër që ka të bëjë me realizimin e saj

Ashtu si në prozën e tij të gjatë, ku dominon i foluri skenik, monologu, dialogu edhe këtu, elementë të tillë mund të ndeshesh me tepri, si përpjekje e autorit për t'i dhënë narratives së tij më shumë ngjyrë dhe itensitet

Parë nga ky kënd, ky libër mund të konsiderohet pa frikë edhe si një laborator krijues, ku krijuesi dhe lexuesi hyjnë në një dialog të natyrshëm, duke ngacmuar tema dhe problematika me interes për të djeshmen dhe të sotmen e arti dhe letërsisë

Si dëshmitar i një periudhe të shkretëtirtë, ku të bërit letërsi dhe art, ishte një lojë e rrezikshme me zjarrin, rrëfimi i autorit i ndryshon here pas here tonalitetet dhe nuancat e tij, në varësi të rrethanave dhe ngjarjeve të kohës, pasi vetem një dramaturg dhe shkrimtar si ai, e di, çdo të thotë, skenë teatri, , ku përpara syve të spektatorëve kuriozë, mund të luheshin dy drama njeherësh, ajo e personazhit të trilluar artistik dhe ajo e dramaturgut që e kishte shkruar atë. "Artistikisht mirë, por"

Me ka mbetur në mendje kjo frazë, e shkurtër, gjysmë pohuese dhe gjysmë kundërshtuese, që ka të bëjë me vlerësimin e një veprë mbas provave gjenerale që fsheh në vetvete vërejtjen për mungesën e partishmërisë proletare, vërejtje që mund ti mbyllte perdet e skenës autorit dhe veprës, dhe kjo mund të ishte më e pakta:

"Nga momenti i shkrimit gjer në ditën e premierës, si dhe më pas, drama u gjykua disa herë, levizi nga sirtari në sirtar, nga tavolina në tavolinë, shoqëruar me një re shqetësimi, se mos e teproni me kritika për, pushtetin, që është e vërteta, as që pritej nga unë"

Ndërsa lexon keto pasazhe të trishtë, me sekretarë komitësh të partisë dhe censorë të terbuar, që i vriste e vërteta dhe luftuan ti shndërronin artistët në bojaxhinj të ngrehinën së pushtetit, lexuesi ndjen se është duke u vëzhguar së largu nga sytë e shqetësuar të Minush Jeros, dhe dramati e tij psikologjike, që u shfaqën në dramaturgjinë e asaj kohe si mimozat guximtare të janarit, Ai ka hyre ne kete liber sebashku me shumë emra të tjerë të mëdhenj të asaj kohe, si Kujtim. Spahivogli, Shpëtim Gina, Mihal Luarasi etj, jo vetëm si mësues dhe modele të autorit, por edhe si personazhe me ndikim të jashtëzakonshëm, për kthesën e madhe të dramës sonë kombëtare, mbas viteve shtatëdhjetë

Ndaj sa herë bie fjala për këtë figurë emblematike të dramës, Bashkim Hoxha, nuk e fsheh adhurimin dhe keqardhjen, që ndien Ndien adhurim sepse

Në dramaturgjinë shqipe Minush Jero ze një vend të veçantë, jo vetëm se bëri burg për krijimet e tij, por solli antikonformizmin dhe dramën psikologjike të individit në një shoqëri, që lartësonte uniformitetin dhe psikologjinë e turmës

Si mentori i tij në rrugën e dramës ai e, orientoi atë drejt leximit të Cehovit, Shekspir, Bernard Shout, Gogolit, dhe bëri, të dëgjonte për herë të parë për Durenmatin.

Ndjen keqardhje, sepse asnjë nga historianët dhe studiuesit e mëvonshëm të dramës, nuk e ka vështuar krijimtarinë e tij si një risi në peisazhin monoton të dramaturgjisë shqipe, që dremiste brenda kanoneve të

Rreth librit me rrëfime "Post Scriptum"

Dykohësia si provë artistike në krijimtarinë e Bashkim Hoxhës

Nga Agim Bajrami

ngurtë të epizmit skolasik

Harresë e qëllimshme apo jo qëllim, një gjë ka rëndësi Minush Jeros duhet ti jepet vlera e merituar dhe të hyjë sa më shpejt në programet e shkolles sonë të dramës Teatri ynë dhe gjithë drama shqipe, duhet të mburret dhe te mësojë nga mjeshtëria dhe përvoja e vyer e këtyre mjeshtrove të papërsëritshëm të fjalës dhe regjisë skenike, që në emer të saj, provuan kaq privime dhe vuajtje në jetë

Nëse Bashkim Hoxha arriti të krijonte një letërsi të mirë, që në atë kohë, meritë ka edhe shembulli dhe modeli që këta artistë martirë arritën të krijonin tek ai, me erudicionin dhe artin e tyre

Në këtë kontekst autori nuk e fsheh dëshirën për të hapur me lexuesit një debat rreth qëndrimit të krijuesit në diktaturë dhe liri,

Jo më kot, ai i vendos dy kohët e tij shkrimore përballë njëra tjetrës..Heronjtë dhe anti heronjtë, të vërtetat dhe gënjeshttrat,, duke hequr me këtë rast edhe vijat ndarëse mes tyre

Krijuesve që nisën të shkruanin në të njëjtën periudhë me Bashkimin, ky libër ju sjell në kujtesë copëza arealin, që ata e kanë përjetuar vete, kush më pak e kush më shumë

Në kërkim të emrit dhe karrierës artistike të gjithë ishin të detyruar, të kalonin nga e njëjta portë te shisnin lirinë e tyre artistike dhe te respektonin rigorozisht kornizat e ngushta ideore dhe logjikën e ngurtë të partisë shtet. Për rrugë të mesme as që bëhej fjalë.

"Gjykimi i veprave artistike bëhej në atë kohë, duke pasur primare këndvështrimet ideologjike Një grumbull rregullash të shkruar në fjalime plenumesh, apo të pa shkruara, orientimi për të cilat ishte dhënë nëpër

plenumet e partisë, apo të lidhjes së shkrimtarëve, me krye artikujt programorë të gazetës Drita, "ishin shtrati i Prokustit, që po ti kishe këmbët e shkurtra, ti zgjasnin,, Po ti kishe të gjata, ti prisnin Për dy vjet unë punova si instruktor në aparatit e Komitetit qëndror te Partisë, në drejtorinë e kulturës dhe shtratin e Prokustit, e pashë dhe nga sytë e egzekutorit

Kjo mbetet periudha më e dhimbshme imja, edhe pse nuk më ndodhi të ngrija hanxharin në asnjë rast thotë autori në një nga rrëfimet e këtij libri duke bërë kësajsoj edhe një skaner të hollësishëm të asaj periudhe

Nëse i'a doli te vinte në skenë një pjesë të dramave të tij, përveç talentit te padiskutueshem, kjo arritje i dedikohet edhe gjuhës së pasur në tekstual e që vuri në gojë e cdo personazhi, gjuhë aq komunikuese dhe aq e pëlqyeshme nga publiku, me te cilin ai arriti të krijonte një marrëdhënie të shkëlqyer

Unë e kuptoja suksesin e dramës, jo aq nga vëmendja me të cilën ata e ndiqnin pjesën, por më tepër nga reagimet në frymemarrje të tyre

Pritjet e ngrohta që ju bënë "Vërshimeve Pranverore", Unë dhe Mefistofeli, Këngë dashurie me korba, Pranvera që s'voni Ftesë për gjyq etj ishin reagime miredadhëse të publikut, ndaj një autori që kërkonte të interpretonte artistikisht mbi dukuritë esenciale të realitetit dhe jo të zhgarraviste rreth entuziazmit të gënjeshtërt të turmës së manipuluar

Krijuesve mirë të brezit të Bashkimit e kishin të mprehur intuitën për të kapur që në ajër, se për çfarë tematikash dhe subjektsh kishte nevojë spektatori i asaj kohe etur shqipetar, duke gjetur mënyrën e duhur për t'ia servirur

Jehona e gjatë që vazhdojnë të kenë ato



vepra edhe sot e kësaj dite në kujtimet e bashkëkohesve, shërbejnë edhe si matës i vlerave të tyre,

Pjesen e luanit dhe më cilesore të krijimtarisë së tij, Bashkimi e ka shkruar në vitet post diktaturë, por kjo nuk e detyron atë, të mbyllë sytë përballë problematikave me te cilat ndeshet libri si dhe të pasqyrojë me logjikë raportet mes librit dhe lexuesit. Është e vërtetë që letërsia e shkruar në liri, ta largon frikën nga censura dhe ndëshkimet e rënda, por nuk të ndihmon ashtu sic duhet për përshperfaqjen e ideve dhe koncepteve individuale, duke u ndeshur me lloj lloj sfidash dhe pengesash sibjektive

"Shkruan, boton, promovon Po a lexohet libri?"

Ngado flitet për krizën e leximit dhe herë herë shkrimtarët shihen si disa Don Kishotë të mjerë, që përpëliten në ëndrrat e tyre Besoj se nuk ka krijues, të mos ketë medituar për vendin gjithmonë e më të pa vënëreshëm të librit në shoqërinë e sotme

Stina e tanishme për librin, thonë se është dimër

Qoftë duke i'u referuar frazave të marra nga një prej personazheve të romanit "Dimri i librave, qoftë nga dramati individuale te shokëve dhe kolegëve të autorit që operojnë në këtë periudhë, të përforcohet ideja, se koha e librave ka mbetur në orën zero, dhe ato jetojnë në njëjtën stinë të vështirë si atëherë

Mungesa e interesit të shtetit dhe shoqërisë, që reflektohet edhe nga mungesa e politikave te botimeve,, ka sjellë një stepje dhe kaos në radhët e krijuesve tanë, çka manifestohet edhe në numrin e vogël, te botimeve me vlera në stendat e panairëve dhe renien në mënyrë drastike të numrit të lexuesve

Përpjekja e dy tre shtëpive botuese, për të vënë pak rregull në këtë anomali, është e pamjaftueshme. Sido që të jetë edhe përkundrejt kësaj klime jo të favorshme kurba e krijimeve në dramë dhe në prozën e gjatë e Bashkim Hoxhës ka njohur vetëm rritje. "Hotel Ballkani," "Mot i keq për dashuri", "Ground Zero", "Duartrokësit" Një ditë si Skënderbeu," "Kronikat e mjegullës" Asnjëherë të martën, "Vito," Dimri i librave, Shtëpia e verdhë" e gjer tek romani më i fundit "Koncert në festën e ditës së gomarit," me subjektet e tyre të zgjedhur me temë nga absurdi dhe bashkëkohësit, si dhe gjuhën e fuqishme alegorike, janë prituri dhe vlerësuar ngrohtë nga kritika dhe lexuesi, dhe spektatori, duke futurvkëtu disa nga veprat e tij në komedi dhe dramë si

«Ne kendonim Margariten,» Vizita pa vizë e nje alieni, "TAG, Ftesë per gjyq " Une dhe Mefistofeli" etj të cilat së bashku me drama të autorëve të tjerë, i kanë sjellë sollën skenës sonë frymëmarrjen dhe vizionin e munguar Kur mbyll faqen e fundit të këtij libri krahas kënaqësisë estetike dhe bollikut të informacionit të duket se je duke u shoqëruar edhe nga imazhet e portreteve dhe zërat e pavdekshëm të aktorëve të mëdhenj të skenës si Vangjel Heba, Milto Profi, Marta Burda, Todi Thanasi, Sanije Hoti,, Gulielm. Radoja, Mirush Kabashi, Spiro Urumi, Ferial Alibali Yllka Mujo, Fatos Haxhiaj, Ferdinando Radi etj sebashku me emrat e regjizorëve të medhenj te kinemasë dhe teatrit kombëtar Dhimiter Anagnosti, Khanfize Keko, Mevlan Shanaj etj, pa të cilët ky "Post scriptum," do të ngjante i mangët

Ndofta duhet të kenë qenë edhe malli dhe respekti për ta që e kanë shtyrë Bashkim Hoxhën të merrte vendimin për ta shkruar këtë libër Kjo më bën të mendoj, se më shumë se i autorit ky libër është shkruar si një homazh për ta dhe i'u përket vetëm atyre.



Pas një lexim të kujdesshëm, juria ka përcaktuar listën e finalistëve për seksionet e veprave të botuara dhe të pabotuara në narrativa, poezi dhe eseistikë të Çmimit Letrare Nabokov – 2024, të cilët do të kalojnë në finale. Ceremonia e ndarjes së çmimeve – me prezantime të librave dhe autorëve – do të mbahet më 29 mars 2025, në Teatrin Komunal të Novolit (LE).

**PREMIO NABOKOV LIBRARY (editi)
Narrativa**

- Ivana Librici**, "IL GIGLIO D'ACQUA", Solferino Editore;
- Simona Teodori**, "LA COSPIRAZIONE DEI CENCI", Newton&Compton;
- Letizia Brunetti**, "MUTANDE BUCATE", Albatros Edizioni;
- William Raineri**, "CHI PORTA LE OMBRE", Società Editrice Milanese;
- Emilia Covini**, "VIRGINIA APGAR – L'intuizione geniale", Morelli Editore;
- Mathilde Bonetti**, "CIELI DI PIOMBI", Mondadori Editore;
- Brillante Massaro**, "MALANOTTE E FIGLIA FEMMINA", Scatole Parlanti Edizioni;
- Barbara Guazzini**, "IL CORPO INVERSO", Stto Edizioni;
- Luisa Patta**, "UMANE TRAIETTORIE", Booktribù Edizioni;
- Vito Di Battista**, "IL BUON USO DELLA DISTANZA", Gallucci Editore;
- Besnik Mustafaj**, "L'ESTATE SENZA RITORNO", Bibliotheka Edizioni.

Çmimi "Nabokov"

Çmimi "Nabokov" (it. *Premio Nabokov*) është një çmim letrar i krijuar në Itali për të nderuar veprat bashkëkohore në fusha të ndryshme të letërsisë, si proza, poezia apo esetë. Mban emrin e shkrimtarit të njohur Vladimir Nabokov



BESNIK MUSTAJ, FINALIST I ÇMIMIT "NABOKOV" NË ITALI

dhe synon të vërë në pah autorë e vepra që spikasin për originalitetin, stilin letrar dhe kontributin e tyre kulturor.

Historia dhe organizimi:

Çmimi është themeluar nga një grup shoqatash kulturore dhe intelektualësh italianë në fillim të viteve 2000 (zakonisht përmendet rreth vitit 2006–2007) dhe jepet çdo vit. Aktiviteti organizohet në kuadër të një konkursi letrar publik, ku autorët (ose botuesit e tyre) mund të paraqesin vepra të reja ose të botuara së fundmi.

Qëllimi:

Qëllimi i këtij çmimi është **promovimi i letërsisë bashkëkohore dhe nxitja e talenteve të rinj** në arenën letrare italiane. Përzgjedhja e fituesve kryhet nga një juri e përbërë nga shkrimtarë, kritikë letrarë dhe profesionistë të botimeve.

Veçoritë:

Vlerësohet **risia artistike, origjinaliteti gjuhësor dhe forca shprehëse** e veprës.

Në disa edicione, çmimi ndahet sipas **zhanreve** (p.sh. roman, përmbledhje

poetike, tregime, ese etj.).

Sipas traditës së një pjese të çmimeve letrare italiane, fituesit ftohen shpesh në **ceremoni** publike, ku mbajnë fjalime ose lexojnë fragmente të veprave të tyre.

Megjithëse nuk është aq i vjetër sa çmimet më të njohura italiane si **Premio Strega** apo **Premio Campiello**, "Nabokov" është kthyer në një pikë reference për autorë që kërkojnë të bëhen më të njohur në Itali, veçanërisht në rrethet letrare e kulturore që çmojnë eksperimentimin dhe qasjet bashkëkohore në letërsi



“Unë dua poetët e vdekur”, thotë Lida Snjegina, vajza ruse e novelës “Muzgu i perëndive të stepës”, që nënkupton se ajo nuk i donte shkrimtarët e gjallë. “Ajo don kryesisht shkrimtarët e vdekur”, përforcon Kadare. (I. Kadare, “Onufri”, Vepra, v. VIII, f. 66.) E sollëm këtë detaj për të thënë se tash që nuk e kemi Kadarenë, do ta duan dhe ata që nuk e deshën në të gjallë. Ky është zakoni ynë, nuk mund t’i duam sa janë mes nesh shkrimtarët, për njëqind mos - arsye. E megjithatë ata janë që në gjallje ata të pasvdekjes. Në një intervistë dhënë Alketa Spahiut, Kadare do të thoshte: “Do apo nuk do shkrimtari, vdekja bën pjesë në dosjen e tij. Nuk ka në këtë shprehje asgjë patetike... Përparësia e letërsisë, e artit dhe e çdo krijimi vlerash shpirtërore, qëndron pikërisht te lidhjet e tij me të ardhmen”. (“ExLibris”, 25 janar 2025.)

Kadare nuk ishte natyrë e afrueshme, këtë ia vinin re të gjithë atij, por jo një njeriu tjetër të zakonshëm. Te ky i fundit do të na dukej normale, pasi kështu i kemi tipat në jetë, kurse Kadarenë e donim me doemos që të na begeniste, bile dhe të na “donte”. Kadare ishte vlerësues për secilin shkrimtar, edhe për një letrar të ri, kur ai ishte i talentuar, por mbase pa shumë fjalë. Ai, si gjithë të mëdhenjtë, nuk e njihte gjuhën e lajkave. Ai të pranonte dhe çfarë duhej më tepër. Ishte kënaqësi e veçantë kur ai të thoshte “Të kam lexuar”...

1

Bash për keqkuptimin që kanë të gjallët me të mëdhenjtë, gjithmonë ka qenë nevoja e një apologjie ndaj tyre. Gjergj Kastrioti ishte ai që ishte, ama Frang Bardhi u dëtyrua të shkruante një apologji të gjatë dhe të argumentuar rreth origjinës së tij shqiptare. Edhe poemat e Rilindjes kushtuar figurës së tij kanë qëllimin e ringjalljes së epokës lavdimadhe. “Pështjelloheshim” disi në rini kur lexonim në librat e letërsisë se Noli ishte nga Qyteza e Kolonjës, dhe pse kishte lindur në Ibrik-Tepe, diku mes Greqisë e Turqisë. Ka pasur zhurmë për origjinën e Nënë Terezës, derisa u zbuluan dëshmitë e pagëzimit të saj në kishën katolike të Shkupit etj. Por nuk është vetëm origjina që ka nevojë për apologji, e nuk janë vetëm të huajtë që ngrenë hipoteza, alibi, qenka edhe biografia, si ajo e Kadaresë. Ata që nuk kanë mundësi të flasin për personazhet e Kadaresë, e kthejnë atë vetë në “personazh” të tyre, duke i numëruar kinse cenet. Si është e mundur që të hidhet baltë sy në sy. Shkrimtarit të madh i shpifën se kishte thënë një fjalë të rëndë për ikësit e ambasadave të korrikut 1990, ndokush duke bërë be e rrufe se kjo gjë ishte botuar në gazetën “Drita” në maj të atij viti, kur ikja do të ndodhte dy muaj më vonë në korrik (!?). Kadare e përgënjeshtroi disa herë me gojë dhe me shkrim, por askush nuk ia vë veshin, pasi për ata që nuk janë seriozë dhe nuk lexojnë veprën e autorit, legjendat urbane janë një argëtim delirant. Ata që e mbajnë mend atë verë të nxehtë e të thatë, duhet të arsyetojnë, si ka mundësi që në mitingun e madh të gjëmës komuniste në sheshin “Skënderbej”, i vetmi që mungoi ishte Ismail Kadare! Ky është

Kadare dhe “apologjia” e të mëdhenjve

SHKRIMTARËT I DUAM PAS VDEKJES

Nga Ndue Dedaj

lajmi dhe jo thashethemnaja rreth tij. Sepse Kadare nuk mund të ndodhej në vendin e gabuar, në kohën e gabuar.

Ndërkohë ka marrë më shumë vëmendje sa duhej dhe qendrimi i Kadaresë ndaj Fishtës deri në krijimin e një “dueli” të pakuptimtë se cili nga ata të dy ishte më i madh. Ka ndodhur vetëm njëherë dhe ndoshta nuk do të kishte ndodhur, nëse Kadaresë nuk do t’i kërkohej të fliste në nëntorin e vitit 1973, në Konferencën Kombëtare të Talenteve të Reja, në Korçë, që ishte një kongres i mirëfilltë shkrimtarësh, me praninë e sekretarit të KQ për ideologjinë dhe shefes së Institutit të Studimeve ML, ku ai do të thoshte se Fishta kishte qenë konservatori më i madh i letërsisë shqipe dhe po ashtu liberali më i madh i saj, fjalim që pas disa muajsh u botua si artikull në “Zëri i Popullit”. Autori i këtyre radhëve, asokohe gjimnazist në Mirditë, ka qenë në sallë. Duhet ditur se Konferenca, ku Kadare nuk shpëtoi dot pa u “lagur” me diskutimin e tij retorik, u mbajt në frymën e Plenumit IV të KQ të Partisë të atij viti, që ishte armiku më i madh i letërsisë dhe arteve

në gjithë historinë e tyre. Komentuesit e sotëm populistë duhet të dinë se vetëm një vit më pas Partia do ta kurorëzonte aksionin e saj ideologjik varrmihës të letërsisë dhe arteve me fjalimin e 20 dhjetorit 1974, ku Enver Hoxha do t’i emëronte shkrimtarët dhe artistët “ndihmës besnikë të Partisë në edukimin komunist të masave”. O tempora, o mores. Kësisoj, ç’kuptim ka që ky sakrilegj i një shkrimtari të madh ndaj një tjetër shkrimtari të madh, të rimerret dhe të bëhet çështje dite pas një gjysmë shekulli? Le të trajtohet nga biografët letrarë në kontekstin e dhënë dhe kaq është e mjaftueshme.

Me sa duket gjenitë nuk mund ta kalojnë “Rubikonin” pa i paguar një çmim të lartë bashkëkohësisë së tyre mospranuese. Kadaresë i është bërë objekt sulmi ideologjik gjer romani kryevepër i tij “Pallati i Ëndrrave” në vitet ‘80 të shekullit të kaluar. Po sa e sa shkrimtarë të shquar janë bërë “problem” për shkak të keqkuptimit të (krye)veprave të tyre në kohën kur ato u botuan, duke u (para)gjykuar për thyerje të tabuve morale, fetare, ideologjike,



biografisë së papërshtatshme për regjimet etj., si Charl Bodler me “Lulet e së keqes”, Xhejms Xhojs me “Uliksin”, Scott Fitzgeraldi me “Getsbi i madh” etj. Shkurt, të mëdhenjtë, si në mesjetë, si në kohë moderne, këtë fat paskan, të mbrohen për atë çka ata janë. Apologjia e të mëdhenjve është mjerimi i të vegjëlve.

2

Një nga “arsyet” e mosdashjes së shkrimtarëve sa janë gjallë është mallkimi i biografisë, sidomos i atyre që kanë jetuar në regjimin komunist. E kemi shtjelluar këtë argument në një artikull të gjatë në gazetën “Shqip” më 2006, pikërisht me objekt Kadarenë dhe i rikthehem pasij dhe sot shkrimtarët gjykojnë jo për veprën, por si i kanë pasur raportet me regjimin e kaluar, jo vetëm të anatemuarit e vdekur e të gjallë si Fishta, Konica, Koliqi, Kokalari e Haxhiademi, por dhe Malëshova, Marko, Trebeshina etj.

Nga ana tjetër, kur sheh sot bërllokun e fjalëve me të cilin sulmohen



Duke sfiduar vapën e padurueshme të Tiranës.
Bar Juvenilja, e hënë, 24 qershor 2024

[Kjo mbeti fotoja e fundit e Kadaresë.]

shkrimtarët, thua kanë qenë me fat ata autorë që kanë vdekur jo në kohën e internetit, pasi kanë shpëtuar nga jargët e sharjeve dhe “biografizimi” i tipit bolshevik, si dhe nga “klasifikimi” popullor kush është i pari, kush i dyti, kush i treti, a thua se bëhet fjalë për krushq të një dasme që shkojnë të marrin nusen. Është po ajo mendësi që për gjysmë shekulli Fishtën e denigronte për vargjet “Le ta marrë vesh gjithë bota mbarë...”, pa ua ditur kuptimin. Puna është se mosleximi i veprës këtë “çmim” ka, atë të përcimit të autorit me anë të biografisë. Po e gjitha kjo është një kotësi, ata tashmë rrojnë përtej vetes dhe kohës. Sa i përket Kadaresë, janë vetëm gjashtë shkronja, për të thënë të gjithin atë, qoftë dhe pa emrin Ismail përpara, si në rastin e De Radës, Fishtës, Migjenit, apo Kafkës, Kunderës, Borgesit etj. I takoi gjeneratës sonë, apo më saktë dy-tri gjeneratave të fundit, për ta përcjellë në amëshim, por shkrimtari i përket lexuesit shqiptar prej shtatëdhjetë vjetësh, që nga viti 1954, kur solli “Frymëzimet djaloshare” gjyrokastrite, që parathoshin një talent të madh të letërsisë shqipe. I llogarisni vetë lexuesit e tij, prej atëherë, këtu dhe në Kosovë, ku ato gjeneratat e para që e njohën atë si krijues, janë shuar. Por llogarisni dhe lexuesin e tij shqiptar të nesërm, që nuk do të jetë i dyzuar si një pjesë e lexuesit të sotëm, që e sheh shkrimtarin mes letërsisë dhe biografisë, duke i mëshuar kësaj të fundit, a thua se Kadare duhej të ishte një gjysmëperëndi në tokë! E ky është vetëm njëri, lexuesi i gjuhës dhe i gjakut të tij, por është dhe ai lexuesi i huaj i dyzet e pesë gjuhëve të botës, që vetëm sa shtohen. Pra, mjaftojnë vetëm ato gjashtë shkronja, me theks në të fundit, dhe s’ka nevojë për tjetër, si “gjeniu i letërsisë shqipe”, “shkrimtari shqiptar me përmasa botërore” etj. Ai do të jetë dhe letërnjoftimi ynë jashtë vendit. Ju jeni të... Kadaresë? Dmth vini nga vendi i tij? Nga gjuha shqipe? Kaloni!...

Ndokush nesh, që është duke kaluar nëpër atë “aerportin” pa ulje dhe ngritje avionësh, mund të ngurrojë për një çast. Si? Ju po thoni Kadareja është një mit i gjallë? Po ai... nuk foli për shembjen e Teatrit, nuk e kritikoi qeverinë për pazotësinë në luftën kundër e kanabisit, as atë tjetren dje për lejimin e “piramidave”! Nuk mori kazmën të shembte me rropamë kampin socialist! Ka aq shumë mëkate. Nuk i shkruam më kot ne të tjtë Stokholmit që të mos i jepej “Nobeli”.

Ai, i huaji, atje përtej shtetit tënd, që është duke të dëgjuar ty e ka gati përgjigjen, por nuk ngutet. Në fund të le pa fjalë: “A ishte ai një shkrimtar?” Ti sigurisht që nuk mund të thuash se nuk ishte... A, po, vijon ai “apologjinë” për Kadarenë, kam dëgjuar se ju shqiptarët bëni një dallim të çuditshëm, mes shkrimtarit dhe njeriut, thoni se si shkrimtar është i madh, kurse si njeri jo!? Po ku tjetër ndodh kjo ndarje mes krijuesit dhe njeriut? Ju dini se Shekspiri është i madh si shkrimtar, por nuk dini asgjë se si ishte ai si njeri! Apo Balzaku, Dostojevski, Zvjagju. Mos duhej ta modelonit ju shkrimtarin tuaj si karakter, sa i censhëm të ishte? Atëherë ai nuk do të ishte ai që ishte dhe për rrjedhojë do të mungonte vepra e tij!... O Zot kanë guxuar gjer hierarkë

të lartë tuajt në demokraci ta cilësojnë “shkrimtar oborri”, për të qitur vetën më lart se shkrimtari. Por, më thoni, ku janë ata tani? E ku do të jetë nesër, kur nuk do të jenë më presidentë, ministra? Nuk është kjo ajo çfarë dua të të nënvizoj unë i huaji, si një qytetar i botës, për shkrimtarin tuaj të madh dhe njëherësh tonin, Kadarenë. Ka një kontradiktë që ju bën qesharakë. Nuk mund të rrijë një shkrimtar i madh në lëkurën e një

njeriu të vogël!? Një shkrimtar i madh është njëherësh një njeri po aq i madh. Nguliteni këtë njëherë e përgjithmonë në vetëdijën tuaj të lodhur. Mirëpo ka gjasë që ju të mos çlirohëni lehtë prej sindromit të biografisë, vijon ai “zëri” nga jashtë. Për një gjysmë shekulli keni bërë biografinë e njëri-tjetrit me një zell të madh, atë bëni dhe sot dhe ku ta gjenit një “peshk të madh” si Kadarenë që t’ia numëronit një më një të gjithë mëkatet



Një ëndërr dimri me Ismail Kadarenë

Nga Enver Kushi

Është ditë. Një ditë ëndrre si përtej kohës, ose në një kohë pa kohë. Shoh Bashkim Kuçukun me një pirq librash përpara. Ai më zgjat një prej tyre. Libri duket pak i vjetër, por shumë voluminoz. Ca të tjerë, që nuk ua dalloj fytyrat afrohen tek Bashkimi. Unë ulem në një karrike, ku në krah është Ismail Kadareja. Në krahun tjetër shoh Thanasi Dinon. Kadareja duket i ri dhe me fytyrë të qeshur, që i shkëlqen. Edhe flokët i shkëlqejnë. Flokët e tij më duken të kafejta, nga ku shfaqet një lloj drite e çuditëshme. Edhe Thanasi është me flokë. Përballë tavolinës tonë dalloj Bashkim Kuçukun dhe të tjerë ulur, që nuk i identifikoj kush janë. Pak më tutje, dy djem adoleshentë, të gjatë ngjajnë shumë me Kadarenë dhe duken si binjakë. Ata luajnë të shkujdesur. Në ëndër më shfaqen konturet e Atriumit të Muzeut Historik Kombëtar, ku në një kënd të tij, duken qartë gurët dhe porta në formë harku, marrë nga Çuka e Ajtoit. Në një nga këto gurë, ulur në të, duket Helena Kadare dhe pak më tutje Bujar Hudhri. Bashkim Kuçuku ngrihet dhe ua bën me dorë, që të afrohen, ku jemi ulur ne. Pastaj Prof. Kuçuku më drejtohet mua që të flas për librat e tij. Ngrihem dhe shoh se nuk kam asnjë letër, ku të kem shkruar ato që do të flas. Megjithatë, them se Kuçuku do të thotë “i vogël” dhe shtoj se Bashkimi ka një mal të tërë me libra dhe se ai është nga Konispoli dhe se nga ky qytet duket Çuka e Ajtoit, se ai... harroj emrin e Muhamet Kuçuku Çamit. Pastaj përmend Hasan Tahsinin dhe diçka për Çamërinë time, që shtrihet përtej hapësirave të Konispolit, tregoj diçka për ndarjen e kufijve, sesi atëhere, kur u nda një fshat dhe banorët komunikonin mes tyre me këngë. Vështroj portretin e Kadaresë dhe dy djemtë adoleshentë, që i ngjajnë shumë Kadaresë, që vazhdojnë të luajnë. Helena qëndron te gurët e Çukës së Ajtoit. Edhe Bujar Hudhri është aty. Ulem në karrike dhe ngrihem prapë në këmbë. Kadareja me fytyrën si prej drite, ndjek me vëmendje ato që them. Janë fjalë pa lidhje logjike, që herë përmend Kadarenë dhe Çamërinë, pastaj Bashkim Kuçukun. Pastaj Bujarin, pastaj ulem e ngrihem prapë. Dhe kur ngrihem kthehem nga Kadareja dhe i them se nëna ime, kur ka kaluar kufirin në Qafë Botë, mbante mend një re të bardhë, shumë të bardhë, që e shoqëroi atë dhe familjen e saj, derisa arritën në periferi të fushave të Kavajës, pastaj ajo iku, iku siç ikin retë dhe ne mbetëm në dheun e Kavajës, pa renë e Çamërisë. Kadareja ngrihet në këmbë dhe më përqafon. Më mbetën në mend sytë e tij të qeshur dhe veçanërisht fytyra tërë dritë e tij. Dal nga ëndra dhe nder dritën. Ora është 6 e 50 minuta dhe dita quhet e mërkurë. Dhe muaji shkurt. Dhe data është 12. Ngrihem dhe i hedh menjëherë në letër këto copa ëndrre. Dal në ballkon dhe shoh qiellin gri, shumë gri. Dhe më vijnë në mend ca vargje brilante të Kadaresë për qiellin e Tiranës, si tru idioti.

Tiranë, 12 shkurt 2025

e detit. Por jeni ju të gabuar, ngaqë jeni të ideologjizuar deri në palcë. Ju duhej të dinit se ndërsa Kadare shkruante “Dosjen H”, duke shtegtuar nëpër gjurmët e dy studiuesve amerikano-irlandezë, që në vitet ’30 të shekullit të kaluar endeshin në Alpet shqiptare, në kërkim të bardëve të fundit të eposit të kreshnikëve, në labirintet e errëta të sherbimit sekret shqiptar gatuhej dita-ditës “Dosja K”, që nuk kishte asgjë homerike. E nuk do të ishte rasti i parë në historinë totalitare të Europës kur një shkrimtar do ta shpëtonte “llogaria” e famës, pushteti më shumë fitonte apo humbte me martirizimin e tij?...

Kadare është cilësuar nga të huajtë si “rapsod i Europës” dhe kjo ka logjikën e saj, edhe pse dihet se ai ishte një shkrimtar modern dhe jo një rapsod. Por në fillim ishin rapsodët ata që e qitën katundin e tyre përtej malit tjetër, me fjalët dhe zërin e tyre mbi lahutë. Pastaj përtej nëntë maleve, në popuj të tjerë ballkanas e europianë. Ideali i tyre ishin kreshnikët, që përballëshin në një mënyrë apo në një tjetër me kralitë. Kjo ishte dhe saga moderne kadareane, me romanet: “Kështjella”, “Dimri i Madh”, “Koncert në fund të dimrit”, “Ura me tri harqe” etj. Ky “rapsod” i madh bashkëkohor i përcolli Europës baladat shqiptare të besës dhe ringjalljes së njeriut për shkak të saj - romani “Kush e solli Doruntinën”, siç pëmes “Prillit të thyer” evokoi kanunin e shqiptarëve, as pa e glorifikuar si në të kaluarën e as pa e denigruar siç ishte vija politike e kohës. Ndërkohë që “Pallati i Ëndrrave” ishte mënyra se si shkrimtari e pau botën, pa ëndrravrasës të asnjë stine. Përmbledhur në një fjalë të vetme, merita e shkrimtarit është se shkroi letërsi të lirë të nivelit evropian në diktaturë. Gjuha e magjishme e shkrimtarisë, stili i tij thellësisht origjinal dhe kreativ, optika dhe opusi krijues i pazakontë, përqeshja e marrëzisë së botës etj. e bëjnë Kadarenë të parë mes të parëve të letërsisë botërore. Ai iu qas me germa të mëdha dhe me një metaforë sipërore të vetmit fenomen letrar shqiptar të shekullit XX, që ishte Migjeni, duke e quajtur “uragani i ndërprerë”, çka e lartëson personalitetin e tij, ashtu si esetë (sprovat) kushtuar Dantes, Shekspir etj.

Lexuesi shqiptar, jo ai i ri, ka një marrëdhënie të veten me këtë shkrimtar qysh nga fëmijëria, si me asnjë tjetër, ia ka lexuar poezitë e romanet, ka folur për to në shkollë, ka shkruar në shtypin letrar etj. Një bashkërrugëtim i gjatë me shkrimtarin, që kur në duart e mësuesve të tu shihje romanet e tij të sapobotuar në mijëra kopje, si “Kështjella”, “Kronikë në gur” etj. Më vonë jemi përpjekur dhe ne ta themi ndonjë fjalë për veprën e tij., romanin “Prilli i thyer”, librin me novela “Tri këngë zije për Kosovën” etj.

Qysh herët, në poezinë “S’lindëm ne princa”, Kadare do të shkruante: “Dhe ne të gjithë jemi / Drurë të mbjellë në udhëkryqet e historisë”. Dy vargje që të bëjnë të mendohesh thellë, drurë të drejtë dhe drurë të shtrëmbër në një barrë, drurë që kalbën dhe drurë që bëhen eshkë për të ndriçuar netët, drurë - rrape shekullorë dhe drurë - shkurre përtokëse. Të gjithë në udhëkryqet e historisë, ndërsa kujtesa e saj ka punë vetëm me “drurët” përrallorë të pavdekësisë.

Edukimin e parë estetik, deri brezat tanë, E kanë marrë nga kënga popullore në fëmijëri- adoleshencë. Ai ishte arti i parë në kohë, gjithashtu, parësor në formim. Edhe gëzimin kolektiv po prej tij e kanë mësuar ta përjetojnë. Duke kënduar dhe vallëzuar bashkë shprehnin njëherësh të njëjtat mendime dhe emocione të përbashkëta. Krahas kënaqësisë të të kënduarit e të vallëzuarit kishin edhe kënaqësinë e njësimi me njëri tjetrin, të mbështetjes e veprimi të përbashkët. Në vogëli jam mëkuar me këngën popullore çame, sidomos të grave, në dasma, që më merrte nane Nini (Ferideja) me vete. Këngët, që këndonte ajo, me shoqet, ishin veçanërisht të bukura, se kishin bukurinë dhe ndjeshmërinë e saj. Edhe fustani, tumanet, pelshiu, skarpinat, që vishte ishin më të bukurat. Edhe vasilikoi, manxurani erëmirë, që fuste midis rrobave të veshura. Dy këngët e njohura *Moj bejka konispolite* dhe *Zura një mike suljote* më kanë shoqëruar gjithë jetën. Meloditë dhe fjalët e tyre i kisha vazhdimisht në qenien time, më jehonin në vesh si porosi intime. Me kohë vargjet i harrova, veçse, dy-tre prej secilës këngë, nuk u fshinë nga kujtesa. I thoshja me vete, herë-herë, edhe i shqiptoja. Pas shumë vitesh kaluan në pjesën pasive të kujtesës, nuk i pëshpërisja më. Në vitet 1990-a, me gjallërimin skenik e mediatic të folklorit çam, përsëri kaluan në kujtesën aktive. I thoshja vargjet me vete, por nuk i dëgjoja askund të këndoheshin. Duke përsiatur për to, “zbulova” se *Moj, bejka konispolite* nuk ishte thjesht një këngë e zakonshme, as vetëm e bukur. Ajo mbartte vlerë të rrallë arti dhe etnokulturore, prandaj, duhej bërë e njohur për kënaqësi të dëgjuesve bashkëkohës, si dhe për t’u studiuar nga specialistë të fushave përkatëse.

Nga mungesa e tekstit të shkruar, me të cilin mund të provoja, në se kujtesa ime ishte e saktë, apo, më ishte shfaqur ndonjë shajni, pata një lloj krize psikologjike. Megjithatë, isha i bindur, se vargjet, që më vërtiteshin në mendje, ishin të njëmendëta:

Moj, bejka, konispolite,
festija treqint mexhite,
në beson/paçë Kristonë hiqe.

Vitin e kaluar, duke hulumtuar në veprën e Musine Kokalarit për një studim letrar, në radhën e këngëve, që ajo ka riprodhuar besnikërisht në prozën e saj, ishte dhe teksti, që nuk po e gjeja *Moj bejko Kondispolite*, në motërzimin e Gjirokastrës:

Moj bejko Kondispolite

Moj si zez’ e kaço-prerë
Siri jot një lir’ e verdhë
Faqija si koqe-mollë
Del në penxhere si zonjë
Tek potis vasilikonë.
Dil në penxhere nga udha
Me di qelqe si kushulla
Si kushulla e Stambollit
Bejk’ e malit Kondispolit.
Moj bejko Kondispolite
Në feste treqint mexhide
Varur ballit kriqe kriqe
Në beson Kristonë hiqe
Hiqe moj se na shalltise.

(Musine Kokalari ...*sa u-tunt jeta*, Tiranë, *Mesageritë Shqiptare*, 1944, faqet 112-113; marrë nga Musine Kokalari *Vepra e Zgjedhur 2*, botim anastatik i përgatitur nga Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, Tiranë, 2017, faqe 112-113.)

Pas kësaj, rishfletova tërë këngët çame të botuara. Teksti i saj, në një motërzim tjetër, është edhe në librin e Fatos Mero Rrapajt *Këngë popullore nga Çamëria*:

- Kënga popullore *Moj bejka konispolite* -

ARI I RIGJETUR I NJË KËNGE ÇAME

Nga Bashkim Kuçuku

Bejkë e malit Konispolit

Dolli, more, shokë dolli,
bejkë e malit Konispolit,
me takëmet e Stambollit.
Moj, bejka konispolite,
në feste treqint mexhite,
varur ballit kriqe-kriqe,
vëthëtë me biziliqe,
hap sepetetë me kliche:
vish rrobat arhondëriçe.
Vishi, mos i griç pëllua,
se ma plase zemrën muat.

Filat, Tiranë, 1960

(Fatos Mero Rrapaj *Këngë popullore nga Çamëria*, botim i dytë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2019/1983, faqe 210.)

Një motërzim tjetër është në librin me këngë popullore, mbledhur nga Ibrahim D. Hoxha:

Moj bella konispolite

Moj bella konispolite,
në feste treqint mexhite
vartur ballit kriqe-kriqe,
sikur je bilë zabite.
Hine në divan si qiçe,
hane senetet me kliche,
tërë poshe stambollite,
kaçibash anadollçe
mexhite-mexhite,
në beson Hristonë hiqe,
mënt e kokësë m’i prishë.

(*Bilbila dhe thëllëza çame*,

mbledhur dhe përgatitur nga Ibrahim D. Hoxha, Botimet *AIITC*, Tiranë, 2007, faqe 297.)

Në këtë libër, vite më parë, kisha vënë përbri shenjën për t’u rikthyer. Ishin vargjet, që kërkoha, por i kisha harruar, që i pata lexuar dhe ishin diku.

Dy vjet të shkuara, specialisti i kulturës në Bashkinë e Konispolit, nisjator e organizator i veprimtarive folklorike, Vangjel Taho, më pati dërguar *Bejkë e bardhë e Kondispolit*, të regjistruar në disk, nga këngëtari Neço Muko me këtë tekst:

Bejkë e bardhë e Kondispolit

Dolli, dolli, shokë dolli,
dolli veshi [?] dhe Stambolli
veshi vendi [?] dhe Stambolli
Bejkë e bardhë e Kondispolit.
Moj, bejka kondispolite,
festija treqint mexhite,
vartur ballit kriqe-kriqe,
në beson Kristonë hiqe.

(Regjistruar në disk, në Paris, 1929/1930, nga këngëtari i njohur himariot Neço Muko në bashkëpunim me Tefta T. Koçon. Kënduar nga grupi i Himarës. Marrësi është Neço Muko. Hulumtues i diskut dhe i shpërndarjes në rrjet, studiuesi Niko Kotherja.)

Dhe një motërzim tjetër, që ka mbledhur dhe publikuar poeti dhe studiuesi Timo Mërkuri:

Konispolatja

Doli more shokë doli
Bejk’ e bardh’ nga Konispoli

Doli more shokë doli
Bejk’ e bardh’ nga Konispoli

Moj bejka konispolite
Nën shami ke gjasht’ mexhite

Moj bejka konispolite
Nën shami ke gjasht’ mexhite

Moj në beson në Krishtin hiqe
Të të shoh dritën e syve

Moj në beson në Krishtin hiqe
Të të shoh dritën e syve

Moj në beson Krishtin besomë
Të të jap dy napolonë

Moj në beson Krishtin besomë
Të të jap dy napolonë

Moj dy napolona të verdhë
Flori të gushës u derdhnë

Moj dy napolona të verdhë
Flori të gushës u derdhnë.

Timo Mërkuri *Vajz*

e valeve, *Milosao*, Sarandë, 2017, faqe 155.

Ja, pra, vargjet e ruajtura në kujtesë nga fëmijëri-adoleshenca ishin të njëmendëta. Kënga, është, së paku, në pesë motërzime. Njëri i kënduar e i regjistruar në Konispol, në vitet 1960-a (?), tjetri motërzim i Filatit, regjistruar në Tiranë, po në vitet 1960-a. Motërzimi i Gjirokastrës është shkruar më 1944, i Grupit të Himarës, kënduar e regjistruar më 1929/1930. Motërzimi i regjistruar dhe i publikuar nga poeti dhe studiuesi Timo Mërkuri, nga zona e Himarës, më 2017. Kohësia e të kënduarit të saj, sipas këtyre motërzimeve, është afërsisht 90 vjet. Një “e tanishme” 90-vjeçare kaq aktive, hap horizontin e shtrirjes në të kaluarën, në historinë e saj disa herë më të madhe. Hapësira e qarkullimit ka qenë prej Konispolit, në Filat, Gjirokastrë e Himarë. Nuk mund të thuhet, se cili është mëma, dhe cilët janë bijat. Tekstet kanë ndryshime në sasinë dhe llojin e fjalë-figurave, përzgjedhjen, theksimet, për rrjedhojë, edhe në ngritjen e zbutjen emocionale të tyre. Të përbashkëta dhe kryesore, në katër prej tyre, që përbëjnë dhe thelbin e saj, janë: madhërimi i shëmbëlltyrës së femrës, bejkës konispolite, dhe lutja përgjëruese e kënduesit, që, ajo, ta heqë festën nga balli, me stolitë e shtrenjta në formën kriqe-kriqe/kryqe-kryqe/. Arsyeya përse i lutet, lihet të kuptohet në mënyra të ndryshme. Ose, t’i duket tërë bukuria, se festija ia



mbulon, ose, ta heqë, sepse, e zbukuron tej mase, pa përballeshëm, aq sa kënduesi thërret në ndihmë besimin e saj te Krishti për t’ia lehtësuar vuajtjen prej bukurisë së saj.

Vargjet janë një perlë e rrallë arti, në të cilët është shkruar e ngurtësuar një pikë ari, i pazhbëshëm:

festija treqint mexhite,
vartur ballit kriqe-kriqe,
në beson Kristonë hiqe.

Ari është hershmëria, ruajtja e shenjave të identitetit fetar të krishterë të krijues përpunuesve të parë, dhe përcjellja në breza, deri në kohët moderne të shekullit XX. Edhe pse në to janë fare të qarta dhe të forta, të shqiptuara me zë, shenjat e identitetit fetar të katragjyshëve tanë të krishterë, kënga ka pasë qenë kënduar dhe vazhdoi të këndohej një lloj, pa asnjë kompleks faji a mëkati, edhe kur pasardhësit e tyre, konispolatët, ishin kthyer në myslimanë. Për këto, është dhe dukuri historike etno-kulturore qindrvjeçare, me vlerë për studimet antropologjike, psikologjike dhe psikanalitike.

Kënduesi, sikurse e njëjtëson konkretisht, ka parasysh fshatin/çytetin e Konispolit, madje theksohet, duke u shqiptuar dy-tri herë. *Moj bejka konispolite*, nisur prej të dhënave tekstore, do të jetë krijuar shekuj më parë, kur konispolatët ishin të krishterë. Atëherë, kënduesi dhe e kënduara ishin të dy të të njëjtit besim, dhe, poezia ishte në përputhje e harmoni me kontekstin shoqëror, kulturor e fetar, që e pati përfutur. Mirëpo, banorët e tij, prej disa shekujsh nga të krishterët qenë kthyer në myslimanë muhamedanë. Vajza, së cilës i kushtohet, bejka konispolite, njëmendësisht nuk besonte më te Krishti dhe nuk mbante kryqe. Besonte te Muhamedi. Shkonte për t’u falur në xhami a falej në shtëpi, e kthyer nga Qibleja. Mbajtja e kryqit dhe e zbukurimeve me formë kryqi, simboli i krishterësisë, ishte e papranueshme dhe e dënueshme. Kënduesit, apo, këndueset, sipas motërzimeve të regjistruara, ishin dhe mund të ishin të krishterë e myslimanë. Vajza, në poezi, mbeti gjithmonë krishterë, ndërkohë, që, në Konispol nuk kishte më të krishterë. Mes kësaj mospërputhjeje të identitetit fetar të shëmbëlltyrës poetike të këngës, që mishëron të krishterën, me identitetin fetar të vajzës konispolate në përditshmëri, që ishte myslimane, është përcjellë në breza e në shekuj. Me mospërputhje të tillë e kam dëgjuar dhe unë në fëmijëri-adoleshencë, në vitet 1950-a, ende pa e ditur çfarë ishte Krishti, as Muhamedi. Më pëlqente shprehja e vargut *në beson Kristonë hiqe*, që, më shpesh, thuhej *në paçë Kristonë hiqe*, ngjashëm me shprehjen e të folurit të përditshëm

në beson në Perëndi, në paç Perëndinë. Më habiste nga që nuk e kuptoja. Më ngjante sikur i drejtohej ndonjë Kristoje ortodoks nga Mursia, Çifliku, apo, Sopiku, fshatra aty afër, që vinte në Konispol. Pyeta nënën. Ajo nuk dinte si të më përgjigjej, i ra shkurt: “Kështu e ka kënga”. Më i rritur, pyeta nja dy gra mike të familjes. Dhe ato më dhanë po atë përgjigje: “Kështu e thotë kënga”. Dukej, se, për to, rëndësi kishte, që i këndohej aq bukur e madhërishtëm konispolates me të cilën njëjtësoheshin gjatë të kënduarit e të dëgjuarit. Njëlloj ndodhte edhe në dasmat gjirokastrite të familjeve myslimane, aq më tepër në familjet e krishtera. Një gjirokastrite që dhe Musine Kokalari, që e ka regjistruar, si pjesë të repertorit të dasmave të qytetit të saj. Gjithë dasmorët, në shtëpitë dhe familjet e tyre, të të afërmeve e të fisit, të fqinjëve dhe të miqve këndonin dhe dëgjonin vargjet, që i kushtoheshin një të krishtere, besimit të Krishti, duke qenë vetë myslimane dhe myslimanë. Lirshmëria/toleranca shkonte dhe më tej. Gjedhen e saj konispolate, që më është ngulitur në kujtesë, e kam dëgjuar në dasmën e Halit Alushit, djalit të një hoxhe nga Konispoli, Mehmet Alushit, dasma çame më e plotë dhe më mbresëlënëse, që kam përjetuar. Mehmet Alushi ishte mjaft i nderuar. Fliste pak dhe vetëm me burra të tjerë të respektuar. Për vizita në shtëpi, edhe te njerëzit e vet më të afërt, shkonte rrallë. Ishte i shkolluar, kishte mbaruar medresenë në Tiranë. Krahas teologjisë, kishte formim kulturor të një shkollë me programe klasike. Njihte dhe kishte dëshirë të fliste për historinë e ilirëve, Romës dhe romakëve, figura dhe ngjarje të historisë së shqiptarëve. Natyrisht, ai e dinte cili ishte Kristua/Krishti, që i këndohej në shtëpi, në dasmën e djalit të tij të vetëm. Forca e traditës, mendësia absolutizuese e pandryshueshmërisë së gjedhes së trashëguar, pavetëdija kolektive (Jung), ka pasur epërsi mbi vetëdijen e besimit fetar të mëpasëm.

Motërzimi poetik, i përpunuar nga Neço Muko, krahasuar me motërzimet e tjera, ka kaluar në një përzgjedhje të hollë. Janë hequr jo pak fjalë, duke ruajtur thelbësoret, ato, që, përzgjedhësi i ka menduar të domosdoshme. I përshtatur edhe me mënyrën e të kënduarit me iso, në këtë rast, analiza do të duhet të përfshijë

të dy përbërësit, tekstin dhe mënyrën e të kënduarit, që e ka zhvilluar atë ndjeshëm. Ritmi i isos, theksimet emocionale nëpërmjet përsëritjes së fjalë-figurave të caktuara i kanë pasuruar domethëniet, të cilat shpërfaqen me ndriçime kuptimesh sipas stilit të interpretimit të tij mjeshtëror. Fjalë-figurat zotëruese, janë: *dolli, bejkë e bardhë, bejka kondispolite, beson, Kristonë, kri-kriqe*.

Fjalë-figura *dolli*, e rimarrë 15 herë, që në vargjet e para, e paraqet daljen e bejkës konispolite, të bukurisë së bardhë si ngjarje kozmike, sikur dielli të mos ishte dukur prej kohësh, dhe ridoli sërish. Metafora është mbështetur intuitivisht te shprehja e të folurit të përditshëm *doli dielli*, kur mezi pritët pas një moti të zgjatur me shi, mjegull, a dëborë. Dalja (*dolli*, e përsëritur 15 herë), shfaqja, të parit e saj prej djalit, është më e rëndësishme se sa bukuria e bejkës së bardhë, bejkës konispolite (përsëritur 8 herë). Vajzat, me normat morale të shoqërisë shqiptare tradicionale, bënin jetë të mbyllur dhe komunikonin me fare pak njerëz, të afërt e fqinj. Dalja, të shfaqurit e saj ishte ngjarje për djemtë. Këtë rrethanë jetësore Neço Muko e ka dramatizuar dhe poetizuar në kullm, e ka shndërruar në kuadër filmik. Horizonti i pritjes, i kuptimit dhe i interpretimit është i gjerë dhe i hapur. Njoftimi për shokët, *dolli, dolli, shokë dolli*, le të kuptohet, se djali e dinte që do të dilte, madje, mezi e priste bashkë me shokët. Mezipritja e tij është shkaktuar nga pritja e gjatë, me orë e ditë, ndoshta, muaj, ndërsa, ajo, nuk ka dashur, apo, nuk ka mundur të dalë. Fjalë-figura *beson* (Kristonë) ka një barazrimarrje, sa fjalë-figura *bejkë e bardhë* (8 herë). Numerikisht janë të barabarta, prej nga mund të arrihet në përfundimin, se *bejka e bardhë* /bukuria vet, dhe *besimi* i saj/*beson* (në Kristonë) poetikisht dhe muzikalisht janë, thuajse, të njëvlershme. Vajza është tepër e dashur dhe e çmuar për kënduesin, sa e ngre në shkallare sipërore. Bukuria e madhe, bëmat e saj ndalen vetëm para besimit të Krishti, prandaj, i lutet, që, në emër të tij, ta heqë festen.

Në pjesën e parë të këngës zotëron bukuria e madhe e bejkës dhe shfaqja e saj në sytë e djalit. Në pjesën e dytë, numerikisht, me fjalë-figurat, merr përparësi e zotëron besimi të Krishti. *Beson/besimi* (8 herë), *Kristonë* (5 herë),

kriqe-kriqe, simbol i Krishtit dhe i besimit tek ai (4 herë), janë një sistem harmonik prej 17 njësisish figurative të rimarra për të theksuar emocionalisht domethëniet, që mbartin.

Ky tekst, i përzgjedhur, dhe, me këtë mënyrë të kënduari, duke theksuar, gati, njëlloj bukurinë e madhe të vajzës dhe besimin e saj, ndoshta, është më i përshtatshmi dhe më i natyrsimi nga motërzimet, që kemi parasysh. Neço Muko me intuitën folklorike, sikur ka arritur në rrënjët e hershme të këngës, kur edhe konispolatët, ose, fqinjët e tyre, krijuesit e saj të mundshëm, ishin të krishterë. Dhe, me mjeshtërinë e vet, sikur ka zbuluar atë që paraardhësit krijues-përpunues të hershëm, kanë dashur të shprehnin në kohën e vet. Të krishterë kanë pasë qenë edhe pjesëmarrësit e grupit të Himarës, prandaj, kanë arritur të hyjnë në thellësi të këngës dhe të atij besimi, që e ka përfutur. Një mendim i tillë nuk është vetëm me arsyetim/deduksion. Mbështetet dhe me të dhëna konkrete. Në tekstet e motërzimeve të tjera, zakonisht, të mjedisëve myslimane (Konispol, Gjirokastër) zotëron bukuria e femrës. Fjalë-figurat, që janë ndjeshëm më shumë, se në motërzimin e Neço Mukos, zhvillojnë edhe më paraqitjen e bukurisë. *Beson në Kristonë* është përbërës dytësor, zgjidhja, ndihma që pret t'i japë për të përballuar bukurinë e saj. Zbritja në shkallare dytësore është rënie, tkurrje e domethënies, zbehje e funksionit, shndërrim i hershmërisë në rudiment. Vet të dhënat tekstore shpien në përfundimin, se, kënga *Moj bejka konispolite* është e hershme, para islamizimit të Konispolit. *Vargu në beson Kristonë* ka mbetur prej atëherë pjesë e saj, i kthyer në rudiment nga mostheksimi prej kënduesve myslimanë, pasi, nuk përputhej me besimin e tyre.

Kënga, e njohur në gjithë Jugun shqiptar, edhe tej kufirit politik të sotëm shtetëror, në Çamërinë matanë, që madhëronte konispolaten, ka qenë e përhershme në repertorin e dasmave dhe në mjediset intime familjare, por nuk doli asnjëherë në skena festivalesh, as krahinore dhe as kombëtare. Edhe pa u prishur me dhunë institucionet fetare dhe ende pa u ndaluar feja me ligj, botëkuptimi zyrtar marksist fenë e quante opium për popullin. Vargjet me lutjen për t'i ndërmendur vajzës besimin të Krishti,

që mungojnë në motërzimin e Filatit, do t'i ketë hequr censura e fanatizmit islam.

E mbetur në kujtesën e atyre brezave, dhe e hedhur në letrën e disa librave e në disqe, të papërdorshëm, veçse nga ndonjë qëmtues profesionist, edhe sot, nuk këndohet në dasma e nuk është ngjitur në skenë, madje, në Konispol është harruar fare. Vështirë të gjendet, edhe ndonjë e moshuar, që ta riprodhojë plotësisht tekstin e melodinë e saj.

Kënga tjetër, e përhershme në dasma dhe gëzime familjare e shoqërore, e parapëlqyer edhe prej meje, në fëmijëri-adoleshencë, ka qenë *Zura nja mike suljote*, në të cilën, përsëri vajzat e gratë myslimane, burrat i këndonin suljotes së krishterë. Kjo ka, gjithashtu, historinë e vet të përcjelljes në shekuj, si dhe të fashitjes së saj, për arsye, kryesisht, politike, me qenë se Suli, suljotet, suljotët, dhe shqiptarët e tjerë ortodoksë në Çamëri, mbetën matanë kufirit shtetëror shqiptar. Politika e atëhershme, bashkë me mendësitë kufizuese, që kishte përfutur, arsyetonte, se, përmendja e Çamërisë, mund të merrej si mëtim për “ndryshimin e kufijve”. Me bukurinë e artit dhe vlerën e çmuar etno-kulturore, meriton të kthehet në repertorin aktiv të festave, festivaleve dhe në gëzimet familjare, sidomos të bashkësisë së çamëve, kudo që janë.

Zura një mike suljote



Zura një mike suljote
naze, lajka puna jote,
mes-holla posi njanjote,
naze, nashka puna jote,
leshverdha si kalviqote.

Naze, nashka puna jote,
u desha ja motë-motë,
motë-motë një gjisëm viti,
se ç'u deshëm njeri s'na diti.
Dhe një plakë që na diti,
dhe ajo s'na martërisi!
Në Xhenet i vaftë shpirti!

Rrëfim nga Fato Balani (Purrizo), 26 shkurt 2019.

(Arkivi i Aranit Balanit, studio *Balani*, Sarandë. Dhënë nga Vangjel Taho, nisjator dhe organizator i veprimtarive folklorike e kulturore, Konispol.)

Tiranë, tetor 2024



1.

«Nata e qeje» e shkrimtarit, Primo Shllaku, thellohet në një zbulim surreal dhe introspektiv të jetës, dëshirës, kujtesës dhe vdekjes. Pa u konfrontue hiç, nëpërmjet skenave të shumta të ndërlydhuna me personazhët, autori i shpie lexuesit në një hapësinë ku temat ekzistenciale përzihen me takime thellësisht personale, të gjitha të ngjyrosuna me një ndjesi tragjike. Mbase edhe të përmallshme.

Në zemër të tregimeve qëndron një zbulim i thellë i mungesës - si fjalë për fjalë ashtu edhe metaforik.

Temat që autori i ka shtjellue, rrezonojnë me rryma të thella emocionale.

Një vdekje jo e shëmtuete, një ritakim me ish tëdashunën, një gjeneral që e ka humbë shpresën për një vdekje "dinjitoze" në fushën e betejës, një vepër pa autor, një stjuardesë e përvujtun në tokë dhe një kujtim i brishtë i fëmijënisë kanë krijuar një portretizim të nuancuem të ndjeshmënisë njerëzore dhe konfliktit ekzistencial.

Duke na sjellë situata me imazhe krejt konkrete ku përplasen përvojat njerëzore, autori ka krijuar gjashtë rrëfime komplekse, me na ofruar një portretizim bindës të përpjekjes së individit për të gjetë kuptimin mes kënaqësive kalimtare të jetës dhe humbjeve të pashmangshme.

Libri me novela «Nata e qeje» na sugjeron se ndërsa kënaqësitë mund të jenë kalimtare, ato gjithësi e kanë potencialin për me na pushtue, qoftë edhe vetëm për pak, vetëm për shkurt.

Nëpërmjet tij, mbase edhe me një angazhim krejt të patëkeq, autori i shtyn lexuesit të përballen me dëshirat, humbjet, mungesën, frikën dhe keqardhjet e tyre, duke i lanë në fund të mendojnë se, nëse janë në qiell, në kujtesë apo në përfaqimin kalimtar të tjetrit, qoftë edhe për fare pak, ta rrokin çastin dhe të gjejnë një rast paqeje brenda vetes.

2.

«Xhelati i mbretit»

Tek tregimi i parë «Xhelati i mbretit» autori e portretizon vdekjen me solemnitet:

"Deka s'asht kurgja, Faik djali, deka asht kapak florini, por gjuha e dalun e shpotia e miletit, e katundit. Ky asht hall për burra..." (fq. 13)

Kjo lutje, ky përshkrim shërben si një kujtesë e fortë jo vetëm e shqetësimit të natyrshëm për vdekjen, por edhe për pamjen, dukjen e personazhit në këtë rast, mbas aktit të vdekjes. *"Për burrin s'asht gja ma e hokubetshme e ma e pështirë se me ndejtë i vjerrun në konop me gjuhë jasht faqe miletit, e shtunë e ditë pazari... Edhe i dekun, edhe i koritun. Mozomakeq!" (fq. 20)*

Vdekja, tek «Nata e qeje» nuk asht një çlirim paqësor, por një realitet shqetësues dhe i pashmangshëm që ndërhyr në përpjekjet e personazheve për t'i shpëtue kufizimeve të ekzistencës njerëzore.

«Xhelati i mbretit» asht një tregim moralizues.

Morali i mospranimit të diçkaje që nuk na përket, na mëson randësinë e integritetit, ndershmënisë dhe respektit për pronën e të tjerëve. Duke u përmbajtë nga marrja e asaj që nuk asht e jona, ne tregojmë se vlerësojmë drejtësinë dhe njohim kufijtë midis zotimeve tona dhe të tjerëve. Ky parim ndihmon në ndërtimin e besimit në marrëdhëniet tona dhe pasqyron një ndjenjë të fortë karakteri. Duhet disiplinë për t'u largue nga gjanat që mund t'i duam, por me të drejtë, ato nuk janë tonat.

" - Unë nuk i pashë, Haxhi ata djemtë, por më thanë se gjithçka ishte në rregull..."

Po, po, por unë nuk ia kreuva punën. Deri sa u doli shpirti, gojën e mbajtën mbyllun e dhambët e tyre krisnin si me qenë tue blue hekur... Nuk e pata rrisk...

Primo SHLLAKU, "Nata e qeje", Botimet Onufri, Tiranë, 2024

NJI ZBULIM SURREAL DHE INTROSPEKTIV TË JETËS, DËSHIRËS, KUJTESËS DHE VDEKJES

Nga Vlora Ademi

Dhe nxori prej xhepit një shami të vogël të bardhë të qendisun vajzënisht e me xhufka ngjyra-ngjyra. E shpëstolli dhe në banak u hapën shtatë monedhat e arit.

-Ti din ku me e gjetë. Këto pare nuk janë të miat... (fq. 30)

Kur shmangim pranimin ose marrjen e asaj që u takon të tjerëve, na parandalojmë që ndjenjat e fajit, turpiti ose shqetësimit të errësojnë jetën tonë. Ky moral na kujton se përmbushja dhe lumtunia e vërtetë vijnë nga fitimi i asaj që kemi nëpërmjet përpjekjeve tona dhe jo nëpërmjet mjeteve të pandershme. Ajo përforcon idenë se karakteri vlen më shumë se çdo përfitim material dhe se një ndërgjegje e pastër është një nga gjanat ma të vlefshme që mund të zotënojmë, qoftë edhe nëse mbi supë e mbartë nofkën- xhelat. Në një kuptim ma të gjanë, respektimi i asaj që nuk na përket promovon një shoqëni ma etike dhe ma të dhembshun, ku njerëzit ndihen të sigurt dhe të vlerësuem.

3.

«Nata e Qeje»

Mungesa shpesh shërben si një temë prekëse në letërsi, duke e simbolizue humbjen – qoftë fizike, emocionale apo edhe ekzistenciale. Portretizimi i mungesës ngjallë nostalgji dhe mall. Tevona, ajo bëhet një hapësinë ku personazhët përballen me atë që dikur ishte e pranishme, shpesh duke çue në reflektime mbi identitetin dhe ndikimin e atyne humbjeve në jetën e tyne.

Kjo temë mungese manifestohet përmes ritakimit, mbase të rastësishëm, të protagonistit me ish-të dashunën, Vjollcën – Violetën.

Ndarja, pritja e pavetëdijshme dhe ribashkimi i shkurtë vetëm për një natë, nxjerrin në pah zgavrimin emocional që koha ka gdhendë mes tyre. Takimi, megjithatë, nuk arrin me e zgjidhë këtë mungesë. Përkundrazi, e intensifikon atë.

Një takim i vonë me ish-të dashunën



reflekton me kompleksitet emocional. Takime të tilla mund të nxisin ndjenja të pazgjidhuna, duke e shfaqë tensionin midis intimitetit të kaluem dhe pandjeshmënisë së të tashmes. Shpesh kjo zbulon nostalgjinë, keqardhjen dhe ndryshimet që sjell koha në marrëdhënie.

"Po mendoja sesi ajo vetëm ishte shëndoshë, se, për të tjerat, kishte mbetë e njajta. Gjoksi, kofshët vetëm se ishin rritë. Ndoshta edhe shpina e saj do të ishte e njajta... Më dukej një gja e çuditshme që njeriu mund të takohet, që mund të gjej shumë gjana si kanë qenë dhe shumë të tjera si janë ba mbas kalimit të njëfar kohe." (fq. 45)

Personazhët mund të përballen me atë që dikur kishin dhe atë që e kanë humbë, duke çue në një kuptim ma të thellë të vetes dhe të jetës së tyre aktuale.

"Kur e pash me një burrë tjetër, diçka më sëmboi në gjoks. Më erdhën menjëherë parasysh skenat e përbashkëta të jetës intime me Vjollcën..." (fq. 47)

Imazhet e një pengu mund të simbolizojnë ndjenjat e kurthit dhe pafuqisë. Mund të përfaqësojnë jo vetëm një situatë fizike, por edhe gjendje emocionale.

Tema e të qenit peng mund të përforcojë tensionet brenda një narrative, duke i detyruar personazhët të përballen me dobësitë e tyre dhe t'i orientoj drejt autonomisë dhe shërimit.

Tevona, autori nuk i shmanget as erotizmit, duke e përdorë atë për të eksplorue dobësitë dhe dëshirat ma të thella të personazheve. Skena erotike të «Nata e qeje» asht gati-gati një kriter i së vërtetës, një test vërtetues që zbulon mashumë sesa thjesht një intimitet fizik; kjo pjesë e novelës ekspozon një dëshirë të mbrendshme për lidhje, identitet dhe ndoshta shpengim.

"teksa përkulej, fustani i saj u hap tek gjoksi dhe iu varën poshtë dy gji të mëdhej që shifnin anash si dikur, por të randë e të fortë.


"Kështu i ka pasë edhe atëherë, vetëm se ma të vegjël", mendova. Atë natë kur i shkova në shtëpi, megjithë frikën e madhe që kishim, erdhi momenti që u dehëm dhe nuk na bante delli gjak. Ajo më la ta zhveshja për sipër. I Hoqa pa mundim fustanin, mandej sutjenin dhe e rrotullova nëpër duer. Gjoksit të fortë e kërcyes nga përpara, i përgjigjej nga mrapa një shpinë e drejt dhe e lugët, e vërgjillt dhe pa mish." (fq. 39)

Në tregimin e autorit, këto skena nuk janë thjeshtsensuale, por janë të ngarkuememe peshë ekzistenciale, duke vunë pikëpyetje nëse intimiteti fizik mundet me i mbushë me të vërtetë boshllëqet e krijueme nga koha.

Takime të tilla nxjerrin në pah si kalimin e kohës ashtu edhe ndryshimet në identitetin personal.

Morali i tregimit ban me kuptue se asht tentim i kotë me iu kthye një diçkaje të mbarueme apo humbun me kohë. Diçka që nuk na ka ra tamam njëherë, nuk ka me na ra tamam asnjëherë ma kurr!

Prandaj edhe në këtë rast, qeni e luen rolin e mbrojtësit. Qoftë edhe si një krijesë e rrezikshme për vrasësit. Qoftë edhe si shkas i ndërpremtjes të një akti intim n'kulmin e dehashpirtit.



PRIMO
SHLLAKU

Nata e qeje

OnufriNovela

"Të kaloja përmes atyne qejeve të ngordhun, trupat e pajetë të tyne tashti më dukeshin si kufoma çastesh." (fq. 69)

4. «Gjenerali»

Novela «Gjenerali» që flet për një gjeneral të pafat, m'përafroi me gjeneral Drogon e Dino Buzzatti-t të «Shkretira e Tartarëve». Në të dy tekstet kemi një gjeneral të dëshpëruem nga humbja e rastit për një vdekje të lavdishme, një vdekje në fushëbetje. "Mbasi të kesh vrrarë nja njiqind armiq, atëherë mund të vritesh edhe ti." (fq. 79) Por ky gjeneral nuk jeton iluzionin e lavdisë, ai e qan mungesën e provës së tij profesionale dhe në ngjitjen e fortë që ka me "komandantin", me tolerancën femnore që tregon ndaj kujtimit të tij, asht një arketip i sindromës së Stokholmit.

Karakteri i gjeneralit i shton kompleksitet temës së kujtesës dhe humbjes. Ndërsa përballet me amnezinë, gjenerali përfaqëson një peng figurativ të mendjes së tij, të burgosun nga fragmentet e pakapshme të së kaluemes. Humbja e kujtesës asht një humbje simbolike e identitetit, duke e reflektue tendencën njerëzore për t'u kapë mbas kujtimeve si spiranca në një realitet gjithnjë në ndryshim.

"Futja ime në burg kishte kuptim, komandant. Ti e dije mirë se po vuaja aq shumë dhe cili ishte shkaku i mërztisë time: jeta po më ikte dhe mua nuk po më jepej rasti të tregoja para teje aftësitë e mia si drejtues i një beteje luftarake." (fq. 83)

Në përshkrimin e tij, autori, Primo Shllaku, kujtesën e shndërron në një depo të brishtë dhe jo të besueme të identitetit, duke e lanë gjeneralin si një hije të vetes së tij të maparshme, të distancuem nga vitaliteti i rinisë dhe të bllokuem në një kujtim të fragmentuem të jetës.

Një gjeneral i vjetër i cili doemso tenton me e përfytyrue një komandant mbi veten, simbolizon brishtësinë e pushtetit dhe humbjen e identitetit personal.

Duke qenë dikur në kulmin e autoritetit të tij, gjenerali tani përballet me një krizë të thellë ekzistenciale ndërsa ndikimi i tij asht zbehë. Në veprën «Plaku dhe deti» të Ernest Heminguejt, lufta e një burri të moshuem për të provue vlerën e tij pavarësisht humbjes së forcës së tij të maparshme, ma së miri pasqyron gjendjen e randë të gjeneralit në tregim.

Një gjeneral i shtyem në moshë që vuen nga humbja e komandës dhe humbja e kujtesës, ofron një rrëfim të pasun që shëmbëllen kompleksitetin e plakjes. Damin psikologjik të pushtetit dhe dilemat ekzistenciale me të cilat përballen ata që njihëre e një kohë kishin ndikim. Nëpërmjet këtij personazhi, letërsia po shqyrton temat e trashëgimisë, identitetit, humbjes dhe kalimit të pamëshirshëm të kohës.

"Unë duhej të vdisja mepatjetër... Për atdheun dhe... -...për disa emra të përveçëm, - shtova unë pa e lanë me e mbarue fjalën." (po aty)

5.

«Se si vizita në një ishull të Jonit më mësoi me e pa trupin e zhveshun të një grueje...»

Vetëm një skenar i pasun mitologjik ose filozofik mund të përfshijë figurën e shkambit – si një simbol zavendësues - duke pasë një përvojë transformuese gjatë një vizite në një ishull.

Protagonisti i tregimit pëson një tronditje nga një vepër arti pa autor në ishull. Ky ishte një shkamb me përmasa të mëdha, porse simbas analizës së tij, ai i ngjante me trupin, apo ma saktësisht me pjesën e ijeve, kofshëve të së dashunës që e kishte përkrah.

Në artin dhe filozofinë e lashtë greke, trupi i grues shpesh festohej si një manifestim i bukurisë hyjnore, harmonisë dhe rendit.



Megjithatë protagonistin e tregimit asht i vetëdijshëm se edhe shkëmbin mund ta konsumonte koha.

Trupi i zhveshun i grues në formë shkambi në këtë rrugëtim simbolik, e kishte sfidue protagonistin të reflektojë aspektet ma të thella të qenies së tij. Takimi me trupin e të dashunës së tij mund të ishte një moment zbulimi ose zgjimi, por takimi me formën e papërpunueme dhe të pambrojtun të shkambit i mësoi atij diçka shumë ma të thellë – vetëm një trup lakuriq mund të simbolizojë të vërtetën.

Takimi i tij me trupin e gruas e kishte ndihmue atë me kuptue se asht e pamjaftueme vetëm forca fizike, duhej të kultivohej edhe mençunia, dhembshunia dhe thellësia emocionale. Kishte kohë që e kishte kuptue se trupi i grues, në këtë kontekst, mund të bëhej një enë për rritje shpirtënore, sesa veç adhurim.

" - Unë jetoj me të prekë ty... - Po pjesën tjetër të kohës çfarë ban? - Pjesën tjetër të kohës?... Pjesën tjetër të kohës rri e pres me të prekë..." (fq. 104)

Shkambi i kishte krijuar një tjetër ide – balancimin e forcës me butësinë, intuitën dhe pranimin.

"Po, dritë, po. Ajo asht vepër arti, por nuk ka autor. Kurse ti gjithsesi e ke autorin, por veç... nuk je vepër arti..." (fq. 109)

Në thelb, simbas përciptimit individual, ky tregim ka të bajë me të mësuemit për të pa përtej pamjes. Për t'u përballë me të vërtetat ma të thella të ekzistencës dhe për të pajtue aspekte të ndryshme edhe brenda vetes.

6.

«Stjuardesa»

Libri «Nata e qejeve» krahason gjithashtu profanen dhe të shenjtën, sakralen me literalen përmes dëshirës së stjuardesës Vivian, për t'u bashkue me murgeshat në një manastir, pas daljes së saj në pension. Kjo dëshirë e zjarrtë për përbushje shpirtnore bie në kontrast të fortë me përvojat sensuale dhe, edhe erotike që figurojnë në libër. Kjo dëshirë e zjarrtë për përbushje shpirtnore bie në kontrast të fortë me përvojat sensuale dhe, edhe erotike që figurojnë në libër. Tërheqja e saj ndaj idesë për me u ba murgeshë në një moshë mesatarisht të shtyeme, sugjeron një dëshirë për pastërti dhe qëllim, sikur kënaqësitë fizike të jetës të jenë të pamjaftueme ose të papërbushhuna. Aspirata e stjuardesës për me gjetë ngushëllim në përkushtimin fetar mbas

njikarriere të kaluemenë hapësinatkuftitare të qejeve, prezanton njinotë të dualitetit ekzistencial, të kapunmidis indulgjencave tokësore dhe një thirrjeje transhendentale.

Një nga reflektimet ma bindëse të romanit mbi motivimin njerëzor asht përmbledhë në rreshtin - *vetëm ideja e të jetuemit në qiell, ose lidhja me te m'ban me u ndie e gjallë*. Këtu, lufta e protagonistes me forcën banale, por të vazhdueshme të ekzistencës, nxjerr në pah dëshirën e qëndrueshme njerëzore për me qëndrue pavarësisht zhgënjimit. Imazhi i të qenit "në qiell" përforcon tensionin e mirëfilltë dhe figurativ midis lidhjeve tokësore dhe dëshirës për t'i kapërcye ato.

Pavarësisht joshjes e të jetuemit nalt, mungesat e gjata në tokë, kishin ndikue për keq në marrëdhëniet e stjuardesës Vivian me njerëzit e dashun.

Personazhi i sajpasqyron një tjetër lloj malli adëshirësajën për t'u bashkue me murgesha nënjimanastir pas daljes në pension. Magjepsja e saj pas jetës nëqiell, sugjeron njëdëshirë të zjarrtë për liri dhe paqe. Përnjë jetë të mbushunme takime kalimtare, stjuardesa ngjitet mbas një ideali qiellor si shpëtimi saj, njivegimqë e mbështetëatë gjatë turbullinave të jetës.

"Mbaj mend do të kem qenë nja dhjetë vjeçe... Po ecja rrugës me mamanë time. Para nesh kaloi një grup murgeshash, të gjitha të veshuna me uniformë. Mbaj mend ato gra me kapelat e tyne të mëdha e të bardha që dukeshin sikur kishin vu zambakë të mëdhenj në kokë. E pyeta mamanë pse këto gra janë të veshuna të gjitha njilloj, ndryshe nga njerëzit e tjerë. E dini si më tha mama ime? Se duen me shkue në qiell..."

"Mue nuk më lidhë gja me tokën, pra thashë të bahemi bashkë... Meqë edhe ju, edhe unë jemi për atje..." (fq. 159)

7.

«Zalli i Kirit»

Shprushja e kujtimeve të rinisë zakonisht shkakton një ndjenjë nostalgjie dhe reflektimi. Personazhët mund të idealizojnë femininë ose adoleshencën e tyne, duke u përballë me ndryshimet që koha sjellë. Kjo temë shpesh përfshinë shqyrtimin e pafajësisë së humbun, andrrave dhe aspiratave të rinisë dhe se si ato përvoja të hershme i formësojnë individët gjatë gjithë jetës së tyne.

Tek «Zalli i Kirit» na portretizohen kujtime të rinisë, konkretisht te Zalli i Kirit në qytetin e Shkodrës. Ky vend shndërrohet

në një simbol të gjallënisë dhe pafajësisë së të kaluemes. Një terren i shenjtë ku fillimisht zunë rranjë dëshirat dhe andrrat rinore të personazheve.

Në portretizimin e autorit, Shkodra nuk asht vetëm një vendndodhje fizike, por një strehë mendore, një dëshmi e një kohe kur mundësitë e jetës ishin të kufizueme në krahasim me dëshirat e pafundme e të pambulueme nga kompleksiteti i moshës.

"Stinët endeshin mbi Zallin e Kirit dhe sillnin variacionet e veta të zakonshme që na e rrisnin shtatin e fantazinë." (fq. 165)

Për autorin, Zalli i Kirit mbetet vend i zbulimit të vetes, në rradhë të parë dhe, vend i zbulimit të rrethanave të kohës. Aty ku ai bashkë me shokë gjallëonte gjatë ditës, të tjerë, të njajtën e shfrytëzonin për mizori gjatë natës.

"Prej bisedave të ma të rritunve, asokohe na binin në vesh shumë ngjarje që kishin pasë për skenë Zallin e Kirit, por gjithmonë ai vend paraqitej si vend ku ndodhnin ngjarje të këqija, të shëmtueme, të frikshme e deri të neveritshme." (fq. 167)

Aty ku djalëria përjetonte e zhvillonte hovet e moshës, mu aty ishin varrosë andrrat, talenti dhe autonimia e Leze Rrukës. Mbase edhe trupi i saj, por jo edhe turpi i burrave të atij qyteti.

Trashëgimia e grave si e Leze Rrukës asht komplekse. Ndërsa shumë prej tyne u errësuen nga skandali dhe shfrytëzimi, arti i tyne shpesh mbetet me ndikim. Ato përfaqësojnë tensionin midis talentit dhe shfrytëzimit. Përvojat e tyne mund të ofrojnë një koment të fuqishëm mbi mënyrën e trajtimit dhe përballjen me kompromise personale dhe profesionale.

Natyra tragjike e një fati të tillë asht se ai e pasqyron jo vetëm viktimizimin e grave si individ, por dështimet strukturore të një sistemi që nuk arriti me i mbrojtë ato ose t'u ofronte shtigje alternative.

"Qyteti si dha vorr."

"Askush nuk donte ta pranonte Leze Rruken, ajo kishte mbetë dhe asht përsëri atje mbi Pendën e Kirit, keq, shumë keq. Pa lavdi e kujtim." (fq. 173)

Leze Rrukja na ban me e kuptue cenueshmëninë e grave – mes dashunisë për profesionin dhe realitetit të ashpër të botës përreth tyne. Sikurse fati i Ana Kareninës, kjo tregon sesi autonomia dhe seksualiteti i një grueje mund të kontrollohej, abuzohej dhe përfundimisht ta shkatërronte ate.

Paradoksi i Zallit të Kirit!

8.

«Nata e Qejeve» e autorit, Primo Shllaku, gërsheton në mënyrë të ndërlikueme dëshirën e personazheve për të bukurën, përbushjen dhe kuptimin e të jetuemit me pashmangshmëninë e ashpër të kufizimeve të tyne. Nëpërmjet tregimeve të tij, romani krijon një meditim prekës mbi atë që do të thotë të jetosh, të duash dhe të përballesh me sigurinë e vdekjes, ndërkohë që e dëshiron një mbyllje dinjitoze ndaj narrativës së fragmentueme të jetës.

Kur këto tregime kombinohen, ato ndërtojnë një tapiceri të pasun të emocioneve dhe përvojave njerëzore, duke i ftuar lexuesit të reflektojnë mbi marrëdhëniet, kujtimet dhe sfidat e tyne ekzistenciale. Pavarësisht nëse rrëfimi anon drejt një udhëtimi personal apo një komuniteti ma të gjanë, këta elementë inkurajojnë introspeksionin dhe ndjeshmëninë, në fund të fundit duke hedhë dritë mbi kompleksitetin e jetës, humbjen dhe kërkimin e vazhdueshëm për kuptimin dhe lidhjen mes kaosit të ekzistencës.

-E dini ç'i ndodh kujtdo në një ditë si kjo, në ditëlindjen e tij, atij që e ka njohur Lefter Çipën? Në ditë të veçanta të jetës, por edhe raste të kësaj natyre, duket se të përshkon një lloj pasigurie e çuditshme, një pasiguri që lidhet me fjalën, peshën dhe fuqinë që ajo duhet të mbartë për të nderuar poetin dhe vjershëtorin Lefter Çipa nga njëra anë, por edhe detyrimin që zakonisht njerëz të personalitetit të tij duhen nderuar dhe vlerësuar.

Kjo pasiguri, natyrisht më së pari lidhet me peshën që Lefter Çipa ka krijuar gjatë gjithë jetës së tij në vendlindje, në krijimtarinë e botuar, në marrëdhëniet me njerëzit, në arkivën me disa qindra këngë të polifonisë së Himarës e Labërisë që shkroi, me njohjen e madhe që ai pati në Shqipëri dhe jashtë vendit, me njohjen që ai kishte për kulturën dhe letërsinë, me talentin e padiskutueshëm me të cilin ai përjetësoi ngjarje, njerëz, krahina, luftëtarë, dashurinë, bujkun dhe blegtorin, detin dhe malin, pra gjithë ritmin e tij jetësor. Ky trishtim që mbart kjo ditë, jo vetëm tek unë, por edhe tek të gjithë lidhet me mungesën e tij, ndërsa libri që ka dalë në dritën e botimit "**Njerëz me dritë**" tregon se Lefter Çipa kishte akoma shumë gjëra për të thënë. Kjo ikje na lëndon.

Më lejoni, që në këtë rast të shprehem si unë e mendoj, si e ndiej dhe si e kam krijuar marrëdhënien me Lefter Çipën, jashtë klišëve tradicionale. Kur flitet për Lefter Çipën, natyrisht nuk mund t'i shmangesh një simbioze të pranuar nga ai vetë, njerëzit e përditshmërisë së tij, studiuesit, grupet e shumta polifonike, personalitetet e shumta që e njohën dhe ai i ka njohur, se: Lefter Çipa nuk kuptohej dhe nuk kuptohej pa njerëzit e Bregut, ashtu si njerëzit e Bregut, vështirë të kuptohen pa Lefter Çipën. Një simbiozë e gjatë, ku dy pjesët plotësuan dhe plotësojnë njëra-tjetrën, ku njëri bëri tjetrin dhe anasjelltas.

Histori të tilla janë të rralla dhe në historinë botërore të letërsisë. Të 15 librat poetikë të Lefter Çipës janë mielli dhe brumi i nxënë dhe i ardhur mirë në këtë lidhje të fortë të tij. Të 15 librat përbëjnë një arkivë të rëndësishme, brenda së cilës peshojnë kohët, dhimbjet, shqetësimet, heronjtë, varfëria dhe bujaria, njerëzit e bukur të së kaluarës historike, por edhe ata të ditëve tona, peshon muza e pafundme e detit, peshon polifonia labe, një perlë dhe një pasuri e njerëzimit, pra peshon jeta.

Libri "**Njerëz me dritë**", brenda të cilit gjenden refleksione, intervista, poema, letra, sentenca, epistolare, vlerësime etj., krijojnë një njohje tjetër, një dimension tjetër të lexuesit dhe për lexuesin, ata që e kanë njohur dhe ata që do ta njohin në të ardhmen, njeriun e madh Lefter Çipa. Libri në fjalë materializon në një farë kuptimi dimensionin, personalitetin, dhuntitë, ditën dhe udhëtimin, aftësinë për të shkruar mes njerëzve, fuqinë meditative, njohjen dhe formimin e tij prej njeriu dhe intelektual, sa duket se është një libër i shkruar për veten, pavarësisht hapësirës së madhe që libri ka brenda vetes. Pikërisht kjo hapësirë e bën këtë libër mjaft të bukur dhe real.

E vlerësoj shumë këtë libër të Lefter Çipës, uroj dhe lus gjithashtu, që familja të gërmojë në arkivat e tij, në fletoret dhe librat e bibliotekës së tij të

NJË JETË PLOT SHKULME E BARDIT LEFTER ÇIPA

Nga Prof. dr. Bardhosh Gaçe



gërmojë ende, për të na dhënë dhe libra të tjerë, pasi një libër si ky nuk zbulon vetëm profilin e Lefterit, por krijon koordinata të rëndësishme për autorë të tjerë, për çështje të rëndësishme të zejes së letërsisë, për tema bazike dhe të mprehta, detaje dhe mundësi të mëdha që letërsia ka në kohë të caktuara të vendit.

Libri është ndërtuar funksionalisht mirë për shkakun se shumë-planshmëria e tij arrin të komunikojë qartësisht. Të tetë kapitujt e librit përbëjnë nga një njësi më vete, të cilët përveç komunikimit si të tillë, ata duket se e plotësojnë njëri-tjetrin. Libri ngjan me një sofër të madhe, ku Lefter Çipa duket se është shtruar me të gjithë të njohurit e tij, me ata që i ka dashur shumë dhe që e kanë dashur, një sofër ku lejohen të flasin të gjithë, ai dhe të tjerët. Pse e them këtë, dhe e krahasoj me një sofër? Tradicionalisht sofra është vendi ku njerëzit janë të barabartë, ku të gjithë mund të flasin dhe të gjithë duhet të dëgjojnë tjetrin.

Pamundësia për ta ezauruar plotësisht metaforën e librit, poeti, intelektual dhe bardit Lefter Çipa, në gjithë librin ka reflektuar dhe ka sjellë njeriun, njeriun si burimi jetik i kuptimësisë së jetës, njeriun prej të cilit, sipas konceptit të Çipës buron drita, të cilin ai prezanton që në titullin e tij. Ndoshta kjo është dhe metafora më e qenësishme e tij.

Edhe pse libri është strukturuar në

kapituj të ndryshëm, të cilët qartësisht ndihmojnë në leximin e tij nga lexuesi i çdo niveli, ai përshkohet nga një frymë krijuese, nga një mendje dhe shpirt i lidhur shumë me krijimin. Kapitulli "Të ditur që të diturojnë" është njëri nga kapitujt, ku poeti dhe krijuesi Çipa pjesëton mjeshtërisht raportin shoqëror me njohjen dhe vlerësimin për figura të njohura të letërsisë dhe kulturës shqiptare, poezisë dhe studimeve, siç janë kontaktet me Dritëro Agollin, tek i cili shquan poetin, njeriun, talentin dhe burrin e mençur, bujarin dhe gjenium e poezisë shqipe. Shënimi i titulluar "Ç'më flet zëri i shpirtit, zëri i Dritëroit", i cili zë një vend të rëndësishëm në libër, ka një refleksion të thellë njohës për poetin, por ajo që është më e rëndësishme në këtë, lidhet me një lloje shpërshfaqje plotësisht krijuese dhe filozofike, siç ai e bie poetin e madh përmes njohjes së tij tek lexuesi.

Dritëro Agolli është një përvojë e çmuar për çdo poet shqiptar, jo vetëm para viteve '90, por edhe tash. Agolli ishte dhe mbetet një njeri i mençur, i ditur dhe i lidhur fort me vendin e tij, njerëzit dhe filozofinë jetësore ku ai lindi, u rrit dhe kontribuoi. Lefter Çipa na ka zbuluar një figurë madhore të këtij kalibri, duke e pasur një mik të çmuar. Sjell ndër mend vitin 1983, ditët e fundit të majit, në klubin buzë detit në Himarë, ku debati letrar midis Dritëro Agollit dhe Lefter Çipës vazhdoi disa orë, mbi frymën e shenjtë poetike

të Naim Frashërit, Andon Z. Çajupit dhe De Radës, poetë kombëtarë këta që i kishin mjaft për zemër: Kur Lefteri nisi të këndojë disa vargje poetike të thurura prej tij: "Në Çajup vajta njëherë,/ mbushur vendi luleverdhe", Dritëroi iu përgjigj me këngën e tij devolliçe "Riza Velçishti", e pastaj me atë të Kajo Babienit. Të gjithë ne, së bashku me 5-6 këngëtarë piluriotë, u mahnitëm nga zëri i tyre i mbrekullueshëm polifonik.

Refleksionet të thella ai ka për figura të tjera si Petro Marko, një personazh dhe figurë emblematisht, një karakter i fortë, burri i tramundanave në brigjet me "re dhe gurë", siç thotë Lefter Çipa, një shkrimtar dhe romancier klasi, pastaj këndvështrimi dhe brilantet e hedhura mbi figurën dhe talentin e Xhevahir Spahiut. Po ashtu, vlerësimi përmes njohjes të artistes Justina Alia, kompozitorin e njohur Aleksandër Lalo, këngëtarin e njohur nga Kosova Nexhmie Pagarusha, studiuesin e njohur Dhimitër Shuteriqin, këngëtarin Bik Ndoja, pastaj Adem Demaçin dhe të tjerë, besoj që krahas raporteve që ai kishte me njerëz të tillë, marrin vlerë dhe krijojnë një dimension tjetër të tij në raport me kulturën dhe dijen.

Në kapitullin e titulluar "Bisedime dhe refleksione", kryesisht intervistat që Lefter Çipa ka dhënë, janë interesante jo vetëm zbulesat që lidhen me krijimtarinë e tij, por edhe raporte të tjera të kohës, ngjarje të shënuara dhe marrëdhënie që e kalojnë interesin lokal



dhe atë kombëtar. Repertori krijues i Lefter Çipës dhe grupet polifonike me të cilët ka bashkëpunuar ai kanë nxjerrë në skenë dhe kanë deklamuar mjeshtrë të polifonisë, të muzikës dhe kompozitorë të rangut ndërkombëtar, duke dëshmuar një personalitet me ndikim të madh në artin e këngës dhe të skenave ndërkombëtare.

Siç është thënë me të drejtë, që në krye të herës, Lefter Çipa arriti si askush tjetër ta mishërojë në artin e këngës polifonike, por edhe në poezinë e tij, qoftë e llojit vjershë, qoftë e llojit poemë, mishërimin e historisë. Në këtë rast arti dhe krijimtaria përbëjnë një ndërmjetës të rëndësishëm për ta aktualizuar atë. Shënime të tilla si “Një rrëfim si dëshmitar i rivarrosjes së Avni Rustemit në Vlorë”, “Vështrim historik mbi shkollën shqipe në Bregdetin e Himarës”, “Mëmë Mara e mërmërimave ligjëruese” përbëjnë detaje të rëndësishme për të krijuar njohje të besueshme për shumë ngjarje dhe personazhe të caktuara të kohës. Bregu i Detit, Vlora dhe Himara, por edhe shumë vende të tjera të këtyre anëve kanë histori të shumta rishtuese dhe trimërie nga thellësitë e kohërave deri në kohët tona. Në jetën dhe gjurmimet e Lefter Çipës ka një opus të madh njohjeje dhe vlerësimi.

Lefter Çipa mbeti përjetësisht i lidhur fort me polifoninë, dhe si i tillë, dedikimet më të mëdha ai i kishte për polifoninë, motivet e këngëve, kompozitorët, solistët, grupet, zërat, akordet, pra gjithë strukturën njerëzore dhe skenike të këngës polifonike. Kapitulli “Dialogë me Polifonët” është një libër më vete. Ai ka dashur ta rishkruajë në të gjithë mundësitë pjesën e shpirtit me këtë kontingjent të artë njerëzish dhe artistësh, jo vetëm në Pilur, por në të gjithë hapësirën ku polifonia ka jetuar dhe jeton. Polifonia është pasuri botërore tashmë, dhe si e tillë ajo ka historinë e saj, sakrificën e saj, njerëzit e saj, ngjarjet e saj, sukseset dhe dëshmitë e saj.

Si i mençur që ishte Lefter Çipa i ka dhënë një hapësirë dhe një perimetrim të gjerësishtë tematik, njerëzor dhe emocional polifonisë dhe protagonizmit të saj kombëtar dhe ndërkombëtar. Shënime të tilla si: “Një urdhër shpirti dhe gjaku”, “Përgjigje zemre Bejkës së Bardhë”, “Këngët e Atdheut janë triumf shpirti tek populli dhe e ardhmja”, “Piluriontë të mi”, “Jeni prova fatlume për një artist”, “Unë besoj vetëm te kënga” dhe të tjera shënime, ku shpalosen njerëz, ngjarje të bukura dhe evenimente, dëshmojnë këtë lidhje të fortë, të cilës ai i kushtoi jetën.

Në libër ka përvijë jetësore, ndërsa dy poemat “Katërshes vlonjate” dhe “Lum si Bregu për Vunoin” përbëjnë thelbin e shpirtit të poetit, të lidhur fort në shkëmbin e jetës, siç është vendlindja, ku shpërfaqen dhe dy zhanre të reja, atë të sentencave, që lidhen me përvijën e jetës dhe aftësinë e meditimit të poetit, filozofit dhe njeriut të ditur Lefter Çipa, maksimat, sentenca zakonore dhe epistolare, duke u mbyllur me vlerësime dhe mendim kritik nga kritikë, studiues dhe konsiderata të njohurish.

Unë vetëm i preka çështjet, libri është thellësisht i nevojshëm për t’u njohur dhe studiuar, pasi brenda tij ka një jetë plot sakrificë, njohje, vlera dhe kontribute të bardit të madh Lefter Çipa.

MIRI DHRAMI

Me lëkurë të re

Tregim



Mëngjeseve herët, kur vesa ende nuk lish tharë mbi qemerët e portave të gurta, dëgjohej e beftë trokitja e plakut që grumbullonte nëpër fshat, lëkurët e kafshëve të therura. Nuk ishte nevoja të thërriste. Të gjithë ia njihnin trokitjen me shkopin e dorës. Disa ja hapnin portën por të shumtët përgjigjeshin nga brenda. (Na lër o Çelo, pash zotin! Nuk e kemi rrjepur kecin akoma!) Atëherë plaku drejtohej tek porta e komshiu, e kështu me radhë, duke trokitur në të gjithë dyert e fshatit. Veçse tek porta jonë, ai ngulmonte më tepër. Trokitjet e dëshpëruara të tij derdhnin tek parmaku i shtëpisë tonë, tërë makthin e jetës së tij të mundimshme. Ndërkohë dy të mëdhenjtë e shtëpisë, babai dhe gjyshi, pyesnin njëri tjetrin me habi, “Përse nuk i bie ziles ky njeri? Nuk e shikon butonin, apo me shkop e ka më të lehtë?” Për pak trokitja e tij bëhej e rreptë si zhurma e breshrit mbi llamarinën e kotecit.

“Vërtet, përse nuk e vendos gishtin mbi zile? Përse e shpërfill kaq shumë veprën e mrekullueshme të babait tim?” pyesja veten ngaqë të gjithë shokët në fshat, kishin qejf t’i binin ziles tonë. Mos vallë gishtat e plakut të kthyer prej artritit si çekanë, nuk e shënonin dot butonin! Këtë nuk e mësova dot. Plaku fshihte shumë mistere.

“Ke parë ti, goxha zile në portë dhe tjetri i gërdis gishtat mbi derë! -u rrëmbye një ditë im atë nga sjellja e pakuptimtë e lëkurë mblehdhësit. Megjithëse babai nuk ish dakord as me shkëlqen e vazhdueshme të butonit të ziles, siç bënin shokët kur më thërrisnin për të lozur. Ndaj dhe i shante keq. Ata thyenin sokakëve si gargujt që lëshoheshin nga majë e plepit, kur Koço gjahtari, shtinte me çifte. Për pak, trokitjet e plakut bëheshin të shkurtra dhe të shpejta, si të jepte në mors thirrjen për ndihmë. SOS. Dhe kur përgjigja nga brenda vononte, prej gjoksit të petëzuar të tij, dilte një zë i shkrehur, si lutje e gjatë e përsëritshme. Mërmëriste se donte një lëkurë të re dhe se pa gjetur lëkurë, do të vdiste nga uria.

“Na ruaj, zot i madh! -shpërtheu gjyshja një ditë, -Të fut apo jo në gjynah ky plak verzevul? I themi nuk kemi lëkurë për të shitur dhe s’degjon të shkulet! Veç të rripemi e t’i japim zhapën tonë!” -shtoi gjyshja me shaka dhe shikoi nga unë, të kontrollonte nga afër reagimin tim. Më mirë le të themi, frikën time. Meqë sipas saj rrjepja e njeriut është diçka e thjeshtë dhe mund të ndodhë kurdo e tek kushdo, unë e mora me shumë frikë. Ishte çnjerëzore ajo që propozoi gjyshja, ndaj qysh prej asaj dite, sa herë Çelua shkulte në fshat, zemra gati më ikte nga vendi. “Kaq e lehtë qenka rrjepja e njeriut?” -pyesja veten i zverdhur si qitro, ndërkohë imagjinoja veten të rrjepur mes rrjepacakësh dhe ngrysesha si dimër i vogël. Kjo bëri që gjyshja ta çonte edhe më tej shakanë e vet. Përsëriste gjithmonë pa pikë ngurrimi, (të rripemi) (u rropëm) (do na rrjepën) (bythërrjepurit) e të tjera si këto. Ndërkohë plaku mbas porte vazhdonte me lutjen e dhimsur; “Një lëkurë kërkoi, o njerëz!”

Prekëse lutja e tij, të bënte të ndjeheshë keq. Po kur nuk ka, nuk merr as perëndia.

“-O po ky është çmendur fare! O na merr sot zhapën, o s’shkulet këndeji!” -thirri pas pak gjyshja e nxehur, dhe u nis me xhinde për

tek porta e oborrit. Pas saj dhe unë. Fustani i gjatë me pala i shkonte andej këndeji si perdja e kinemasë së fshatit kur e tërhiqim të hapej në të dy krahët. Porse plakës shkundjen e fustanit nuk ia provokonte tërheqja e ndonjë litari, por hapat e mëdhenj sipër plloçave të largët në oborr, që ende i rezistonin shkuljes nga vendi. Kurse unë me hapat e vegjël i bija shkurt. Hyja edhe nëpër baltëra, si tanku lodër me telekomandë i djalit të kryetarit. Kur gjyshja arriti tek porta, unë u fsheha midis palëve të fustanit të saj. U përpoqa të shikoja plakun e lëkurëve, i cili porsa ndjeu zemërimin e gjyshes, vendosi të largohej i palosur në mes, duke ngritur lart në erë shkopin dhe llërët e fshkura. “Ç’u bëre, o i zi? Pse ike ashtu? Ktheu pra, të na marrësh zhapën!” -thërriste me sa kish në kokë gjyshja por ai nuk e ktheu kokën. Eci heshtazi deri në fund të sokakut, pastaj na humbi nga sytë. Atëherë, dola nga palët e fustanit, dhe shikova gjyshen në sy, të bindesha se ajo kësaj here bënte shaka. Megjithëqë gjyshja kish përcaktuar dhe pjesën ku do të fillonte rrjepjen e vetes. Nga brinjët e thara. Pra nuk u desh shumë dhe çështja e rrjepjes nisi të më gërryente shpirtin. Makthi i pa kontrollueshëm. Gdhiesha dhe ngrysesha i ngrirë prej tmerrit të rrjepjes. “Ku dihet si vjen puna?-thosha me vete. Gjendem orën e gabuar në vendin e gabuar dhe, brisku famëkeq i plakut të lëkurëve frëngëllon mbi mua!” Shkurt, ishte e pamundur ta mposhtja frikën. Natën në gjumë shikoja brisqe që kullonin llahtarë. “Po të më gjejë mynxyra, si do të jetoj pa lëkurë? Sa ftohme mund të durojë një fëmijë i rrjepur?” -pyesja veten teksa vëreja se, mbi trupat tanë të dobët, nuk mbylleshin lehtë as plagët prej çjerrjeve të vogla, e jo më shërimi prej rrjepjes totale.

Kjo bëri të kyçesha gjithë ditën në shtëpi, sa herë Çelo lëkuraxhiu hynte në fshat. Më dhimbsej lëkura ime dhe gëzohesha derisa në fshat kishte akoma disa kokë dhen dhe dhi, që ai t’ju merrte zhapën. Kështu do ta shtynim dhe pak kohë brenda lëkurës tonë. Veç kur fshati të mos kishte më as keca, atëherë si do t’i bëhej hallit?! Dhe gjithçka dëftonte se ajo ditë nuk ishte e largët. Plagët mbi degën e arrës së Gjileke kishin filluar të mbylleshin, ngaqë çengeli i kasapit varej gjithmonë e më i rrallë në të.

Gjendja u përkeqësua kur Çelua dëshmoi me gojën e vet se; “Po të mos i jepnin lëkurë, ndonjë do ta rripte vet të gjallë.” Dikush u shpreh se nuk ishte kërcënim dhe se nuk u drejtohej fshatarëve, por të gjallave. Kurse një tjetër qartësoi se Çelua foli me nëntekst, dhe u drejtohej fëmijëve. Pra, ata duhet të rrinë brenda! Kështu e mbylli sqarimin ai.

Në fshat tashmë u bënë dy persona që flisnin për rrjepjen e njeriut. Ai dhe gjyshja ime. Paçka se gjyshja fillimisht pranonte rrjepjen e vetes, kurse ai të fëmijëve. Përfundimisht deklarata e Çelos nuk kaloi e thjeshtë, por si hakërrim. Fjala fluturoi në çdo cep të fshatit, që të vegjlit të merrnin masa sigurie, të ruanin lëkurën. Ndaj dhe fëmijët nisën të caktonin rroje tek Shkëmbi i Petësit, porsa të dukej Çelua, ai të këndonte si buqicë dhe shpella e Brame të ushtonte, që fëmijët të mbylleshin shpejt brenda mureve të shtëpisë.

Por një ditë vere që kalamajtë e fshatit kishin shkuar në det dhe laheshin e

tërboheshin me valët në breg, dikush më i rritur rrëfeu një të fshehtë të madhe. “Çelua, tha ai, nuk i preferon lëkurët e përcëlluara! Zhapat e përzhitura nuk shiten lehtë!” -shtoi duke hedhur gurë petashuq në det. Çastin tjetër të gjithë dolën nga tenda. U shtrinë mbi zhavorr si bukëfiqe, të piqeshin në diell. U dogjën e u përcëlluan aq shumë, të bëheshin të papëlqyeshëm për Çelon. Disa në fshat i përqeshën, i quajtën (harrapë)po kjo nuk i shqetësoi fëmijët. E rëndësishme ishte të ruanin lëkurën e vet. Ndaj dhe kur diskutonin, fillimisht i kujtonin njëri tjetrit fatin e madh që gjendej me lëkurë. Pastaj për të këputur çdo fije dyshimi, e ledhatonin njëri tjetrin në shpinë. “Gëzohu, o vëlla i pa rrjepur!..”

Kjo përkujdesje zgjati gjithë vitet e vegjëlisë, derisa një ditë nga fundi i prillit qarkulloi në fshat se Çelua i frikshëm, vdiq. Madje lajmërimi i vdekjes së tij u transmetua edhe në radio. Nuk e di si u ndjenë të mëdhenjtë për humbjen e tij, po ne të vegjlit e festuam fshehtazi. Madje kënduam dhe një copë nga himni kombëtar, pastaj u ngatëruam dhe vazhduam me himnin e flamurit, për ta mbyllur në fund me disa vargje nga kënga “Ato maja rripa rripa, seç gjëmojnë!” Por të tilla ngatërresa nuk përbënin turp. Kështu u ndodhte të gjithëve kur gëzonin, i pleksnin e i trazonin këngët bashkë, ngaqë dëshironin ta përfshinin gjithçka të madhe e të bukur, brenda një teksti.

Gjithsesi tek kushdo dallohej entuziazmi. Dhe me të drejtë. Më në fund shpëtuan nga Çelua të pa rrjepur. Të paktën kështu mendonin. Nga lumturia disa nisën ta thërrasin shokun, jo me emrin e vet, por me epitetin e madh. (O i pa rrjepur.) Emra të tjerë do të tingëllojnë krejt pa kuptim. Për këtë u krenuan edhe të mëdhenjtë në fshat. Fëmijët që ata rritnin me mundim, i mbulonte lëkura e vet...

Por fatqësisht e liga kish ndodhur, dhe për më keq këtë nuk e dinte askush. Gjithçka u zbulua rastësisht, ditën që u rrëzua nga buza e madhe Pirrua i Mëhille. Doktor i që erdhi ta vizitonte, porsa e pa djalin të zhvokur e të përgjakur, shastisi një çast, pastaj ngriti pak të dya duart duke thirrur i tronditur. “Po copën tjetër të lëkurës ku e ka ky vogëlush?..” Atë çast, dikush nga kryesia nduku buzën dhe doktori heshti. Pastaj mjeku e rrotulloi djalosin e plagosur ta vizitonte nga shpina. Unë që kisha mësuar si të shpoja në turmë, prej kindave të fustanit të gjyshes, dola thujse në reshtin e parë. Aty dëgjova qartë doktorin që pyeti për lëkurën e munguar të Pirros dhe, këtë u mundova ta përcillja mbrapa, tek shokët, por ai i kryesisë më kuptoi dhe ma tërhoqi veshin fort. “Mistrec! më tha, Doktorin nuk pyeti për lëkurën, po për sandalet e tij prej lëkure!” Unë mbeta si muç. Përgënjeshtrimi i tij sy për sy ma ndrydhi zemrën. U ftoha krejt. Nuk munda të flisja për asgjë. Kështu, rrjepjen e Pirros nuk e mësoi askush në fshat. Mbeti sekret. Veç disa vite më pas, kur ne e matkisëm fshatin dhe shkuam të punonim bratanë kufrit, e para që na dëgjuan veshët pas kontrollit të lehtë mjekësor nga doktorët e huaj, ishte fjala; “Ore, po këta qenkan fare të rrjepur!” Nuk kanë cipë mbi vete! Shumë nga ne i nisën urgjent nëpër spitalet rrotull. Njëri nga ata që iu ushtrua terapisë për lëkurë të re, isha dhe unë që po ju rrëfej.

Netët në spital mu bënë muaj. Drita e ftohtë që kisha mbi sy, po mi thante ëndrrat. Shikimi mu zbeh dhe kokërdhoku mu zmadhua, gjë që i tmerroi infermieret.

(o kajmenos!) i mjeri, dëgjoja të pëshpëritnin sipër kokës time, megjithëse shpesh herë kaloja në jerm. Kur u përmenda, prekja vazhdimisht veten duke u habitur për lëkurën e re. “Kush do ta paguante vallë lëkurën time të re dhe si e humba lëkurën e vjetër! Kur më rropi Çelua i frikshëm dhe nuk e ndjeu askush? Kush vallë e veshi lëkurën time të vjetër, dhe a i ujdisej bukur mbi trup? Këto dhe shumë pyetje më mundonin, por ajo që më tmerronte ishte frika mos dikush ma zhvishte përsëri lëkurën e re. Lëkurën që më qepën doktorët e huaj.

Qysh atëherë kanë kaluar shumë vite dhe unë ende prek gjymtyrët me kujdes të provoj, nëse ende jetoj me lëkurën e re...

MEHMET ELEZI

Fustani për
Shën Valentin

Tregim

Vetëm kur e shoqja e ceku në bërryl, ke të vogla apo të shoh unë, ai e vuri re faktorin, që priste përballë me bllokun e biletave në dorë. Atij i kishin mbetur sytë të një vajzë me kryq të bardhë në fytyrë, ulur në ndenjësën mbrapsht, e paske bërë hundën? Cipa e hollë dhe e dëlirë e faqeve të vajzës zbriti dhe u bë e tejdukshme, për një imtë mendoi mos ajo ndezi llampën e telefonit. Jo, po këqyret në pasqyrë. Përfytyron imtën kur do t'i dalë atij përpara me fashën hequr. Dhe.

Autobuzi mbushur rrastë, ulje çmimesh për Shën-Valentin, të tërë qenë turrur te TEG-u. Në stacion hovën brenda dy çunakë me mimoza në duar. Ai zgjodhi një tufë e ia zgjati së shoqes. Ajo buzëqeshi dhe u mori erë. Njihet në krejt Tiranën si grua e bukur. E shpallur Miss Hijeshia në universitet, në kulmin e lulëzimit kish hequr dorë nga garat e bukurisë. Kurrkush nuk e mori vesh pse.

Parakaloi një ulurimë makine, vajza me kryq në hundë çoi sytë. Atij i sëmboi në parzëm. Sy shites, mimoza të çelura në një natë të kaltër.

E shoqja i ra lehtas në shpatull, erdhëm. Ai e përvodhi rishtas me bisht të syrit vajzën me hundë të fshehur nën kryq. Vajza holloi shtatin me përbirue mes njerëzve, lakoi belin gjarpërisht dhe rrëshqiti në derë. Ai fluturoi me të sdi se ku. E pa vajzën kah zhvishet në një dhomë të muzgët, drita e holluar dridhet prej zjarmisë, dy sqepa në kraharor u venë flakën kokrrizave të ajrit, fushëtira e pruar e barkut zbret maturisht drejt ngushticës së muzgët, në fund të saj hataja, ka rënë zjarr!

Duke hyrë në derën ballore të TEG-ut, e shoqja i shtiu krahn. Një punonjës sigurie ua nguli sytë, dreqi e di pse. Ndoshta për shkak të asaj. Të sharmit të saj.

- Si ajo e dua fustanin, tha grua. Si ajo goca që kish bërë hundën, të pëlqen?

- Po, tha ai.

- S'kam parë aso blu, tha ajo.

- Po, tha ai.

Ajo buzëqeshi, ngjyrën e zgjodha unë, modelin zgjidhe ti. Me kënaqësi, tha ai. Ndonjë mendje dua, gjithsesi. Po, tha ajo.

Hipën në shkallën vetëlëvizëse. Ai ia vuri dorën në përmjet.

Matanë fekttoi vajza me natën e kthjellët të mimozave në sy. Kryqi në hundë u bë zog, u dha flatrave, fër-fër. Vajza kapërceu një derë dhe u zhduk, duke tundur dorën e majtë, me një çantë këpucësh të sapoblera.

E shoqja bëri shenjë, këndej. Hynë në një shitore me veshje femërore, marka të shtrenjta. I bukur ai fustani në cep, model i ri, tha ai. I verdhë, tha ajo. E verdha të shkon shumë, tha ai. Me flokët, me sytë. Dhe.

Ajo u ndal.

- Nuk të pëlqen bluja, si e asaj gocës?

- Pse, ç'ngjyrë e kish ajo, s'e kish të?

Ajo u zemërua. Edhe kur më bën dhuratë, tallsh!

Ai tha më fal. Thjesht mendova sa i bukur ky fustan, është ngjyra jote. E blejmë si të asaj, por edhe këtë, pse jo. Marrim dy.

Ai as që kish vënë re ç'ngjyrë e kish fustanin vajza me hundë të bërë. Nga u zhduk, po zgjedh prapë fustan? Me një sy të ëndërrt e ndoqi te kabina e provës. Ajo u zhvesh, të bardhat e vockëla i lëshoi mbi çantën me këpucët e reja, vithet rrumbullake kërcisnin si mollë. Afroi hundën me kryq të pasqyra, pasqyra u mbush prapë me mimoza të çelura në një natë të gjelbër në vjollcë. E shoqja se ç' tha për ngjyrën e fustanit. Po, ia ktheu ai pa e pasur mendjen, me vete po thoshte ke të drejtë Musteqe. Musteqja qe shok klase i gjimnazit, i vetmi që kishte mbetur në Tiranë, kthenin herë-herë ndonjë birrë me qofte skare te Tymi e bënin gallatë. Ku mbajnë mend burrat çka vesh një femër, thoshte Musteqja. Sytë e burrave e zhveshin femrën, e shohin vetëm cullak. Kjo është një e vërtetë e vjetër sa bota. Pse, ty s'të ndodh kështu?

E shoqja ndjeu në qafë vështrimin e një burri të panjohur. U rrek me e këqyrë me bisht të syrit, pa e kthyer kryet.

Po gratë, mendoi athët ai, duke ndier një djegie të papritur në zgrof, si e shohin gratë një mashkull përballë? E shohin edhe sto siç e shohim ne një grua, duke e zhveshur cipricullak?

-Ej, ti qukëse, tek dera të kërkon një burrë, një vuv - thirri dezurnia e shkollës, një mesogrua e shkurtër me flokët e mbedhur topuz, që sikur çalonte pak në anën e majtë.

Kështu e nis rrëfimin Kristina, për një nga ngjarjet më shënjuese të fëmijërisë të saj.

"Ka shumë ngjarje e kujtime që më ndjekin pas e më marrin kaliboza, por ajo e asaj dite është krejtësisht e pabesueshme, e veçantë. Pas njoftimit, mësuesja dha lejen e saj dhe unë dola. E mbërrita dezurnen ende pa zbritur në katin e parë dhe e pyeta sërish: Kush, kush më kërkoi?"

Të thashë njëherë - më vështroi vëngërt e lodhur nga dihatja - një burrë shurdhmemec!

I kapërceva dy e nga tre shkallët e kateve deri sa mbërrita tek dera e jashtme e shkollës. Më priste babai. Një shkullm inati e zemërimi m'u mblodh lëmsh në fytyrë. Më mbyti. Isha vetëm tetë vjeç, nxënëse e klasës së tretë dhe nuk e dija që jeta e fëmijës është si një zmadhim i fotos të babait. Një zmadhim që mbase shkon në absurd. Pse ma quajti shurdhmemec babain? Ku dinte gjë ajo?

Gjithë pyetjet e mia ishin si ato harabelat e beharit që nisen nga një habi në tjetrën dhe nuk mbërrijnë kurrë në destinacionin e duhur. Babai im prej kohësh kishte ndërprerë komunikimin me zë, por këtë mendoja që e dija vetëm unë dhe nëna. Në shtëpi merreshim vesh thuajse me shenja. Në rrugë e në punë ai fliste rrallë e më rrallë. Të tjerët, shokët e komshinjët e mëhallës thoshin për të se ishte bërë si gur. Si gur varri. I heshtur. Mumje. Ndonjëherë babai shkonte për peshk në lumin Drino. Vetëm. Rrinte atje me orë. Mbase flet me lumin, i përgjohesha unë fshehtas nënës. Peshkimi i tij u bë ritual. Thuajse dy a tri herë në javë. Në shi e në diell, në zheg e në shqotë. Ndërsa kur vinte nga puna në shtëpi, babai donte të luante shah. Se si iu ngjit kjo sëmundja e lojës shah. I kërkoi dhe nënës të mësonte lëvizjet e lojës magjike, por ajo nuk ia thoshte. Pas disa përpjekjesh të kota, e la fare atë ngasje.

Rritu sa më parë, - u duk sikur m'u lut atë kohë. Isha gjashtë vjeç. Dikur ... A ndoshta kështu e kuptova unë. Koha është fat. Mundësitë i kemi si graviteti. S'mund të ndërmetjesosh me gravitetin, arsytetova vite më pas vështrimin e tij. Babai nuk hoqi dorë nga shahu e nisi të luante krejt vetëm.

Me vetveten.

Bënte herë lëvizjet e gurëve të bardhë e herë të atyre të zinj. Pas kësaj, e folura e tij humbi krejt, u bë si një ngjarje jashtëtokësore, si të ishte privilegj qiellor. Pak nga pak humbi aftësinë e artikullimit. Rrallë e më rrallë, kur ndodhte që ai të fliste, ngjante sikur gjuha i ngjitej lart në qiellzë dhe mezi shqitej.

Sikur një fuqi misterioze e pengonte. Nga humbja e gjuhës, sytë e tij sikur u veshën me perde, morën hutimin e guakut, megjithëse mbetën vezullues. Shenjat e përditshme të komunikimit, tërësi krejtësisht flu, të shumuara, ishin përsiatje të padurueshme gjer në litani.

Ç'rëndësi kishte humbja e gjuhës në raport me pushtetin e vetmisë dhe privatësisë?

Babai ashtu në vetmi, sikur ndihej më i qetë, më i sigurtë, sikur kishte braktisur të shkruarën, duke ofruar shansin e nxjerrjes së vetvetes nga rradha e fajtorëve. E pyesja përherë, kinse për ushtrimet e shkollës dhe ai më kthehej i papërtuar. Më ndihmonte, por vetëm me shkrim. Shkruante në fletore zgjidhjet e ushtrimeve dhe m'i zgjaste.

E përqafoja fort pa e ditur që problemi i tij s'ishte thjesht ai i lirisë, por i një rrugëdaljeje nga rrethi vicioz. Revolta ime fëmijore ndaj tij shndërrohej shpejt, sa hap e mbyll sytë, nga tragjedi në komedi dhe anasjelltas.

I lëngëzonte si dinte ai, ata sytë e shkruar bojëqielli, pa mundur të më rrëfente dot atë brengë mjaft të trubullt, një shijim torture, dredhinë e kohës që i kishte çarmatosur fatin. Pa më thënë asnjë fjalë, babai më shtrëngoi dorën dhe të dy së bashku ecëm me hapa të shpejtë në krahn tjetër të rrugës, drejt kopshtit me dreq, aty ku ishte motra e vogël pesëvjeçare. Diçka duhet të ketë ndodhur, më shkrepri nëpër sy frika që më drodhi trupin me ndjesinë e një rreziku. Ndoshta gjyshja e nënës që gjendej në fshat?

Ku i dihej? Ndoshta diç tjetër ...? Shurdhmemeci nuk i rrëfen asnjëherë planet. Ai ia mbath përherë nga dicka, nga brenga, nga e papritura.

Pse e kishte zgjedhur babai këtë rol?

A nuk ishte kjo një histori false?

Mirë në punë e në rrugë, po dhe në shtëpi? Njëherë ai i tha nënës: Këtu të përgjon edhe era!

Nuk e kuptova atëherë se si mund të përgjonte era?

Kohë më pas kam meditaruar gjatë rreth frikës së tij. Nëna atëherë ia ktheu: Mirë thua, thashethemet janë si flakët e zjarrit.

Dihet kur fillojnë, po kurrë s'u dihet fundi! Babai miratoi me kokë. Si përherë, nuk dha asnjë shpjegim. Nxituam tinës dhe morëm motën e vogël nga kopshti, pa rënë në sy. Ecëm drejt sokakut të vjetër të Kokobobajve, atje ku gjendej shtëpia jonë, trashëguar prej gjysh - stërgjyshërve të babait,

ODISE KOTE

Llokumet

Tregim



bankierë e financierë të famshëm të qytetit. Shtëpia ishte karabina e madhe trikatëshe, gjysmë e rrënuar, një pjesë e shtetëzuar, ku banonin veç nesh dhe pesë familje të tjera të ardhura vitet e fundit. Me të ardhurit kishim fare pak gjitoni. Ne banonim në katin e tretë, në anën perëndimore, krah që kishte fushëpamje mbi luginën e gjerë të Drinos, nga ku herë pas here shikonim edhe ndonjë aeroplan ushtarak që ngrihej prej aeroportit të vjetër të qytetit. Një familje agronomësh ishte në krahn tonë, në anën lindore, ndërsa katër të tjerat, mësues, mjek, berber dhe ushtarak, banonin në katet poshtë nesh.

Për të hyrë në karabina, ngjiteshim nëpër të njëjtën shkallare druri me kangjella me romba, shkallare që kërciste si drej e dëgjohej deri në fund të qytetit. Babai im nuk punonte më sipas traditës familjare e shkollimit, as si bankier dhe as si financier, por roje dhe magazinier në postë. Punonte i përkushtuar, i ndershëm deri në palcë, me orar e pa orar.

Tri nga xhaxhallarët e tij ishin pushkatuar si armiq të pushtetit, ndërsa gjyshi dhe njëri prej djemve, ai i madhi, ishin internuar në veri.

Në qytet kishte mbetur vetëm babai.

Fillikat dhe shurdhmemec.

Babai e mori motrën në duar dhe më dha shenjë të ngjiteshim pa u ndjerë, pa më të voglën zhurmë në shkallaren e shtëpisë. Ngjiteshim në majë të gishtrinjeve.

Vjedhurazi.

Derën e hapi me shumë kujdes.

Hymë në shtëpinë bosh.

Na uli në divanin e vetëm përballë qelqeve të dritareve të mëdha dhe na përqafoi si për herë të fundit në jetë. Na puti me rradhë.

Të parën motrën e vogël e pas saj mua. Atë moment nuk e kuptova arsyen.

Nxorri nga poshtë xhakët një pako të madhe me llokume.

E hapi me kujdes.

Ishin llokume të mëdha, me arra, nga ato që i provonim tepër rrallë, vetëm kur shkonim për vizitë tek dajot, vëllezërit e nënës.

Do hamë llokume sa të ngopemi - foli babai. Po nëna - s'mu durua mua që fluturoja nga gëzimi prej ndryshimit të papritur të babait që atë çast kishte folur.

Nëna është në punë.

Kur të vijë do hajë dhe ajo - foli sërish zëulët babai.

I dha llokumen e parë motrës së vogël. Ajo e kullufiti. Pastaj më ofroi dy copë mua.

E futi një në gojën e tij dhe shkoi të ndezë radion. Radioja transmetonte muzikë të çuditshme. Të padëgjuar më parë.

Ne i hëngrem shpejt e shpejt llokumet e para. Babai na dha të tjera llokume duke na i futur me dorën e tij në gojë:

Hani, hani!

Hanim me nxitim, pakuptuar asgjë.

Radioja vazhdonte të jepte muzikë të çuditshme.

Muzikë funebre, - tha për të babai, ndërsa spikeri me zë ngashëryes e të përballshëm lajmëronte popullin për ikjen nga kjo botë të udhëheqësit të partisë e diktaturës së proletariatit".

MARRËDHËNIE

Kërkoj të ndez një shpirt të fikur,
Të ftohur në vetmi,
E ftohem vetë pa e ditur,
Si moti netëve me shi.

Kërkoj të ndez një shpirt të fikur,
Betejë me shumë plagë,
E vritem vetë pa e ditur,
Si luftëtari nga një shpatë.

Kërkoj të ndez një shpirt të fikur,
Të djegur në harresë,
E digjem vetë pa e ditur,
Si flakë qiriri pa shpresë.

...
Kam tretur veten pa e ditur,
Fikur në mundim,
E vjen ky shpirt dikur i fikur,
Të ndezë shpirtin tim.

SINQERITET

Ndonjëherë unë qaj pa shkak,
Nuk qaj unë, qan poeti.

Ndonjëherë, dashuroj pa shkak,
Jo unë, dashuron poeti.

Ndonjë ditë do të vdes pa shkak,
Do të vdes unë e jo Poeti.

PËRQASJE

Ashtu si Akili ka një thembër,
Unë kam sytë, kam një lot,
Po të më vrasësh shikimin,
Më ke vlarë një horizont.

Një horizont më ke vlarë,
Dhe perëndimin përmbi det,
E verbër qofsha dhe e marrë,
Por me shikim të vërtetë.

...
Në pabesi si një Parid,
Nuk pres të më vrasësh sot,
Lermë të shoh perëndimin,
Me sytë e tu në horizont!

DY GJYSMA MALLI

Ky mall, bir, që më sjell te ti,
Nga ime bijë më ndan,
E ngelem një zemër mbi ajër, pezulli,
Si mjergull e dëndur mbi oqean.

Mbi oqean dy gjysma malli,
Zemra e Nënës në sinkron rreh,
E lotët fsheh nga vajza e djali,
Si mali që brenda thesare fsheh.

PRITJE

Ti vendose të më vdesësh në pritje,
E në pritje vërtetë po vdes,
Mos harro të vish me 1000 puthje,
Që si sfinks të ngrihem e në jetë të mbes.

ELEGJI PËR TIM VËLLA

Ilirit në 35 vjetorin e ikjes

Si në legjendë, vëlla i dashur,
Ti ngrihesh si Kostandini mbi kalë,
Sa herë thërras në dhimbje tretur,
Sa herë kërkoj frymën të ndal.

Ti je supi që kurrë se pata,
Je fjala e munguar,
Je zemra që më ndalet,
Dora që mbet shtrënguar.

Ti loti që kurrë nuk rrodhi,
Por brenda shpirtit u bë det,
Je brenga që kurrë s'më doli,



Je brenga që brengat vret.

Sepse nuk kisha tjetër,
Ta thërrisja vëlla si ti,
E s'pati kush në jetë tjetër,
Të ishte i lirë sa ti.

Se shkule rrënjë e tunde gjeth,
E barin krejt e ngrive,
E ike tretur në legjendë,
Portat e një qyteti mbylle.

Nga gjithë prangat jam çliruar,
Të jem e lirë sa ti vërtetë,
Por dhimbja prangë e plagë mbeti,
E s'munda të çlirohem dot një jetë.

Si në legjendë vëlla i dashur,
Ti vjen si Kostandin mbi kalë,
Sa herë thërras në dhimbje tretur,
Sa herë kërkoj frymën të ndal.

MIRËNJOHJE

Dikur mbi detin e trazuar,
Humba në kthim,
Mbi valë deti turbulluar,
Njoha një delfin.

Mbi delfinin nëpër det,
vetëm pa një shpresë,
Prej tij s'munda të shpëtoja,
Prej tij s'munda as të vdes.

Me delfinin luftova,
Dallgët bërë gri,
Gjithë detin e përshkova,
Mbi kurris të tij.

E kur deti u kaltërua,
E ndijnë yjet në qetësi,
Kur ra Hëna përmbi mua,
Ai ra në dashuri.

-Nuk të dua, më beso,
Të lutem o delfin,
Nga ky det më shpëto,
Më kthe në bregun tim!

Me lot në sy ai u nis,
E nuk e di se si,
Diku u vra, diku u gris,
E skuqi gjaku i tij.

E putha lehtë përmbi plagë,
Si me magji u shërua,
E iku shkoi përmbi valë,
Duke më thënë: Të dua!

ARRATISEM

Ti vjen andej nga vjen thëllimi,
Ç'më fut në shpirt kaq ftohtësi,
Unë arratisem nga kujtimi,
E në një qoshk të shpirtit rri.

Por ti më vjen ashtu papritur,
E ç'rrugë të sjell drejt meje prapë,



Si e gjen derën pa trokitur,
E pa një çelës si e hap?

Ç'më thua: Lermë moj mike,
Këtu ka vend për ne të dy,
Jam vlarë shumë që kur më ike,
Sot të kam unë vetëm ty!

Ti vjen andej nga vjen thëllimi,
Ç'më fut në shpirt kaq ftohtësi,
Një dritë më ndiz të njoh zhgënjimin,
A të ndej pak ngrohtësi!

NDAJNATË

(çast trishtimi në prag festash)

Këto drita dhjetori si agim në fikje,
Si qirin në lutje bashkuar në prag,
Santa Clausat varg murgjish gjakosur në
dhimbje,
E zilkat muzikë, këmbana shuar ndër natë.

KU JE?

Të kam thirrur,
Ku je?
Vala e detit ende përsërit,
Një pulëbardhë
flokun tim të verdhë, kKa nisur byzlyk të
artë
për dorën tënde të djalhtë.
Ku ishe?
Qielli u çka nga vetëtima mesazhesh
dhe Hëna u lodh
duke mi lidhur plagët
me fasha ndriçimesh.
Se ke ndërë?
Deti e Qielli
vibruan njëherazi
me ankthin tim.
Po ti ku je?
Vala e detit ende shushurin.

KAM GJETUR NJË SHTEG

Oh, ç'kam gjetur unë një shteg,
Të arratisemi sot të dy,
Por kalon rruga mes yjesh,
Hëna të mos jetë aty.

Po të jetë Hënë e zbehtë,
Në shpirt do ndej pikëllim,
Do të largohem fare lehtë,
Nga i yti përqaftim.

Po të jetë Hënë e plotë,
Frikë kam nga dritë e saj,
Me gjuhë netësh do më thotë,
Se ç'ke bërë në çdo skaj.

Po të jetë Hënë e ngrënë,
Do të rrimë mbi të, të dy,
Yjet larg do ti përzemë,
Se ç'do bëjmë pastaj? Se di!

VRASJA E RIMËS

Tani do të shkruaj në varg të bardhë,
se rimën ma vlarve ti,
Duke ecur vjeshtës së çalë,
Si gjethe kërcisnin vargjet,
Nën këmbët e stërmëdha.
Pa mëshirë,
gjakosje rimat,
këngët.
Me sy të bardhë
e këmbë të shtrembëra,
ti ikje,
vargun tim duke vlarë,
Ti ikje
Vargun tim të vrisje,

DY QIEJ

Jam larg me ty tani, e di,
Na ndajnë midis dy qiej,
Një qiell mbi mua rri,
Nën ty një tjetër qiell.

E lart pot ë hedh sytë,
Një yll të kërkoj,
T'i lutem përgjërim,
Ku fshihesh të tregojë.

Dashuria mund gjithçka,
Kujtimet bëhen dritë,
E qiejt s'mund të ndajnë,
Atë që shpirtit ndrin.

Po të mundje të vije,
S'do ishe thjesht një flutur,
Që ngazëllyer vjen,
Të më bësh më të bukur.

S'do ishe thjesht një lot,
Një dhimbje që s'gjen fjalë,
Dy qiej bëhen një,
me dashurinë që mbajmë.

...
Jam larg tani me ty,
Na ndajnë midis dy qiej,
Një qiell mbi mua rri,
Nën ty një tjetër qiell.

KUJTIME

(për Nënë)

Ka vargje që më mallëngjejnë,
Dhe këngë që më shkrehin në vaj,
Kujtime ku shpirti dhemb,
E lot që dot s'i mbaj.

Të pres në qoshen e preferuar,
Që kafen të rruftisim me zhurmë,
Më pas të qajmë të qeshim,
E të mallohem ca më shumë.

Ka vite që më rikthehen,
E ti je përherë aty,
Rreth teje kurora e harresës,
E përjetësia përherë me ty.

Të pres në qoshen tënde,
Të të them një mijë herë "më fal!"
Për gabime, faje, mirënjohje,
E në prehër të dremis pa fjalë.

Si dikur kur sulej kuçedra,
E burimin krejt e thante,
Si dikur në përrallat e vjetra,
Ku shpirti femënor qante.

Si dikur, kur qetësia,
Prehrin tënd bënte dritë,
E Bota ish nën këmbët e mia,
Mjaftonte të të shihja sytë.

Të pres në qoshen tënde,
Që bashkë të kuvendojmë,
E forcë nga fryma jote,
Shpirtit të m'i shtojë.

Ajo rrinte në këmbë, me shikimin nga A dritarja e madhe. Drita e verdhë e mbasditës futej me përtesë. Ishte një plogështi drite fundgushti, ku ndiheshin edhe pse të pakta, shkëndijat e para të vjeshtës. Një dritë e kthjellët, por më e ftohtë, më e kursyer, më e mbarsur me freskun e shtatorit. Tutje xhamit të madh, tek tuk, ca re përtaçe, rrinin pezull mbi qiellin kobalt. Përtej dhomës së madhe, që nga perdja e mëndafshhtë ngjyrë qumështi shquheshin tjegullat e qytetit. Tymtaret, antenat si dhe kryqet shquheshin gjithkund. Ishte vërtetë një mori e kuqe tjegullash, por nuk kuptohej mirë ç qytet ishte. Me siguri flitej për një nga ato qytetet e mesdheut ku dielli është i pjekur, i verdhë, i ngrohtë. Kish veshur një fustan të zi prerë thjeshtë, i cili ja zbulonte një pjesë të kofshave. Fustani xixëllinte i tëri nga dritëza e vogla të cilat si yje ndizeshin dhe fikeshin mbi trupin e saj. Mbi fustanin ngjitur me trupin prerë me fyt U, mbante një varëse floriri, e cila i zhytej brenda fustanit. Ishte një fustan mbrëmje, i cili ja zbulonte format e trupit. Nga ato rrëzëllitëset, me fiye mëndafshi dhe poliester, nga ku sipër vitheve, përreth mesit, i varej një zinxhir i kabashëm ngjyrë ari. Çantën e vockël të lëkurës e kishte mbështetur mbi divanin veshur me damask. Tek e kqyrte nga cepi i tij, ku rrinte ulur me shampanjën në dorë, i shihte shpatullat e larta, flokët e mëndafshhtë, të dendur që i derdheshin bukur mbin supet që cilët i mbulonin qafën. Rrinte krejt e heshtur, si e përpirë nga drita, paksa e ftohtë dhe me një freskurë të çuditshme fundvere. Edhe ajo, mbante gjithashtu një gotë kristali me fron që i rrëzëllinte në dorë, nga ku shquheshin bulëzat e shampanjës shkumëzuese.

Me siguri po shihte ëndërr. Takimi po ndodhte në ndërgjegjen e dikujt. Jo më kot gjithçka ishte sa e mundshme, po aq e pamundshme. Gjëja më e panatyrshme ishte se edhe pse flitej për një ëndërr, ajo që po ndodhte kishte një llogjikë të egër racionale.

Pastaj ajo u kthye nga ai, buzëqeshi dhe ndenji ashtu, duke e fiksuar me sy. "Sa herë që udhëtoj!" i tha. "E bëj natën. Ndaj nuk kam as orare, as plane, as qëllime!"

Më tutje shkeli me këpucët e holla mbi tapet, plot hijeshi dhe kujdes, derisa iu ul pa zë mbi divanin përballë. Nga sytë fare të zinj, lyer vëmëndshëm me rimel, qepallat ishin nxirë aq shumë sa dukej se ja kishin shtuar ëmbëlsinë e vështrimit. E pa me sytë e dashur. Kishte në ato sy, admirim, dritë, emocjon. Buzëqeshi pak, lehtas, plot mirëdashje ku kishte një përzjerje mirnjohjeje, vlerësimi dhe kurjoziteti. Një kurjozitet grishës, i cili shquhej që larg. Ajo nuk po i bën sytë e ëmbël në atë kuptim! Është e natyrshme! mendoi ende. Kur gratë kalojnë të pesëdhjetat fundbarku fillon dhe ftohet! Nuk e dinte ç'të mendonte. Dikur, kur gjaku i ziente fort dhe e vetmja vajzë që i kishte pushtuar fantazinë ishte kjo zonjë, atëherë, po, do ta kish dëshiruar me zjarr dhe lot. Por tani, ishte më shumë një takim kërshërie dhe malli të çuditshëm. Si të ishte epilogu i një ndodhie që nuk kishte ndodhur kurrë. Një përmbledhje, bilanc mbi të gjithë dështimet e tij.

Heshtja u pllakos çuditshëm. Ajo e uli vështrimin, e mbështeti gotën e kristaltë me fron mbi syprinën e qelqtë të tavolinës, mori paketën, nxorri një cigare të hollë të bardhë, e ndezi dhe e thithi fort. Kornizat me piktura mbi mure, ngjyra krem e murit, rafti me librat më tutje, vazot prej qeramike, gjithçka dukej sikur kishte veshë, sy, shqisa. Ndërsa në fund, në mugëtirë, gjendej një minibar. Një trafik i çuditshëm emocjonesh i lëvrinte në shpirt. I vështronte qafën. Shpesh kishte menduar se qafa e një vajze flokëshkurtër, kishte vërtetë diçka tejet të brishtë dhe erotike. Aty, në linjat e saj harmonike, në ngjytjen e saj nga rreza e torsit deri afër veshëve, ndryhej edhe dëshira më e egër

ARTUR SPANJOLLI

Aromë lulesh prilli

Tregim



e burrit. Dukej sikur së bashku me linjat elegante të një qafe femre, të shtohet tek sytë e burrit edhe ëndërra në rritje e një pasjoni ulëritës. Qafa e një vajze, vërtetë kishte diçka të mistershme. Dukej sikur ajo e ftonte burrin për mëkate. Ai për një çast, tek qëndronte me shpinën mbështetur tek divani i rehatshëm, e shihte pa turp. Kohën e kishte të kufizuar, sikur ajo tjetra, nga çasti në çast të zhdukej. "Sa vite!" mërmëriti, "kam pritur këtë çast!" Ajo i buzëqeshi këndshëm. Dhe bashkë me buzëqeshjen, mrekullisht iu shtua edhe drita në vështrim. Një dritë e ftohtë, plot shkëndija të zeza që i vezullonin nga bebet e syve. Ishin plot mister, veshur me një brerore qiellore. Po e shihte ende. "E di!" vazhdoi ai, "Ju nuk jeni e vërtetë. Këtu asgjë nuk është e vërtetë. Ju jeni veç një projektim iluzjonesh. Por edhe pse është kështu, jam i bindur se ne një ditë do të takohemi. Do të jetë triumfi im, ngazëllimi."

Kish ndryshuar. Ishte më e mbushur nga ç'e mbante mend. Tek supet, më e plotë, mjekrën më të rrumbullt, faqet më të fryra, por kur vështronte e ruante hijeshinë joshëse. Flokët ia mbante mend të prera me baluket mbi ball të drejta mbi supe, ndërsa tani nga qendra e kokës dy baluke të mëdha i zhvilloheshin në anët e tëmthave. "Dyzet vjet!" thanë sytë e saj. "Që vij e iki, veç nëpër ëndërra!" Ai nuk e dëgjoi me vesh por me zemër. Por ndiqte si i fantaksur mërmërimën ndër buzë, ngjyer me të kuq, si skepa dallëndyshje. I kishte dhëmbët krejt të bardhë dhe të rregullt. "Kush jeni?" e pyeti ai me zërin e fortë dhe kurjoz. "Unë ende nuk e di kush jeni?"

Ajo u gjallërua. Lëvizti, shkundi kokën, mbështeti cigaren e ndezur mbi një tavull, vuri bërrylat mbi gjunjët e zbuluar nga ku i dilnin kofshat as shumë të shëndetshme as shumë të dobëta. Kish veshur geta të errta, transparente, pastaj gishtat grusht, i vuri poshtë mjekrës. Këpucët e holla, të zeza, me gërsheta mbi qafë dhe me maja, ia shtonin elegancën trupit të saj. Gruaja! mendoi ai. Misteri më i madh i krijimit! Tani ajo kishte një buzëqeshje disi ironike, zhytur në reflektime. "Unë nuk dal kurrë nga ëndërrat!" i tha. Kishte një zë plot thërmija të ftohta dhe të ëmbla në të njëjtën kohë. "Jam ajo që ti ke vendosur të jem. Një vegim mëngjesi, ylli polar, vetmia e netëve, muzika jote e fjetur, ndoshta!" Ai nuk ngopej së sodituri. Ja kundronte me afsh flokët e mëndafshhtë ngjyrë gruri, ballin plot dritë, vetullat e holla dhe sytë e thellë, të zinj, krejt mjaltë dhe vëmendje, të cilat, në atë çast, ishin veç të tijat. Kish humbur në ato sy si i mahnituri në pyllin magjik të pavetëdijes.

"Gratë si ju duhet veç të buzëqeshin!" i tha. "Ju e keni prerë biletën për parajsë!"

"Kush jeni ju që flisni me kaq bindje?" "Krijesa si ju, të bukura jashtë edhe brenda, shkojnë drejt edhe tek drita e krijuesit!"

"Fjala juaj në vesh të Zotit!" tha ajo. Pastaj buzëqeshi rishtaz, bukur dhe kur buzëqeshi fytyra iu përtëri drite. "Ju nuk jeni më as objekti i epsheve, as gruaja me

të cilën bëhen projekte jete. As shoqja e rrugëtimit, as e përcëlluara sekrete, të cilën sa më rradhë e takon aq edhe më me pasjon e dëshiron. Kush jeni atëherë?"

"Përgjigjen gjejeni vetë!" ia ktheu. "Unë s'jam veç një robinë e sajuar nga ju. Çfarë kërkoni, aman? Amëshim? Kërkoni dhembshurinë e Hyjit, apo ndoshta përsosjen morale? I besoni ndoshta fjalëve të Krishtit: *ajo ka mëkatuar, por edhe ka dashuruar shumë!*"

"Jo!" ja ktheu. Ju kam identifikuar gjithmonë si pjesë e Hyjit. Si një krijesë e mbrujtur me zjarr yjesh dhe ëndërr poetësh të krisur. Sa herë ju kam parë, aq herë kam ndërë ngazëllimin, lotët e lumnisë, vetë shkëndijën e shenjtë!"

"Kjo është blasfemi. Ju nuk duhet të krahasoni një të vdekshëm me Hyjin!"

"Kur ju shihja që kaloni rrugës, ende e vockël, i goditur nga bekimi i mallkuar, pikasja tek ju, gjithë vrytytet më të larta njerëzore. Aq shumë ju kam idealizuar, sa më shtytë vetvetiu drejt artit. Ndaj u lodha për vite me radhë në përsosjen së fjalës. Doja të shpreheshja sa më mirë për ju! Sa herë që ju pikasja, ndjeja një ngazëllim të thellë, një lumni e cila është e krahasueshme veç me hyrjen në parajsë. Ju ishit zjarri i shenjtë në shpirt. Hyrja madhështore drejt parajsës, të cilën, asokohe as nuk e njihja fare! A thua lindim veç për t'u orvatur në gjetjen e gjysmës tjetër?"

Ajo nuk diti ç të thoshte. E ndoqi mendimin me sy, pastaj e ngriti pak kokën. "Në gjahun e dashurisë synohet lart!" tha. Tani ndjehej e mikluar në shpirt. Sikur bashkë me fjalët, një energji e çuditshme duke dalë nga goja e ligjëruesit vetmitar, të pushtonte etermin dhe pastaj, krejt padukshëm të futej tek veshët e saj duke u shndërruar në rrezatim. Kjo është fuqia e komplimentit! mendoi. Veç ta ndej nga goja juaj një fjalë. Pasuria dhe fama, s të bëjnë mbret. Por ajo që ju thoni, po!

"Ajo që ju quani art, është thjeshtë ispirimi që figura e juaj më fal pa droje, pa sforcim, natyrshëm. Dhe ky afsh arkan, i mistershëm, vjen çuditërisht si të kishte flatra engjëlli. Duket e çuditshme, por shpirti është i ndërëtur në mënyrë të tillë që të ndizet magji!"

Ajo e pa mendueshëm. "Dyshoj se ju nuk jeni gjë tjetër, veç se një ëndërrimtar pasiv, i cili pret që të zbresë mana nga qielli!"

"Gjithçka është e pamundur, e padobishme. Kam frikë se kur të zgjohem, do shembem nga iluzjoni zhgënjyes. Ta lëmë ashtu: gjys ëndërr gjys të vërtetë, si një zjarr që nuk shuhet kurrë. Një dritë që ushqehet me lëndën e vet!"

Ajo e ngriti gotën dhe e drejtoi nga larg sikur të thoshte gëzuar. Anoi pak kokën. Atë kokë të bukur ende vajzërore. Një kokë fantastike, por e pamundur. "Ndoshta është më mirë që takohemi në ëndërra. Gjuetarë fantazishë. Shfaqemi, ngacmojmë, zhdukemi. Thjeshtë sa për t'ofruar lëndën ngazëlluese!"

Ishte ai që ra në mendime tani. "Ti ke qenë muza!" i tha. "Dhe ashtu të dëshiroj!"

"Nuk dëshironi pra që të takohemi në jetën reale?"

"Jeta reale?! Ç është ajo? Gjysmën e saj ne e jetojmë brenda nesh, në formë joreale. Ajo na pushton krejt, na mbush me mrekulli dhe zhgënjim. Veç brenda nesh, ne jetojmë jetën e vërtetë. Ajo është akoma dhe më reale, interesante, e madhërishme se vetë jeta fizike. E cila në përgjithësi është e mërzitshme dhe monotone."

Burri kishte veshur një kostum të zi. Poshtë xhakëtës së teritalit, mbante një bluzë të errët me fyt V, e cila kontrastonte me flokët ngjyrë bakri me onde. Në pulsion e majtë mbante një orë të rëndë me zinxhir hekuri dhe tek gishti, ngjeshur unaza e martesës. Ajo e dinte.

Nuk ishte as i imët, as i bëshëm. Këpucët i kishte të zeza, të reja, shkëlqyer nga llustra e sapo dhënë. I mbante pëllëmbët mbi gjunjë, të hapura, gishtat kish mbuluar kërcinjtë e gjurit. Mbi gotën e kristaltë, shampanja çlironte flluska të vogla. Flokët i mbante krehur me kujdes nga ku dilte një ballë plot dritë me dy të dala sipër vetullave. I binte një si nur plot hije nga ai çast aq i shumëdëshiruar. Si në një seancë spiritiste, të kam ndjellur që nga fundi i botës! dukej sikur thonin sytë e tij.

Rrinte ashtu, me qeset e syve, buzët disi të mbledhura, dhe sytë plot trishtim. Një trishtim fisnik por edhe i ndrydhur. Kur fliste, me tingujt, i çlirohej një si dhimbje, pikëllim i çuditshëm. "Është thellësia e ndjeshmërisë!" ishte përgjigjur kur i kërkuan arsyejen a asaj shprehje prej të rrahuri kokëulur. "Do të jetë dhimbja!" shprehej. "Unë jam njeri që ka vuajtur në jetë!"

"Kështu pra!" vazhdoi ai me një grimë ironie. "Fati ka vendosur që të takohemi veç në ëndërra!"

"Më bukur, apo jo. Ju më ndillni, unë vij dhe kur zgjoheni, ju mbetet ndër duar veç pahu i artë i flatrave të mia. Lënda e çuditshme për krijim, si brumë yllësishë dhe ëndërr!"

"Mos më thoni se edhe ju jeni veç pjellë e fantazisë. Ta dini, që ju jeni e vërtetë. Në ndonjë cep të botës ju merrni frymë, bëni pazarin, shfryheni nga taksat e larta. Si çdo njeri, keni frikë nga sëmundjet!"

"Për ju, unë jam ajo që jam. Fill i hollë frymëzimi, që materializohet veç nëpër ëndërra. Mos u orvatni të më gjeni. Nuk do t'ja dilnit kurrë. Edhe sikur t'ju rrefeja se ku gjendem, s do të vinit dot kurrë. Edhe po të më gjeni duke më kërkuar nëpër ëndërra, do t'a kuptoni që..!"

"Çfarë?"

Ajo tërhoqi pak muskulin e buzës së djathtë, dhe iu shqua ndër sy një grimë sarkazëm përzier me mosbesim. Nuk foli. U ngrit, eci drejtë me atë hovin rinor, i cila, edhe pse kishin kaluar vite, ishte i njëjlojtë. Ishte një ecje prej dreri kryelartë, ëndërrimtare, disi kryeneçe, si të ishte një artiste që jeton e lirë, mbi të gjitha, e shijon jetën.

"Kam ardhur veç për t'ju ofruar ëndërra!"

"Unë nuk dëshiroj trupin tuaj zonjë." Ja ktheu ai. "Dikur! Kur digjeshja nga afshi për trupin tënd, kushedi ç hata do të lindte. Tani, synimi është shpirti juaj. Skajin më i thellë i qenjes tuaj. Trupi ndryshon, shëmtohet, por shpirti mbetet gjithmonë i ri. Ai është i përjetshëm!"

"Nga e dini ju?!" e pyeti.

"Atje," shtoi ai dhe drejtoi gishtin sipër, "do të jemi 30 vjeçarë!"

"30 vjeçarë?!" u habit ajo. Një mahni plot surprizë iu duk në shkëlqimin e syve.

"Sa çuditshëm. Ngjuar veç nëpër ëndërra! Kimera që s do kenë as fillim, as fund!" tha. E toku gotën. Tringëllima shëmbëlleu e çuditshme. Një si krisje ciflash qelqi u përzie me dritën. Tingujt u përhapën në dhomë me një intensitet të çuditshëm, si të vinin nga humbëtitrat e kohërave.

"Aq fort të kam dëshiruar!" u shpreh ai,

“sa edhe vetë dielli do të lutej për përdëllim!”

Një tis i ngrohtë dhembshurie, i ra ëmbëlsisht në tipare. “Dashuria është meskine!” tha. “E pashpirtë. Ajo udhëhiqet nga ca impulse të pakuptueshme, të cilat i mposhtin ligjet e arsyes. As vetë nuk e dimë, por ja që diçka na pëlqen, na tërheq. Një zë, një tipar, një aromë, një buzëqeshje. Ndaj fillojmë dhe e dëshirojmë fort. Na gudulis botën tonë, na ysht të ëndërrojmë. Ja kështu fillon magjepsja dhe biem në dashuri me dikënd!”

“Simbas kësaj llogjike!” foli ai, “mund të pëlqehet edhe dikush që as nuk e meriton fare dashurinë e një kryefemre!”

“Arsyja s’ka lidhje fare me përfshirjen e emocjoneve!” vazhdoi ajo.

“Keni qenë kaheër një vegim Itake për mua. Klithmë e ndrydhur, burim ku nuk më lejohej të ngjishja buzët për t’a shuar etjen. Ke qenë pritje dhe ofshamë. Ç kam fituar? Ç të kem fituar vallë?”

“Përjetësinë ndoshta!”

“Atë të tej jetës?! Të ushqehesh me iluzionin se një ditë do t’ju takoj gjithkë?! Broçkulla? A ndoshta jo. Nuk e di. Do të më pëlqente, por kam frikë se besoj atë që shoh dhe prek. Kam humbur besimin, më vjen keq!” tha kështu dhe burri shfryu. “Oh ngushëllim iluzjonesh! Ndoshta përtej s’ka asgjë, ndoshta gjithçka. Mjerisht, ajo që kam të sigurtë tani për tani, është veç forca e imagjinatës dhe frika nga pusi i zi!”

“Ju flisni kështu? Ju që për vite keni kënduar Lart?!”

“Oh kam humbur perlën më të shtrenjtë. Dy herë fatkeq. *Ahime a me!*”

Gruaja buzëqeshi hidhur. Tani iu ul fare pranë. Aq pranë sa ai ndjeu firomën e saj të akullt si një gjarpër në errësirë. Kishte një aromë lulesh prilli, që çlirohej natyrshëm nga lëkura e saj. E ndjeu ngrohtësinë e saj, e cila tani buronte nga vithet dhe gjoksi. Rrinte e ulur në cep të divanit, e kthyer me një gjest të hijshëm, plot mirësjellje. Gjunjët i mbante të puthitur, përkulur nga e majta. Mbi kofshat e bukura, kishte mbështetur krahët e zhveshur, dhe me dorën e djathtë shtrëngonte ende kupën e kristaltë.

Tjetri, vëzhgonte duart e saj. Këto janë duart që më kushtuan aq lot! mendonte dhe nuk ngopej së vëzhguari. Kjo zonjë, i vetëtiu në tru, ka ndërruar lëkurë minimumi shtatë herë. Kur e vërente ende adoleshent, me sytë e marrëzisë, atë dorë, e kujtonte më delikate, fine, të hollë. Nuk e kishte atë cipë dhjami, e cila, mbas të 50tave ishte e paevitueshme. Dikur, lëkurën e kishte më të brishtë, më të ujshme. Tani, qelizat, me kalimin e dhjetvjeçarëve, të fryrë dhe plakur, e kishin humbur disi elasticitetin e tyre. Nuk kishte rrudha përve atyre anash syve, fshehur nga mrekuillitë e kozmetikës. Krahët i kishte më në mish; por kur buzëqeshte, ia kujtonte ende kohën e largët të dashurisë, kur ai, krejt i magjepsur, çalltiste si i krisur. Ngaqë nuk e kishte pranë, i ishte dashur të krijonte një të rreme.

“Ja ç jeni!” i tha. “Një sozie!”

Ajo e zhibiroi me syte e zinj dhe qeshi. “Ndoshta!”

Rrinin akoma si brenda një ëndërre. Dy qenje të cilëve i ishte e ndaluar rreptësisht të takoheshin mbasi të zgjoheshin. Sikur fantazia të ishte eprorë karshi jetës mbushur plot mërzi.

“Nuk e kuptoj?” shtoi ajo. “Përse nuk e vini shpirtin në paqje?! Unë nuk egzistoj, jam thjeshtë një ëndërr.”

“Unë këtë kërkoj, sublimitetin në art!” i tha.

Ajo tani fliste por nuk kuptohej. Kur mërmëriste fjalët, i lëvizte buzët e holla me një koketëri prej aktorje ledhatare. Ai, i vërente me kujdes buzën e sipërme, e cila kur lëvizte duke sajuar zanoret dhe bashkëtingëlloret, bëhej gjithnjë edhe më nazike. I pëlqente aq shumë, sa lëvizja e tyre, tërheqja gjatë buzëqeshjes, qepallat dhe qerpikët krejt të zinj, lyer me kujdes, sytë

nga ku dilnin ca vezullime drite të ëmbëla, bënin që burri të dehej krejt. I kujtohej koha e largët. Sa më shumë e shihte, aq më shumë mbronte tezën se kish qenë vërtetë dashuri. Më vonë do të njihje edhe shumë dashuri të tjera. Mishtore, të vërteta, por ja që ato, kishin qenë ndryshe. Kishin qenë veç aventura mishi, plot epsh dhe lotë, por krejt ndryshe. Kjo kish qenë sa e pavërtetë, po aq edhe e madhërishtme. Dhe ç dashuri?! Nga ato që lindin poetë të mëdhenj. Pak nga pak, kishte zbuluar se dashuria kishte me qindra aspekte, nga të cilat, më e çuditshmja, më e pabesueshmja kishte qenë kjo. Një dashuri e gjetur veç në veprat më të mëdha të njerëzimit. Nga Homeri, tek Dante, Servantesi, Gëte, deri tek Shekspiri.

“Ishte dashuri!” mërmëriti duke e parë në sy. Qelqet tringëllinë akoma, me një tingull të kristaltë. Një tin tin krejt të hollë, delikat si një fill ajri i qelqëzuar që thyhet në perëndim. Shiheshin pa turp, si të donin të zbulonin ca sekrete shpirti që e tejkalonin llogjikën. Që preknin sferën e pandërgjegjes.

“Ndoshta!” ja ktheu ajo. “Mos harroni se tani, jeni duke folur me një krijesë sajuar nga ju!”

Burri nuk foli. Kishte adhurim tek bebet e tij. Një adhurim, i cili shkonte deri në magjepsje, sikur gjithçka të ishte një artefic i një seance spiritike. A ishte ndoshta në dramën e Faustit kur hyri në skenë Margerita? A ndoshta në çastin kur zbriti Beatricja, veshur me mantelin kuq-jeshil? Ja shqyrtonte tiparet një e nga një. Linjën ovale të nofullave me mbylljen e ëmbël në mjekërr. Ballin e lartë, krejt të lëmetë, mbajtur me kujdes. Faqet pak të fryra, plot shëndet. Habitej. Gruaja, vërtetë e kishte humbur disi sharmin rinor; por ende i ruante linjat e bukura, vështrimin e thellë, qeshjen hyjnore.

“Pas pak ju do të zhbëheni!” i tha. “Dhe më duhet tju rikrijoj me fjalë!”

“Ndoshta ky është misjoni yt!”

“Eh!” ja ktheu ai. “Jeni e madhe sepse e ndaluar. Jeni e madhërishtme, sepse e paarritshme. Hyjnore, sepse e idealizuar nga dallitë e kimikës. Një krijesë që ushqen veç ëndërra artistësh. Çuditërisht, ju i ngazëlleni me fjalë poetë!”


Nga tutje xhamit drita po shuhej pak nga pak. Një dritë gri, e fortë, e dendur si një muzg brenda dhomës. Ai zgjati krahun dhe ndezi një dritë anësore.

“Gjëja që nuk kuptoj!” vazhdoi ai, “është se që nga koha kur lëngoja, ju keni fjetur fare e pa shqetësuar. Zgjuheshit ndonjëherë, e mjergullt dhe e paqartë, pastaj flinit ende. Flinit gjithashtu edhe nëpër copa letrash, fletorësh ku kisha shkruar vargje pa fund. Gjendeshit gjithkund nëpër faqe letre, ku ende shquheshin njollat e lotëve të derdhur. Më vonë, kur unë mendova se nuk do të zgjuheshit më kurrë; se do të humbeshit përherë në pyllin e pavetëdijes; ja pra, së bashku me gjuhën e nënës, u zgjuat edhe ju!”

“Jeta është plot dështime!” tha ajo. “E shkuara gëlltitet duke jetuar për të ardhmen!”

“Unë ju zgjoj dhe ju ndjell veç për lëndën e parë!” tha ai. “Ju jeni virgjëresha e së ardhmes.”

Ajo shqiptoi këto fjalë, pastaj i hodhi një sy orës së dorës. U bë tepër vonë, mendoi. Çuditërisht, ajo nuk shfaqte shenja padurimi. Ndenji ashtu gjatë. Pastaj, pak nga pak, bashkë me muzgun, filloi të venitej gjithçka. Duart, këmbët, qafa, gjoksi, sytë dhe flokët e saj. Ai pa se si po shbëheshin, si në një ëndërr të tjeterr në gjumë. Gjymtyrët e sajuara nga ajo substancë e çuditshme, si një rrjet merimange, u shkrinë krejt. Të tjera orendi, si të ishin fije dëbore, po shndërroheshin në mjergull. Tutje dritares së madhe, pak nga pak, muzgu i një qyteti të panjohur po vazhdonte të binte. Paska ardhur vërtetë veç për t’ofruar ëndërra! mendoi dhe u zgjua.



Botim i ri nga Minerva

LEV TOLSTOI Kalendari i urtësisë

Përkthyer nga Granit Zela

Ky është libri që vetë Tolstoi e konsideronte si kontributin e tij më të çmuar për njerëzimin dhe që është njëkohësisht dhe vepra e viteve të fundit të jetës së tij. I lexuar gjerësisht në Rusinë e para revolucionit, i ndaluar dhe i harruar gjatë komunizmit dhe i rizbuluar e i prituar me entuziazëm të madh, “Kalendari i urtësisë” është një udhëzues i përditshëm që ndriçon rrugën drejt një jetë të vlefshme e të virtytshme me një dritë që as koha nuk e zbeh dot.

Ky libër, i censuruar pa të drejtë për gati një shekull, meriton të vendoset në krah të librave të paktë të historisë sonë, që na mësojnë se çfarë është më e rëndësishme në këtë botë.

“Uroj që lexuesit të provojnë të njëjtën dashamirësi dhe ndriçim që unë vetë provova teksa punoja për krijimin e këtij libri, dhe që i provoj vazhdimisht teksta e rilexoj çdo ditë”.
- LEV TOLSTOI, mars 1908

Le të themi se Tolstoi është transcendent dhe se i jemi mirënjohës që ka jetuar mjaftueshëm gjatë, që të na dhurojë trashëgiminë e tij të madhe.
- THOMAS KENEALLY
autor i Lista e Schindler-it

MBRËMJE

Një yll i vetmuar
Atje lart shkëlqen,

Syri im i etur
Tretet në eter.

Ylli përmbi tokë,
Unë nën këtë qiell,

Ai diç më thotë
Unë diç i them.

1972

SONTE

Sonte nuk kam gjumë
Ma vodhën yjet cinxëri -
Zemra ime sonte
Si deti nën hënë shushurin,
Jam hedhur
Në krahët e mëndafshhtë të natës,
Në sy më flenë
Dy kulumbri dhe një bukureze :
Sonte jam universi
Qe fsheh mistere.

1973

SI DHJETË VJET MË PARË

Dëborë e bardhë si ëndërr fëmijërie
Peizazh i shtrenjtë që shpirtin ma ngroh,
Nën plojë e butë të kristaleve magjike
Harroj se ka trishtime kjo botë.

Fluturat më ulen në sy e në duar
E zemra më lutet të qesh marrëzisht,
Të kthehem sërish në ato ditë të arta,
Kur u njohëm bashkë e u bëmë miq.

Prapë jemi miq, kjo është e zakonshme
Por dhe e pazakonshme njëkohësisht,
Vështrimet tona të pastra si loti, janë ftohur
E tronditur ndonjëherë, pa dyshim.

Por ka mbetur dashuria e plotë si një diell,
Që prapa reve i bukur dhe i zjarrtë rri
Dhe është e domosdoshme në këtë kohë të
sertë,

Si dita e kthjellët pas një moti me shi.

Kjo bardhësi hyjnore që prej qiellit bie,
E nusëron qytetin e dashurisë sonë,
Një vogëlush që nga sytë dhe balli është ti,
Futet mes nesh e me borë na qëllon.

Bajram Curri, janar 1983

MË KA MARRË MALLI

Më ka marrë malli për të qeshurën tënde -
Gurgullimë ujërash pranverorë,
Degëz e çelur lulemollë.

Për sytë e tu -
Burim i kulluar që ma huton vështrimin,
Pasqyrë ku më duket vetja e bukur.

Më ka marrë malli për dorën tënde -
Rreze agimi që zgjon ujërat e blerta.
Krehër hëne që çlodhet në kokën time.

Për profilin tënd -
Vizatim i druajtur dhe kryeneç
Yll që më tërheq në orbitë.

1984

NE BAJRAM CURRI

Të vish edhe njëherë këtu
E të zbulosh gjurmët e rinisë tënde.
Të zgjosh ëndrrat e çuditshme që ke pasur

FERIDE PAPLEKA

Poema dashurie

Të rikrijosh veten tënde të dikurshme.
Të dëgjosh të qeshurën e pafajme të
dashurisë.

Të ndiesh druajtjen e puthjes së parë,
Të sjellësh në mend përfaqimin pas një
trëndafil.

Gezimin tënd për fëmijën e parë
Dhe ta kuptosh se jeta është një lumë,
Që rrjedh teposhtë me rrëmbim ;
Pastaj t'i lësh të gjitha këto
Dhe të soditësh fytyrat e njerëzve
Që të kanë dashur

E i ke dashur,
Të takosh vajza e djem,
Që të kanë parë në sy
Të rishohësh prushin e zjarreve të
dikurshëm

Në sytë e tyre,
Sepse "shpirti i nxënësit
Është një zjarr për t'u ndezur"¹⁾
Dhe të përtërihesh.

1985

TI ISHE QIELLOR

Ti ishe qiellor,
M'u desh të bëhesha me flatra për të të
mbërritur,
Koha pas meje rrëshqiste si trëndafil i rërës,
Ditët e mia i ngjanin Spirales me ëndrra
Që e turbulluan Gëten;
Duke ardhur drejt teje,
Sy burrash të tjerë më kanë vështruar,
Sepse çdo grua është një Tokë e Premtuar,
Por mua të tërë më dukeshin Zota pa qiell.

10 janar 1990

NGANJËHERË

Nganjëherë më grisen të gjitha velat
Dhe dallgët e mendimeve më përplasnin larg,
Dëgjoj brenda meje krakëllima, rënkime,
Si në anijethyerjet e mëdha.
Kur dua të mbledh partallet,
Për ta bërë prapë atë që ishte UNE,
Arrij ta kuptoj humbjen ;
Sytë i mbaj hapur, por nuk shikoj,
Goja më kyçet.
Me kë të flas ?
Ndërsa ngrihen rreth meje aq e aq mure,
Atëherë më josh kënaqësia e panjohur
E një fundi ku mbretëron Hiçi,
Por të shoh ty i dashur
Dhe drejt teje vij
Si drejt një limani plot dritë e kaltëri.

APOKALIPS

Kur mungon ti
Mbarë gjithësia përmbysët
Dielli jep shpirt
Në ujërat vdekëtare,
Hëna dhe yjtë
Marrosen nëpër humnera,
Pa e ditur që atje është fundi i tyre,
Lulja e zbehtë e Narcisit rritet
Më e lartë se Kulla e Babilonit.
Qielli zvogëlohet:
Nuk ka vend as për Zota
dhe Olimp,
As për parajsë;
Shumë shpejt edhe zogjtë do të vdesin
Nga Përmbytja e shpirtit tim.

LUTJE

Do të desha që me një nga durt e tua
Sonte të krijoj një lule të rrallë
Trëndafil që zemrën me aromë ta shuaj
Ose dhe zambak që ta mbjell mbi varr.

A ma premtton dorën tënde të shtrenjtë,
Që të lindem një grimëz për herë të dytë,
Shpirtin të deh nga drita jote e diellit
Dhe në çastin kobzi t'i mbyll e qetë sytë.

1995

NATYRË E QETË

I
Diell që perëndon
Qiell i portokalltë
Tinguj në dhomë
Puthjet tona të harruara
Vështrimet tona të hutuara
Heshtja vrastare
Dhe duart tona,
Dy pëllumba
Që kërkojnë të ngjiten në qiell.

II
Fytyrat tona të lodhura
Kundërshtojnë pasqyrën
Dhe gjërat e ndriçuar,
Hapësira e pafund është
Si një pamundësi
Për të shkuar larg -
Lulet që mbloodhe për mua
Këtë ditë pranverë
Përgjojnë mbi tryezë.

NJË ZË

Dëgjoj në heshtje dhe e çuditur
Një zë
Qetësisht kthehem pas:
Ka ndodhur dje apo ka një shekull,
Që ky zë më ka turbulluar
Në labirintin e jetës time,
Ai është tokë dhe det
Muzikë dhe jetë ai është.

RRËFIM

Sa e gjatë ishte java!
Dhe horizontet plot mjegull qenë,
Njerëzit e njohur
Më dukeshin të panjohur,
Çfarë zbrazëtie!
Por unë jetoja tjetër kohë,
Në një vend të largët,
Midis trëndafilave të Bengalit,
- Që të parë nga lartësitë e kaltra,
Duke si zjarre të vegjël -
Me imazhin tënd në sy
Dhe me zërin tënd të skalitur në shpirt
Duke shtrënguar zemrën,
Zemrën time të brishtë si një zog,
Që krejt i përgjakur
Endërron fluturimin e mbramë.

METAMORFOZE

Kam disa fjalë pa zë për të thënë,
Fjalë të hutuara,
Të huaja për kohën time.

Fjalë blu,
Që zbresin nga qiejt e lartë,
Të yjezuar, të çuditshme.



Fjalë të tejdukshme,
Pasqyrë e shpirtit të botës,
Ikanake, të ndritshme.

Fjalë ëndërr,
Që zgjohen nga përjetësia,
Me bukuri kobtare, rrezëllitëse.

Fjalë zjarr,
Të ngjyera me të verdhë e të kuqe,
Zemra ime papushim aty digjet.

DIALOG

Ti më pyet se çfarë shoh
Një udhë të panjohur

Ti më pyet se çfarë mendoj
Trëndafilin e dashurisë

Ti më pyet se çfarë kërkoj
Ëndrrat e humbura

Ti më mbështjell
Me duart e tua filiza pylli

Që ngatërrohen
Në flokët e mi

Toka fillon të rrotullohet
Në krahun e kundërt

Atëherë bota nuk ekziston
As metropolet

Vetëm ti dhe unë,
Dhe asgjë tjetër.

OPTIMISTE
-Alegrivacce-

Agu
Dielli
Dita
Fati
Vështrimi
Buzëqeshja
Muzgu
Hëna
Dashuria
Trëndafil
Puthja
Prehja
Qielli
Hëna
Yjtë
Foshnja
Ngjitja.

DASHURIA

Ishte një stinë e mistershme
Vjeshtë e parë
Dhe trëndafilat kuqëlonin së tepërmi
Vitet dhe ditët tona
Nisën të prarojnë
Dhe në një çast
U përndezën

Në një hapësirë abstrakte.
Ne heshtnim
Dhe kur flisnim
Thoshim diçka pa lidhje
Që mbi të gjitha nuk e dëgjonim,
Vetëm zemrat
Kishin një gjuhë të kuptueshme.
Pataj nisëm të ecnim
Në mes të kozmosit të tmerrshëm
Të hutuar e të mrekulluar
Me fatin tonë përdore.

SYREALISTE

Bota jonë shpërbëhet ngadalë
Fjalët popullojnë një botë tjetër
Natyra hap dyert magjike
Ngado shihen shtatë ngjyrat e ylberit
Unë jam purpuri që të huton
Ti shndërrohesh në horizont
Dhe më tërheq lart, larg
Ecim apo lundrojmë?
Nuk e di,
Por rrugët bëhen ajrore
Bimësia lëviz me ne
Pemët ruajnë stinën e artë
Flladi na përkëdhel
Si fëmijë të urtë
Me duart e tij të ëmbla;
E tashmja dhe e shkuara ikin
Mbetet vetëm e ardhmja
Hipotetike,
E vockël
Dhe e madhe
Njëkohësisht.

Tiranë, 10 janar 2020

POEMA IME

Poema ime është
Një dashuri sublime
E ndritshme dhe e errët
Pa kontekst
Që nuk vdes kurrë
E lirë, abstrakte
E mëvetësishme
Si drita.

2022

ÇASTE

Ndonjëherë,
Në mes të natës,
Zgjohehem e lemerisur
Një makth më mbërthen:
Zëri yt diellor.
A është arratisur ai nga shpirti im,
Apo ende aty banon?

TRËNDAFIL

E kujtoj atë trëndafil
Ngjyrën e tij të kuqe, të kulluar
Si rubin
Një ditë vjeshte
Që ishte llahtarish e bukur
Dhe e trishtuar
Nga mendimi i fshehtë
Se vdekja mund t'ia behte papritur
Si magji e zezë
Dhe mund ta flakte tutje
Mizorisht atë trëndafil.

Në dhomë trëndafilin e kuq
Unë e afrova te zemra
Dhe i këndova në heshtje
Një këngë të padëgjuar
Këngë e çuditshme
Me kuptime të fshehta
Si mbishkrimet e lashta
Këngë e thellë
Përzier me atë lloj bukurie
Që ka brenda çdo *amour fou*
Bukuri e vdekjes.

10 janar 2025

KLARA KODRA

Ëndrra të bukura

(fragment nga novela)



Etleva! Shpejt! Mësuesja!
Vizatimi i trëndafil, sa hap e mbyll sytë, u zhduk nën bangë, për t'i lënë vendin fletores së shënimeve.

Mësuesja e biologjisë e vështroi me miratim atë, pas syzeve të trasha - ajo ishte më dritëshkurtër se një urith. - Etleva ishte nxënese e mirë, e ndiqte shpjegimin, u sigurua ajo. Si do t'i merrte ndryshe dhjetat?

Sigurisht, një pjesë të meritës e kishte ajo vetë, me shpjegimet e qarta dhe të hollësishme, mendoj mësuesja me vetëkënaqësi. Ai teveqeli i matematikës s'kishte sy e faqe të ankohej për nxënësit!

- I bukur është ai send apo frymor që është i përsosur në llojin e vet - tha mësuesi i vizatimit, duke përsëritur përkufizimin që dikur i kishin mësuar në leksionet e estetikës dhe që i ishte dukur si zbulim.

- Atëherë - humbi tingëllueshëm zëri i më çapkënit të klasës - buburreci më i përsosur në llojin e vet, a është *i bukur*?

- Pyetje interesante - tha mësuesi, pa e qortuar se kishte folur pa leje. - Jo, nuk mendoj se është *i bukur*. Është *i përsosur* në shëmtinë e vet.

Mësuesi u kujtua se përkufizimi që sapo u kishte dhënë nxënësve kishte

caqet e veta dhe mund të bëheshin të tjera pyetje që do ta ngatërronin më shumë.

U kujtua që dikur i kishin thënë se veprat moderniste s'mund të ishin të bukura. U kujtua edhe për kultin e të shëmtuarës që kishin ekspresionistët.

Së fundi, u kujtua që nxënësit e klasës së gjashtë që e dëgjonin s'do të kuptonin asgjë në rast se do t'u tregonte gjëra të tilla. Vazhdoi: - E po, s'është i bukur sipas përfytyrimit që kemi ne. Ndofta është i bukur në natyrën e vet si buburrec që është.

U kujtua prapë me frikë për ndërlikimet e subjektives dhe objektives. Po iu duk se nxënësit kishin pranuar atë që u kishte thënë.

Etlevës iu kujtua që kur ishte e vogël ishte përpjekur të vizatonte buburreca. Tani vizatonte lule. Vjollca, luleshqerra, trëndafila dhe atë lule pa emër që i kishte shkrepur ta quante "lule të paraajsës" se asnjë lule e vërtetë s'kishte atë ngjyrë bojë vjollce. Mos vallë ishte ... si i thoshnin asaj ngjyre që kishte gjetur në internet dhe që sytë e njerzve s'e kapnin dot? Ultra ... po ... ultraviolet, ultravjollcë. Pse vallë sytë e njerzve s'e kapnin dot?

Mbase sytë e alienëve, mendoj prapë. Po alienët a ishin vallë më të përsosur se njerzët e Tokës?

Po rrezet infra të kuqe? Mendoj që të përziente të kuqen me rozën.

Dhe... me çfarë tjetër? Që të vizatonte disa trëndafila të mrekullueshëm. Po trëndafila të kaltër pse s'ka?

Mund të provonte të vizatonte edhe ndonjë trëndafil të kaltër.

Në jetë vërtet s'ka, po në përralla mund të ketë. Po të bëhej piktole mund të ekzistonte ndonjë libër me përralla ku kishte trëndafila të kaltër. Sigurisht, autori ose autorja s'do të gjente dot ilustrues për trëndafilat e veta. Dikush do t'i thoshte: A s'ke dëgjuar për piktolet e famshme Etleva...? Ndofta ajo do të pranojë të bëjë ilustrimet.

Etleva e harroi fare se s'ishte ende piktorja e famshme. Vizatimi me trëndafil i rrëshqiti për tokë nga poshtë bankës dhe shoqja pranë harroi ta lajmëronte se po afrohej mësuesi. Sytë e gjithë klasës po e vështronin tani me frikë, ndonjë me ngazëllim të fshehtë.

Etleva! Ku e ke mollën që kishim për të vizatuar sot?

Ah, një lule! Qenka e bukur, - a kishte vallë ironi në zërin e mësuesit? - Ki durim do të vizatojmë edhe lule.

- Dëgjo, në jetë lulet bëhen fruta, në vizatimet tona ... s'besoj se mendon që po të vizatosh një lule molle ajo do të bëhet mollë. - Tërë klasa ia plasi të qeshurit. - Pastaj ... kjo s'është lule molle ... çfarë është?

- Trëndafil - bëlbëzoi vajza e vogël. Gjersa mësuesi bënte humor kjo donte të thoshte se s'ishte shumë i zemëruar ... apo mos donte të tallej me të? Ai e mori vizatimin, sytë e saj e ndoqën me frikë, mos do ta griste? Jo, e vuri në xhep.

- Ah, trëndafil! Trëndafili s'bëhet frut, po është i bukur. Shiko, Etleva, gjërat kanë radhë. Do të flasim pas mësimit.

S'po e nxirrte jashtë, s'po i thoshte se do t'ia ulte notën në sjellje. Domethënë se kishte shpëtuar.

- Etleva! Domethënë se ty të pëlqen shumë të vizatosh?

- Po, mësues, shumë - mezi foli ajo.

- Kjo është një gjë e bukur, po, si të thashë, gjërat kanë radhë.

Ti do të bëhesh piktole?

Vajza u drodh. Mësuesi kishte përmendur me zë të lartë ëndrrën e saj të fshehur.

- Po, mësues.

- Shumë mirë. Atëherë do të duhet të vazhdosh Liceun Artistik, pastaj Akademinë e Arteve ...

Vajza u drodh. A do t'i vinte vallë radha pas dy vëllezërve?

Ata s'e pëlqenin vizatimin, po universitetin s'kishte pikën e dyshimit se do ta vazhdonin.

Babai dhe mamaja me siguri do të ngulnin këmbë për këtë gjë.

Qysh nesër do të m'i sjellësh tërë vizatimet e tua që t'i shoh.

A e kishte me tërë mend mësuesi?

Jo, ai ishte i mirë, nuk tallej.

Motra kishte qejf letërsinë, edhe ajo do të ndiqte shkollën e lartë.

Sa keq kur je fëmija e fundit në familje!

Po ndofta mësuesi do të fliste me prindërit. Ata do t'ia dëgjonin fjalën.

Gjithmonë. Pa u ndaluar. Me rritjen e frikës dhe venitjen e shpresës.

Do të të dua pa ia vënë veshin veprimeve të armiqve tanë apo xhelozisë së aktorëve. Do të të dua pa ia vënë veshin zemëratës së prindërve apo mërzitjes së miqve. Do të të dua pa e çarë kokën se ç'shërbehet nëpër kafenetë e botës apo ç'lojë luhet gjatë çasteve të pushimit. Do të të dua pa e çarë kokën se me sa e sa zjarre do të na duhet të luajmë apo se ç'vizatohet në dërrasën e zezë me një shkumës të turbullt e të mërzitshëm. Do të të dua pavarësisht nga gabimet e pafundme kur përpiqem të thjeshtoj thyesat dhe sado i vështirë të jetë mësimi përmendësh i tabelës periodike. Do të të dua pa e vrarë mendjen se cili është kombinimi i dollapit tënd apo si ke vendosur ta kalosh kohën në sallën e studimit. Do të të dua pavarësisht nga performanca e ekipit tënd të futbollit nëpër turne dhe pa ia vënë veshit njollave në veshjen time si nxitës tifozësh. Do të të dua edhe nëse nuk të shoh më dhe do të të dua edhe nëse të shoh çdo të martë. Do të të dua nëse shkurton flokët dhe do të të dua edhe nëse ua shkurton të tjerëve. Do të të dua nëse heq dorë nga prapësitë dhe do të të dua nëse tërhiqesh nga teatri dhe zgjedh një profesion tjetër, më pak të rrezikshëm. Do të të dua edhe nëse e lëshon mushamanë e shiut në tokë, në vend që ta varësh, dhe do të të dua edhe nëse i del kundër tët eti. Do të të dua edhe nëse thua se poezia e Edgar Gestit është më e mira në botë dhe do të të dua dhe nëse thua se vepra e Zilfa Kitli Shnajderit është e padurueshme dhe e lodhshme. Do të të dua nëse braktis tereminin dhe merr harmonikën dhe do të të dua nëse ua fal marmosët kopshtit zoologjik dhe bretkosat M.-së. Do të të dua ashtu siç do ylli i detit koralin dhe siç do kudzu pemët, edhe nëse oqeanet kthehen në pluhur dhe pemët bien në pyll pa i dëgjuar kush. Do të të dua ashtu si *pestoja* do pastat *fetuçine*, si rrepa do *Miagin*, si *tempura* do *ikurën* dhe si *peperoni* do picën. Do të të dua si foka do lulëllakrat dhe si njollat e errëta duan leopardin, si shushunja do kyçin e një lejleku dhe si një kufomë do sqepin e një grabitqari. Do të të dua ashtu si mjeku do pacientin e vet më të sëmurë dhe ashtu si liqeni do notarin më të etur. Do të të dua ashtu si mjekra do nofullën, si thërrimet duan mjekrën, si ajo drej pecete e njomë do thërrimet, si ai dokument i çmuar do lagështinë e pecetës, si syri i mprehtë i lexuesit do të bardhën mbi të zezë të dokumentit, dhe si lotët rrëke duan syrin që përpëlitet, teksa keqkupton atë që është shkruar. Do të të dua si ajsbergu do anijen, si pasagjerët duan varkat e shpëtimit, si varkat e shpëtimit duan dhëmbët e balenës dhe si dhëmbët e balenës duan shijen e uniformave të marinës. Do të të dua ashtu si një fëmijë do të dëgjojë bisedat e prindërve të vet, ashtu si prindërit duan vërshimin e zërave të tyre gjatë grindjeve dhe ashtu si një stilolaps do të shkruajë në fletore një për një fjalët që këta zëra shqiptojnë. Do të të dua ashtu si zalli do të bjerë nga çatia në një ditë të vranët e të zaptojë mjekrën e një inatçiu dhe si furra do të mos punojë kur piqet gjeli i detit. Do të të dua ashtu si një aeroplan do të bjerë nga qielli i kristaltë dhe si një shkallë lëvizëse do shallet e shtrenjta tek ngatërrohen nëpër mekanizmat e vet. Do të të dua ashtu si një letër e njomë do të bëhet shuk e të hidhet pupthi në tavanin e tualetit dhe

LEMONY SNICKET

Do të të dua

Përktheu: Xhoina Salaj

ashtu si një gomë do të lërë pluhur në flokët e njerëzve fjalaman. Do të të dua ashtu si një manshetë do të shkaputet nga këmba dhe të jetojë për hesap të vet dhe ashtu si një palë doreza të bardha duan të rrëshqasin me delikatesë në brokën e ponçit. Do të të dua ashtu si një taksidër do të spërkatet me baltë nga një llucë dhe ashtu si një bibliotekë do tiktakun e duruar të orës. Do të të dua si një hajdut do një galeri, si një korb do tufën e vet, si një re do lakuriqët e natës dhe si një mal do kodrën e thepisur. Do të të dua ashtu si fatkeqësitë duan jetimët, si zjarri do pafajësinë dhe ashtu si drejtësia do të ulet serbes e të shohë gjithçka që shkon si mos më keq. Do të të dua ashtu si një fushëbetë do djelmohat dhe si menta do alergjitë e tua, dhe do të të dua si lëkura e bananes do këpucën e një burri që sapo u godit me një zall që ra nga çatia

e një shtëpie. Do të të dua ashtu si një shërbim zjarrfikës vullnetar do të rendë drejt ndërtesave që shkumbohen dhe si ndërtesat që shkumbohen duan që ata të zhduken nga sytë këmbët, si një parashutist do të lërë dirizhablin dhe si një parashutist do ta ndjekë pas atë. Do të të dua ashtu si thika do shpinën e dikujt, si dikush do tunikat rezistente ndaj thikave, si tunikat rezistente ndaj thikave duan të shkojnë në një pastrim kimik dhe si një punonjës i pastrimit kimik do të qëndrojë zgjuar gjithë natën me një palë tejqyra, duke parë një fabrikë thikash për orë të tëra, me shpresën për të kapur një hajdut, dhe si një hajdut do t'i bishtnojë njerëzve me tejqyra, sepse papritur kujton që e ka lënë thikën në shtëpi. Do të të dua ashtu si një sirtar do një qoshk të fshehtë, si një qoshk e fshehtë do një sekret, si një sekret do të bëjë dikë të gulçojë, si dikush që

gulçon do një gotë me raki për të qetësuar marazin, si një gotë raki do të thyhet në dysHEME, si zhurma e qelqit që thyhet në dysHEME do të bëjë dikë tjetër të gulçojë, si dikush tjetër që gulçon do një tryezë që të mbështetet pak, edhe pse mbështetja pas tij cek një dorezë që do një sirtar me një qoshk të fshehtë. Do të të dua derisa të hapen dhe zbulohen të gjitha qoshqet e tilla dhe derisa të gjitha të fshehtat të kenë gulçuar nëpër botë. Do të të dua derisa të gjitha kodet dhe zemrat të jenë thyer dhe derisa çdo anagram dhe vezë të jetë qëmtuar. Do të të dua derisa çdo zjarr të shuhet dhe derisa çdo shtëpi të rindërtohet nga pyjet më të bukura e më të ndjeshme, dhe derisa çdo kriminel të prangoset nga policët më të dembelosur. Do të të dua derisa M.-ja të urrejë gjarpërinjtë dhe J.-ja të urrejë gramatikën, dhe do të të dua derisa C.-ja të kuptojë se S.-ja nuk është i denjë për dashurinë e tij dhe N.-ja të kuptojë se ai nuk është i denjë për V.-në. Do të të dua derisa zogu të urrejë folenë dhe krimbi të urrejë mollën, derisa molla të urrejë pemën dhe pema të urrejë folenë, dhe derisa zogu të urrejë pemën dhe molla të urrejë folenë, megjithatë, nuk mund ta ndërmend dot këtë ndodhinë e fundit, sado të përpiqem. Do të të dua ndërsa rritemi, gjë që sapo ka ndodhur, dhe ka ndodhur, dhe ka ndodhur jo më larg se para disa ditësh, vazhdimisht, vite të tëra para, dhe do të vazhdojë të ndodhë ndërsa akrepat e çdo ore dhe faqet e çdo kalendari shënojnë kalimin e kohës, me përjashtim të atyre që njerëzit kanë harruar të kurdisin orët dhe të vendosin kalendaret në vende të qarta. Do të të dua ndërsa e gjejmë veten gjithnjë e më larg njëri-tjetrit, ku dikur ishim aq të afërt sa ndanim edhe pipën plastike dhe lugën e gjatë të hollë mes buzëve dhe gishtërinjve tanë. Do të të dua derisa mundësitë që ne të takohemi sërish të shuhen nga një pikë e mundshme në zero, derisa fytyra jote të vishet nga një kujtim i largët, derisa kujtimi yt të përballet me një mjegull po të largët, derisa mjegulla jote të kujtohet nga një fytyrë e largët, dhe derisa distanca jote të bëhet edhe më e largët nga kujtimi i një mjegulle të mjegullt. Do të të dua pavarësisht nga ku shkon dhe kë sheh, pavarësisht se kë shmang dhe kë nuk sheh, dhe pavarësisht se kush të sheh duke shmangur vendin ku po shkon. Do të të dua pavarësisht se çfarë ndodh me ty, pavarësisht se si do ta zbuloj se ç'po ndodh me ty, pavarësisht se ç'më ndodh ndërsa zbuloj këtë të fundit dhe pavarësisht se si do të jem pas asaj që më ndodh, ndërkohë që zbuloj këtë zallamahi. Do të të dua nëse nuk martohesh me mua. Do të të dua nëse martohesh me dikë tjetër, ndoshta me partnerin tënd, ose Y.-në, apo edhe O.-në, ose kushdo nga Z.-ja deri tek A.-ja, madje edhe me R.-në, edhe pse, fatkeqësisht, besoj se do të kalojë goxha kohë derisa dy gra të lejohen të martohen, dhe do të të dua nëse ke një fëmijë, dhe do të të dua nëse ke dy fëmijë, ose edhe tre, apo edhe më shumë, edhe pse mendoj se tre dalin e mjaftojnë, dhe do të të dua nëse vendos të mos martohesh fare e të mos kesh fëmijë, dhe i kalon vitet duke uruar që në fund të fundit të ishe martuar me mua, e të them të drejtën, në netët e vona e të ftohta, zemra më gufon për këtë skenar nga të gjithë skenarët e tjerë që kam përmendur. E kështu, Beatrice, do të të dua ndërkohë që bota vazhdon në rrugën e saj meskine.



Pas muajsh me ditë të bukura me diell, dimri filloi të zvarritej ngadalë. Fermerët maltezë kanë një thënie, që na lë të kuptojmë se moti nuk është freskuar ende, madje as është ftohur, deri në Krishtlindje. Dhe sikur të mos donte të sfidonte urtësinë shekullore të fjalës së urtë mbi bujqësinë, moti priti deri sa kaloi Viti i Ri para se të fillonte të shfaqte praninë e tij të ashpër. Pikërisht ditën e tretë të janarit, qielli u nxi në mënyrë ogurzezë dhe një erë e fortë verilindore solli një nga ato stuhitë dimërore për të cilat Mesdheu është i famshëm. Edhe temperatura ra në mënyrë drastike dhe rrobat e dimrit u nxorrën nga garderoba për t'i bërë ballë të ftohtit. Herët pasdite, filloi një shi me gjyma dhe këmbësorët hapën çadrat për të gjetur strehë nga shiu i furishëm.

Veç nëse kishin angazhime të ngutshme, që do të thoshte se ishin të detyruar të dilnin, ata që kishin frikë nga stuhitë qëndronin brenda, duke i ngrohur shtëpitë e tyre që të ndiheshin rehat, të struktur në divanet e dhomave të ndenjës duke parë televizorin dhe duke dëgjuar vetëtimat që gjëmonin rradhazi duke ia lënë vendin njera-tjetrës. Pasdite vonë, rrugët e Valetës ishin të shkreta. Shkuan e vanë ditët kur Rruga e Republikës do të gëlonte nga të rinjtë që shëtisnin lart e poshtë, ose kur kishte turma të vogla syresh që prisnin që kinemaja të hapte dyert. Në ditët e sotme, sapo mbyllen dyqanet, Valeta përgjimet deri të nesërmen në mëngjes, pasi jeta e natës dhe aktivitetet e tjera argëtuese janë zhvendosur gjatë.

Paceville është bërë kryeqyteti i ri argëtues i ishullit, me të rinjtë, madje edhe me ata jo aq të rinj, që ishin në kërkim të shoqërisë, argëtimit dhe të gjitha dëshirave të tjera. Njerëzit e kanë braktisur qytetin e kalorësve për qytetin e natës, me restorantet, klubet, kinematë dhe bufetë e tij që qëndrojnë të hapura gjatë gjithë kohës.

Bregdeti Sliema nuk kishte frymë njeriu. Ai është i ekspozuar ndaj erës verilindore dhe nuk ofron mbrojtje, me erërat e forta që marrin përpara çdo gjë që gjejnë përpara. Dallgët e larta e kishin rrethuar plazhin shkëmbor, ndërsa trotuari me pamje nga bregu ishte lagur nga një përzierje shiu dhe spërkash nga dallgët. Stolat e lagur me pamje nga deti ishin ato që mbanin peshën e furtunës. Ata dukeshin të vetmuar, pa asnjë shenjë nga pushuesit e tyre të zakonshëm, të cilët, në mbrëmjet më të ngrohta verore, uleshin aty deri në mbrëmje, derisa krevati t'ua bënte me shenjë të ktheheshin në shtëpi.

Megjithatë, pavarësisht motit të keq, turma e zakonshme e të rinjve që frekuentonte vendtakimet e Paceville, ishte ende atje, ndonëse me shumë gjasa, më e paktë në numër. Kuptohet që rrugët nuk ishin të mbushura me njerëz si zakonisht, por baret dhe restorantet ishin plot e përplot. Në fund të fundit, ishte mbrëmja e së shtunës, dita e javës kur shumica e njerëzve shkojnë në Paceville për argëtimin e fundjavës. Me afrimin e orës njëmbëdhjetë, të rinjtë që dëfrenin mund t'i shikoje duke vrapuar drejt autobusëve të linjës ose furgonëve me qira, që funksionin si autobusë individualë, në mënyrë që të respektonin orarin e vendosur nga prindërit e tyre, ndërsa më të rriturit, që kanë transportin e tyre; ishin ende duke ardhur. Të ngrënë, të pirët dhe kërcimi do të vazhdonin pa ndërprerje deri në orët e para të mëngjesit, ku ndërimi i brezave vihej re deri tek rojet të cilën siguronin që dëfrimi të mos ndërpritej.

Një grup i vogël djemsh dhe vajzash adoleshente ishin në një nga këndet më



të njohura të pijes në zonë. Ata ishin ulur rreth një tavoline, duke pirë dhe duke u lëkundur nën ritmin e muzikës që buçiste nga dy altoparlantët e mëdhenj në secilin krah të lokalit. Baristi, me flokët e kapur bisht me mjeshtëri pas koke, përfitoi nga një moment qetësie për të larë dhe tharë gotat, që t'i kishte gati kur turma me klientët e radhës të mësynte lokalit, duke kërkuar pije. Vështrimi i tij ishte fiksuar tek një grua që ishte ulur në stolin e banakut të barit, duke pirë vodka.

- Edhe një tjetër, - tha Suzana, teksa i zgjati gotën e saj për të rimbushur.

- Nuk mendon se ke pirë mjaftueshëm për sonte? - i tha asaj.

- Hë pra, mbushe edhe një teke... e fundit. Bëje dopio.

Baristi bëri siç i kërkoi ajo, e mbushi gotën dhe ia vuri përpara, ndërsa ajo e pagoi. Ai e njihte Suzanën prej një kohe të gjatë dhe gjithmonë ishte tërhequr prej saj. Ajo ishte e bukur dhe e denjë për një vështrim të dytë, apo edhe të tretë. Ai kishte

pasur gjithmonë një dëshirë të fshehtë për të dalë me të, por kurrë nuk kishte marrë guximin për ta pyetur. Çuditërisht, kishte qenë gjithmonë i frikësuar të merrte iniciativën, sepse e konsideronte tepër të bukur që ajo të mendonte të dilte me të. E megjithatë, ai e dashuronte, qoftë edhe vetëm nga larg. Ajo nuk ishte më e re, pavarësisht viteve dhe efektit të tyre tek ajo, Suzana ishte ende një grua e bukur. Çdo mbrëmje, ajo vinte në lokal dhe fillonte të pinte vodka pa fre dhe nuk ndalonte para se t'i rëndoheshin sytë dhe lokali të fillonte t'i vinte rrotull. Shumë herë, ndërsa dilte duke iu marrë këmbët nga lokali, pengohet dhe binte pasi përplasej pas ndonjë karrigeje apo tavoline. Pedit, baristit, i pëlqente fakti që ajo kalonte kohë në banakun e tij, por shqetësohej kur e shihte në atë gjendje, duke pirë aq shumë. Shpesh ajo përfundonte me një vështrim të akullt në sy dhe duke folur pëçart. E kishte vdekje veçanërisht kur shihte klientë të tjerë që buzëqeshin të vetëkënaqur apo

edhe zgërdheshin me të. Oh, sa shumë do të donte që ta merrte me vete në shtëpi për ta dashur, për ta çmuar dhe për t'u kujdesur për të. Megjithatë, Suzana nuk tregoi kurrë ndonjë interes për të. Pedit nuk ishte i pashëm. Natyra nuk e kishte bekuar me një pamje fizike tërheqëse. Mbrëmje pas mbrëmjeje ai do të takonte vajza të panumërta dhe do hynte në biseda me shumë prej tyre, por kurrë nuk arriti të dilte me ndonjërin. Shpesh, do të dëgjonte të rinjtë që frekuentonin barin e tij të mburreshin për arritjet e tyre, duke përfshirë të gjitha detajet e ndyra. Por, ai vetë, nuk kishte pasur kurrë përvoja të tilla. Detyra e tij ishte të kujdesej për lokalit dhe këtë e bënte mirë gjatë natës, e ndonjëherë edhe deri në mëngjes. Ai fitonte shumë nga puna, por nuk ishte kurrë i kënaqur.

E kishte menduar një mijë herë ta linte punën, por nuk e ndërmoi kurrë hapin përfundimtar. Prania e Suzanës në lokalit e tij ishte shpesh faktori që e mbante atje, duke shërbyer pije, duke marrë pagesën e duke dhënë kusurin, duke larë e tharë gotat dhe duke parë fluksin e vazhdueshëm të njerëzve brenda dhe jashtë lokalit. Ai e kalonte pjesën më të madhe të orëve, zgjuar, në zemër të një argëtimi të tillë, pa pasur kurrë mundësinë ta shijonte vetë. Atë natë, Pedit e kishte përqendruar vështrimin e tij të vëmendshëm tek ajo, duke e parë të kthente me fund atë që supozohej të ishte e fundit për atë mbrëmje.

Ndërkohë, një djalë i ri duke pirë i qetë në një kthinë bashkë me një grup të rinjsh, i tha njëres prej vajzave:

- E sheh atë gruan te bari? Ajo vjen këtu çdo ditë! Dhe, kur e ka plotësuar kuotën e saj të vodkës, largohet nga këtu, gjysmë e dehur. Një herë, ndërsa po dilte, ishte aq e dehur sa që u rrëzua me fytyrë. Ne nuk mund të reshtnim së qeshuri me të!

- Ajo e ktheja me fund vodkën, - u përgjigj vajza.

Kjo shkaktoi një numër komentesh nga të tjerët në grupin e tyre, të cilët tani i kishin të gjithë sytë tek Suzana.

- Ajo pi vodka pothuajse sikur të ishte ujë.

- Duhet të ketë lekë tepër, nëse i shpenzon ashtu.

I riu iu përgjigj këtij komenti të fundit, duke konfirmuar:

- Po, ashtu është.

- Duket se e njihkërke mirë, - ia ktheu vajza e parë. "Ç'është e vërteta jo, por fola me dikë që e njihte dhe ai më tregoi shumë gjëra rreth saj."

- Si për shembull? - reagoi vajza, me kuriozitetin që iu zgjua natyrshëm.

- Po ja, di që ajo është e martuar me një avokat mjaft të suksesshëm dhe shumë të pasur, - tha ai.

Vajza tjetër, duke mos dashur të mbetej jashtë këtyre thashethemeve, e pyeti për moshën e saj, "Ajo duhet të jetë rreth të tridhjetave..."

- Aq them edhe unë, - tha djali duke e parë me eph. "Megjithatë, ajo është ende e bukur dhe e ka ende atë, nëse e keni idenë se për çfarë e kam fjalën dhe nëse..."

- Mbylle, - ia ktheu vajza duke buzëqeshur. "Mos fillo me atë mendjen tënde që të punon vetëm për një gjë."

- Çfarë thashë? Unë nuk thashë asgjë...

- E di shumë mirë se çfarë doje të thoje, more kopuk i ndyrë... - e ngacmoi ajo duke qeshur.

Nga aty ku po qëndronte, Pedit mund t'i dëgjonte të gjitha shakatë që vinin nga ai grup të rinjsh. Ai vetë ishte mbi të tridhjetat dhe megjithëse ishte gjithmonë i rrethuar nga këta të rinj, muhabeti i tyre shterpë dhe humori i cekët nuk i shkonin aspak për shtat.



A duhet të jetë e marrë dashuria që të quhet dashuri? A duhet të jetë trallisëse dashuria që të quhet dashuri? A duhet ta përjetojmë çmendurisht dashurinë që ta quajmë DASHURI?

Ç'është thotë "dashuri", "të biesh në dashuri", "të dashurosh" e të tjera si këto pyetje, shpeshherë sflitëse e pa ndonjë përgjigje konkrete për secilin prej nesh, kur na kaplon kërkësia, nevoja apo habia për t'i dhënë shpjegim këtij koncepti. Ajo që më vjen në mendje gjithmonë kur flas për dashurinë, është një thënie e André Breton, themeluesit të surrealistit:

"Dashuri do të thotë të takosh dikë, i cili të rrëfen diçka të re për veten".

Në një analizë tagente e sipërfaqësore të kësaj fraze, mund të arrish në përfundimin se kjo dashuri është egoiste, sepse mendon vetëm për Unin, dhe jo për Tjetrin. Madje, surrealistët, guxojnë e shkojnë më tej, duke e përkufizuar këtë dashuri si "amour fou", pra si dashuri të marrë, të çmendur, trallisëse e me epitete metaforike të tjera që mund t'i përngjiteshin këtij konotacioni.

Termi *amour fou* e ka origjinën nga vepra me të njëjtin titull e André Breton, shkruar në vitet 1934-1936 dhe e botuar për herë të parë nga botimet Gallimard në vitin 1937. Kjo vepër i kushtohet dashurisë dhe muzës së tij të madhe, të cilën e shihte si mishërimin e *amour fou*, korrespondenca e të cilës është vetë mrekullia. Ky koncept i André Breton nuk ishte thjesht një ide letrare apo filozofike - ishte një përvojë e jetuar, e mishëruar në marrëdhënien e tij pasionante me Jacqueline Lamba.

Shprehja poetike surrealistike e *amour fou* presupozon lehtësimin e poetit nga paragjykimet estetike, lakuriqësinë dhe pastërtinë e vizionit të tij dhe identifikimin me objektin e tij. Femra dhe erosi bashkëidentifikohen, por nuk shkrihen me njëri-tjetrin. Ajo që mbetet elementi kryesor në problematikën surrealistike të *amour fou* është **dëshira**, çelësi kryesor që na çon drejt përjasjeve frojdiane dhe dimensioneve shoqërore. Dëshira erotike nuk nënkuptohet vetëm brenda një kuptimi veçanërisht erotik, por në një aspekt më të gjerë. Edhe pse konsiderohet si stimuli kryesor i procesit erotik, ajo krijon dy lloj shkrimesh: së pari, erotizmin, i cili është kultivuar sistematikisht në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore dhe së dyti lirizmin, që nuk ka asnjë lidhje me shprehjen e njohur romantike. Këto dy tendenca përcaktojnë pak a shumë shkrimin surrealist erotik.

Vetë dashuria, duke nënkuptuar dashurinë pasionante, zë vendin e parë në rrëfimet surrealistike. Tek ajo gjenden të gjitha prestigjet e Universit, të gjitha fuqitë e të vetëdijshmes, e gjithë tronditja e ndjenjës. Lidhja e poezisë me dashurinë mbizotëron në poetikën surrealistike, sepse dashuria luan një rol parësor në krijimin e botës së re. Roli i saj është krijues dhe shkatërrues, sepse bëhet fjalë për një formë revolucionari, në kërkimi të të cilit ishin surrealistët.

Kështu, Aragon, në 1924, tek parathënia e "Libertinage" shkruan për erosin:

"Nuk mendoj asgjë tjetër përveç se erosit (...) Për mua nuk ekziston një ide që të mos i përkasë erosit. Nëse do të ishte në dorën time, gjithçka që do t'i kundërvihet erosit, do ta asgjësoja..."

Koncepti i surrealistëve për erosin ecën paralelisht me dashurinë e tyre për artin dhe të dyja këto estetika plotësojnë njëra-tjetrën. Një vepër arti dhe një femër janë e njëjta gjë për ata dhe kthehen në një mjet komunikimi ndërmjet njeriut dhe botës. Vlen për t'u theksuar ky përkim i *femër-vepër arti*, ashtu siç do të shprehet edhe Breton tek "Amour fou" në lidhje me përmasat e kësaj marrëdhënieje:

"...rrëfej pa shqetësimin më të vogël apatinë time të thellë përpara veprave të artit që nuk më japin asnjë turbullim apo eksitim fizik..."

Lautreamont, Freud, Sade dhe romantizmi gjerman janë burimet thelbësore të filozofisë

"Uroj të të dashurojnë marrëzisht, Jacqueline" Një *amour fou* surrealistike à la française

Prof.ass.dr Maklena Nika

surrealistike për dashurinë. Pesimizmi erotik i Lautreamont shprehet poetikisht me imazhe dhe asosacione që paralajmërojnë interpretimet psikoanalitike të ëndrrave të Freud. Përkundrazi aktualiteti dhe plotësia e fjalës shkencore të Freud janë për surrealistët garancia më e mirë për projektimin dhe zhvillimin e tezave të tyre mbi dashurinë. Por, surrealizmi nuk këmbënguli absolutisht në idetë romantike për *erosin*, ai huazoi vetëm ndjenjën e pasionit, të absolute, të forcës së misterme që lidh erotikisht dy njerëz. Nga "Nadja" tek "Amour fou", nga "Fata Morgana" tek "Arkana 17", vepra e Breton shfaq idetë bazë të problematikës surrealistike mbi erosin: lidhjen femër-mashkull dhe dashurinë e përzgjedhur, në kombinim me libertinizmin (*libertinage*). Këto koncepte mbulojnë gjithë spektrin e dëshirës erotike dhe prekin kufijtë e një globaliteti.

Për surrealistët, *amour fou* nuk është vetëm një rrugë drejt surrealistit, por një qëndrim jete dhe një mënyrë njohjeje e botës. Impresioni, e rastësishmja, admirimi janë elemente që përbëjnë këtë gjendje në të cilën njeriu ftohet të zhvillojë një lidhje krijuese me realitetin. Pasioni erotik është një rast tjetër ku surrealistët gjejnë një mjet shpërthimi dhe distancimi nga realiteti shoqëror, një mjet për të njohur vetveten. Është karakteristik fakti se për surrealistët çasti i përkimit ndërmjet dy qenieve është pa dyshim një çast lirie dhe rilindjeje. Por, nga ana tjetër, për surrealistët liria e individit gjendet dhe shprehet në predispozicionin e tij për të pranuar dashurinë si purgator dhe

si ndjenjë krijuese.

Shprehja poetike surrealistike e *amour fou* presupozon lehtësimin e poetit nga paragjykimet estetike, lakuriqësinë dhe pastërtinë e vizionit të tij dhe identifikimin me objektin e tij. *Amour fou* çliron erotikën, shpreh dëshirën irracionale dhe thyen kufizimet shoqërore. Erotizmi, në thelb, është një formë lirie, ndërsa dashuria një akt rebelimi kundër racionalitetit dhe një urë lidhëse midis së shkuarës dhe së tashmes, ëndrrës dhe realitetit.

Breton beson se dashuria e vërtetë është e paracaktuar dhe mund të shfaqet papritur, si një vizion. Vetë takimin me *Jacqueline* e konsideroi si përmbushjen e një fati të pashmangshëm. Kjo dashuri ka vlerë eksploruese, nuk është vetëm emocionale, por edhe epistemologjike - ajo zbulon të vërtetën të fshehura, njësoj si ëndrrat ose shkrimi automatik. *Amour fou* nuk është dashuri racionale; është një dashuri që e çon njeriun në prag të marrëzisë, një forcë dërrmuese që konsumon të dy të dashuruarit. Dashuria e vërtetë duhet të jetë gjithëpërfshirëse, në atë masë sa të rrënojë të gjithë qenien e dikujt. Lidhja e dashurisë së Breton dhe *Jacqueline* përfaqëson bukurinë dhe kontradiktat e *amour fou*. Ndërsa Breton e shihte dashurinë si një përvojë përfundimtare surrealistike, pavarësia që e dashura e tij kërkoi ngre pikëpyetje të tjera në lidhje me kufijtë e një dashurie kaq obsesive dhe të idealizuar. Historia e tyre është një shembull i përsosur i pasionit surrealist - intensiv, poetik, por në fund të fundit kalimtar dhe i përkohshëm.

Edhe pse *éphémère*, ky koncept për



dashurinë do të frymëzonte edhe artistë të tjerë surrealistë, si piktorët Salvador Dali, Marx Ernst, Man Ray e shumë të tjerë. Ndërsa Paul Éluard e konsideron dashurinë si një vizion poetik. Te vepra e tij e famshme "Capitale de la douleur", dashuria shfaqet edhe si burim ekstaze dhe vuajtjeje, duke reflektuar vetë paradoksin e *amour fou*, duke iu dorëzuar plotësisht e duke e lejuar atë të riformësojë realitetin. Përsa i përket filmit surrealist, irracionaliteti i *amour fou* e gjeti medium-in e tij të përsosur në kinemanë surrealistike, ku dashuria shpesh sfidonte kohën, hapësirën dhe arsyen. Vetë Luis Buñuel prodhoi filma që u fokusuan në anën e errët të marrëdhënies dashurore obsesive, shkatërruese ku realiteti shembet nën peshën e pasionit.

Amour fou mbetet një temë e fuqishme artistike dhe letrare, duke frymëzuar gjithçka, nga pikturat surrealistike deri te romanet moderne feministe. Ndërsa Breton e pa atë si një forcë çlirimtare, shkrimtarët dhe artistët e mëvonshëm e kanë sfiduar ose ripërcaktuar atë, duke zbuluar si bukurinë, ashtu edhe kontradiktat e tij. Edhe pse shpeshherë i keqkuptuar nga kritika dhe lexuesi, madje edhe në ditët e sotme, përgjigja e Breton tek "Amour fou" është e qartë dhe shpresëdhënëse:

"Dashuria është përpara nesh dhe jo pas nesh, ajo rishpiket pa pushim...ajo është një mit, si vetë Opera, ku ne kalojmë çdo ditë, ku ne jetojmë, dhe mitet janë përpara nesh, janë tek ne, ata janë vetë ne".

Kjo është DASHURIA!



Dashnorët, 1928 nga René Magritte

Po qëndronim ulur në platformën e stacionit hekurudhor mbi çantat e udhëtimit. Danieli dhe unë kishim hequr bluzat dhe rrinim ulur aty me pjesën e sipërme të trupit lakuriq, Mariana kishte veshur xhinse të prera te gjunjët dhe pjesën e sipërme të bikinit. Po djersinim. Çatia prej llamarine kërciste në nxehtësi, dhe sipër shinave vezullonte ajri i nxehtë. Treni është të paktën dy orë me vonesë, kishte thënë përgjegjësi i stacionit. Nuk u inatosëm aspak, dukej si një mrekulli që në këtë nxehtësi të udhëtonin ende trena.

– Sa keq që nuk kemi muzikë, ia priti Mariana.

Kafeneja e stacionit të trenit ishte e mbyllur. Danieli tha se do të shkonte në fshat të merrte akullore. U largua për një kohë të gjatë, dhe kur u kthye më në fund, akullorja thujse ishte shkrire nga vapa, dhe e hëngrëm me kafshata të mëdha. Pastaj dëgjua lokomotivën të fërshëllente. Nuk kishte kaluar as një orë. Shumë larg u duk një tren në dritën verbuese. Dukej sikur po rrinte pezull mbi shina. Po vinte shumë ngadalë drejt nesh. Përgjegjësi i stacionit doli nga zyra e tij. Ai kishte veshur një këmishë me mëngë të shkurtra dhe një kapelë. Treni erdhi shumë ngadalë në stacionin e trenit dhe na kaloi pranë. Frenat ulëritën fort dhe pafundësisht gjatë. Vagonat ishin të vjetër. Ishin lyer me ngjyrë të bardhë, dhe anash ishin pikturuar kryqe të kuq. Të gjithë diellpritsit ishin ulur. Më në fund pushoi kërkëllitja, dhe treni ndali me një të shtyrë. Pastaj u bë qetësi.

Treni i bardhë qëndroi aty dhe nuk ndodhi asgjë. Vetëm në zyrën e stacionit zilja e telefonit ra sërish, dhe më në fund përgjegjësi i stacionit u kthye shumë ngadalë në zyrën e tij, dhe menjëherë pas kësaj telefoni reshti së rëni. Në sheshin e parkimit pranë stacionit të trenit erdhi shpejt një burrë i shëndoshë, i veshur me të zeza. Po djersinte dhe po e fshinte djersën nga balli me një shami të bardhë dore. Pak përpara se ai të arrinte trenin, u hap një derë, burri hipi dhe dera u mbyll sërish.

– Je skuqur shumë në kurriz, tha Mariana, - mund të të lyej me krem?

Nxori nga çanta e saj e shpinës një tubet me krem dielli, i shtyu syzet e diellit mbi majën e hundës, për të parë më mirë, dhe filloi që të më lyente shpinën.

– Çfarë ka ndodhur me trenin? Pyeti Danieli. Ai u ngrit dhe eci përgjatë peronit deri në fund të trenit.

– I gjithi tren – ambulancë, tha ai, kur u kthye, - tren i posaçëm për në Lourdes. Kur hodha sytw matanë trenit tw bardhë, vura re se njëri nga diellpritsit ishte ngritur disi lart. Në të çarën e ngushtë mund të shikoje një fytyrë. Dikush po na vështronte. Pastaj edhe te dritaret e tjera u ngritën diellpritsit, dhe njerëzit po shikonin jashtë. Disa i varën krahët e tyre jashtë dritareve. Të sëmuret po na vëzhgonin. Nga disa kabina nuk shikonte askush, por edhe atje diellpritsit ishin hapur tani, dhe vura re se mbi minderë qëndronin shtrirë njerëz që lëviznin. Pashë një shpinë, një kokë, një këmbë, një herë një jastëk që u rrotullua. Të sëmuret lëviznin pa u lodhur, dukej



PETER STAMM

Ndalesa

Përktheu Dr. Elda Gjana-Boriçi

që ata nuk ishin mirë, duhet të kishin dhimbje, të vuanin nga vapa. Mu bë sikur ishin shumë larg nesh. Nga një dritare po vështronte një murgeshë me veshje në ngjyrë të çelët dhe me një kapuç të bardhë. Në fytyrën e saj ndorej një shprehje triumfuese.

Të sëmuret të zhurmshëm, tha Mariana. – Mund të mendosh se ata nuk kanë parë kurrë një bikini. – Ajo ndali së lyeri shpinën time, u kthye nga treni dhe hodhi përsipër një bluzë.

– Në tren duhet të jetë vapë e tmerrshme, i thashë.

– Kjo na pret edhe neve, tha Mariana, mendon se kanë sëmurdje ngjitëse?

– Përse na shohin kështu ngultas? I thashë.

Ishte heshtje varri. Vetëm hera – herës kollitej ndonjëri. Ndeza një cigare.

– Nganjëherë mendoj se jeta do të ishte më e thjeshtë, po të ishe i sëmuret, ia priti Danieli. Atëherë do ta dije se çfarë të priste.

– Mendon se njerëzit në tren e

besojnë vërtetë këtë gjë? E pyeti Mariana.

– Nuk është turp ta besosh këtë gjë, i thashë, - por natyrisht nuk ndihmon aspak.

Në dritaren mu përpara nesh qëndronte një zonjë plakë. Krahu i varej i plogët jashtë dritares. Ajo lëvizte gishtërinjtë, sikur po provonte një copë apo rrëshqiste rërë nëpër gishtërinj. Pas nesh gjëmoi një rrapëllimë e fortë. Grilat prej llamarine të kafenesë së stacionit të trenit u ngritën lart. Një burrë me jelek të bardhë po mbante disa tryeza plastike dhe karrige në peron. Kur kish mbaruar dhe u zhduk brenda në lokal, e ndoqa nga pas.

– Ujë, më thirri Mariana nga pas, dhe Danieli: Edhe për mua.

Te bari po qëndronte përgjegjësi i stacionit të trenit, duhet të ishte futur nga hyrja anësore.

– Një i vdekur, më tha dhe tregoi me kokë në drejtim të trenit të bardhë. – Për shkak të vapës...

– Një nga tezet e mia ia hodhi, tha banakieri i barit, nga herpesi. Dhe kur ajo u kthye nga Lourdes¹, i kishte ikur. Por nuk ia pranuan. Ajo u zemërua, mund të ma besosh.

Porosis pijet.

– Jeni ende i ri, mu drejtua përgjegjësi i stacionit të trenit, në moshën tuaj nuk mendoja për gjëra të tilla. Por një shëndet i mirë, kjo është dhurata më e madhe.

Kur dola nga restoranti, Mariana tha: Ata po nxjerrin dikë jashtë.

– Një të vdekur, ia ktheva, - e di.

Dera e njerit prej vagonëve ishte hapur. Aty brenda qëndronte me kurriz nga ne një burrë me një jelek ngjyrë portokalli vezullues. Në qafën e tij shkëlqente djersja. Zbriti me kujdes shkallët e vagonit, pastaj vinte një barelë, pastaj një burrë tjetër me një jelek ngjyrë portokalli. Në fund erdhën burri i shëndoshë me kostum të zi dhe një murgeshë. Tani të sëmuret po shikonin nga grupi i vogël, i cili kishte qëndruar pranë trenit. Pastaj murgesha vrapoi me hapa të shkurtër përgjatë vagonit, thirri diçka dhe tundi duart, sikur donte të dëbonte pula. Disa nga të sëmuret tërheqin kokat prapa. Danieli qeshi. Dy sanitarët mbanin barelën. Priti po i ndiqte.

– A djersijnë në fakt të vdekurit? Pyeti Danieli. – Apo të djersiturit pushon menjëherë?

– Të gjithë ata e kanë ditur, tha Mariana, - dhe ndërkohë më kanë parë. A nuk është e frikshme?

– Duhet të mësohesh me vdekjet, ia priti Danieli.

Është e tmerrshme, tha Mariana, - aty vdes dikush përpara syve tanë, dhe unë të lyej kurrizin për shkak të një djegieje qesharake nga dielli.

– Ai kishte vdekur tashmë, kur mbërritën këtu, ia ktheva, - prandaj kanë ndaluar. Prandaj kanë ecur kaq ngadalë.

– Ç'lidhje ka kjo me këtë? Tha Mariana.

Kur treni filloi të lëvizte krejt ngadalë, edhe të sëmuret e fundit larguan kokat. Diellpritsit u mbyllën sërish.

– Dua të di se kur mbërrinjë ata, tha Mariana. – Sa larg, mendoni, se është nga këtu për në Lourdes?

– Nuk e di, ia prita, me siguri që ata nuk mbërrijnë përpara të nesërme në mëngjes.

– Kaq shumë lëvizje, tha Danieli, të tërë janë gjithmonë në udhëtim diku. Madje edhe të sëmuret. Madje edhe të vdekurit. Atë me siguri e kthejnë. Sikur të luante ndonjë rol.

– Një tren plot me të sëmuret, tha Mariana, - dhe ai tërë natën kalon nëpër vende pa u ndalur. Njerëzit në fshatra flenë dhe nuk kuptojnë gjë.

Marrë nga:
BESTE DEUTSCHE ERZÄHLER
Deutsche Verlags-Anstalt
Stuttgart-München
2000

¹ Është një nga vendet më të vizituara të pelegrinazhit në botë. Në një shpellë, e cila ka një burim me fuqi shëruese, është ndërtuar një kishë, e cila është kthyer në një vend të rëndësishëm pelegrinazhi.

Karikaturë nga Arben Mexsi

